
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti V (XIX) - Nr. 19 (172) ISSN: 2305-655X

SHKENCË ISLAME | SOCIOLOGJ | PSIKOLOGJ | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE 19
2017

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI V (XIX) 2017, NR. 19 (172)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2017

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI V (XIX), prill, maj, qershor 2017 nr. 19 (172)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Ayhan Tekines, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazim, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti Bedër
Dr. Adem Balaban, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti Bedër
Dr. Xhemal Seferti, Jordani
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Peshkopia, foto AQSH

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al
www.zaninalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Bidati (risitë), një prej çështjeve, që mban peng unitetin e myslimanëve
Ervin Qylafku, Myftinia Durrës, KMSH5

Studime

2. Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë,
Dr. Genti Kruja, Universiteti “Bedër”, Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura,
Universiteti i Tiranës, Dr. Robert Gjedia, Universiteti “Marin Barleti”,
.....16
3. Vakëfet në Shqipëri nga periudha osmane deri në regjimin komunist
MA. Uran Kalej, KMSH36

Arsim dhe Edukim

4. 100-vjetori i shkollës normale të Shkodrës
Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.....44
5. Teknologjizimi i arsimit, sfidë apo progres?
Nuredin Nazarko50

Histori

6. Korpusi i mbishkrimeve osmane në Shqipërinë e Jugut I (Vlorë, Gjirokastrë)
Mehmet Tütüncü, Qendra Botërore e Kërkimeve për Gjuhën Turke
dhe Arabe, Haarlem, Hollandë62

Shkenca Komunikimi

7. “Drita Islame”, si mjet i përgjegjshëm komunikimi masiv në trendin e
zhvillimeve aktuale
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti Bedër76
8. Gruaja dhe familja në institucione të rëndësishme të shoqërisë nën optikën
e “Dritës Islame”
Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla, Universiteti i Tiranës82

Shkenca Politike

9. Procesi i pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe roli i saj në stabilitetin politik të Ballkanit dhe në Evropë
M.sc. Artan S. Mehmeti, Kosovë.....92

Personalitet

10. Haxhi Ismail b. Rexhepi, nga Akademik Feti Mehdiu, Kosovë102

Retrospektivë

11. Kush një vet-vedin një Zotin,
Ajdin Zejneli107
12. Abstracts in English113
13. Rregullat e shkrimit120



Bidati (risitë), një prej çështjeve që mban peng unitetin e myslimanëve

**Ervin Qylafku,
Myftinia Durrës**

Abstrakt

Një nga argumentet kryesore që dëgjojmë shpesh prej atyre që çdo risi e konsiderojnë gjynah dhe humbje, është koncepti që, nëse Pejgamberi a.s. nuk e ka vepruar diçka, atëherë veprimi i saj konsiderohet i ndaluar dhe risi (bidat). Kjo është nga gjërat më të çuditshme që mund të thuhet për këtë çështje. Jo çdo gjë që nuk e ka vepruar Profeti a.s. konsiderohet e ndaluar, qoftë ai edhe adhurim, nëse ai nuk ka ndaluar nga veprimi i tij.

Kuptohet qartë se koncepti i dijetarëve të Islamit, përgjithësisht, në lidhje me çështjen e risisë (bidatit), është keqkuptuar, keqinterpretuar dhe injoruar shpesh nga studiues dhe autodidaktë gjithashtu, të cilët kanë krijuar një klimë konfliktuale. Prej tyre minimalisht kërkohet një beshtje ndaj lëshimit të akuzave, llagapeve dhe etiketimeve me gjasë se të gjithë ata që nuk mendojnë si ata, kanë devijuar nga rruga e Zotit dhe janë të rrezikuar të dënohen nga Ai në jetën e amshueshme për çështje të cilat i nënshtrohen arsytimit njerëzor. Debatu konstruktiv është ai që i hap rrugën mirëkuptimit dhe justifikimit të mendimit ndryshe, e për rrjedhojë, unifikimit dhe vëllazërimit të besimtarëve, veprim i cili kënaq Zotin e gjithësisë, Profetin e Tij të nderuar e të gjithë besimtarët gjithashtu. Allahu e di më së miri.

Sikundër dihet, Islami është feja e fundit hyjnore, e cila i përshtatet çdo kohe e çdo vendi dhe, për rrjedhojë, ajo i ka të gjitha komponentët e duhur për ta provuar këtë. Për çdo ndodhi në jetë, risi të teknologjisë, sjellje apo veprimtari njerëzore, qoftë kjo ndërmjet krijesave ose ndërmjet tyre dhe Krijuesit, Islami ka qëndrimin e tij. Jeta ecën me ritme të shpejta dhe paralelisht me të qëndron dhe religjioni. Besimi ynë suporton çdo risi, e cila i ndihmon njerëzit që të bëjnë një jetë sa më qetë e të rehatshme, për këtë s'ka asnjë kundërshtim nga myslimanët. Diskutimet shekullore mes tyre kanë lindur në lidhje me raportet e njerëzve me Zotin, disa sjellje të reja, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me adhurimin, por që e ndihmojnë atë, sikundër ndihmojnë edhe në ruajtjen e principeve e normave të fesë sonë. Cili është qëndrimi i Islamit në lidhje me këto sjellje dhe përkushtime të reja në formë, por jo në origjinë? Çfarë qëndrimi kanë juristët myslimanë në lidhje me ato që quhen risi? Nëse kërkojmë në thëniet profetike, do të gjejmë se Profeti i nderuar ka diskutuar rreth tyre. Ai, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, thotë: “Çdo risi është humbje.”¹ Dhe gjejmë po ashtu fjalën e tij: “Kushdo që shpik në çështjen tonë (fenë tonë) diçka që nuk është prej

saj, ajo është e refuzuar.”² Atëherë si duhen kuptuar këto thënie? Çdo risi konsiderohet e ndaluar; apo fjalët e Pejgamberit tonë, paqja qoftë mbi të, synojnë ato risi që dalin jashtë kornizave të Islamit dhe bazave të tij dhe që e dëmtojnë atë? Për ta kuptuar më mirë këtë çështje të rëndësishme fillimisht duhet të njihemi me nocionin “bidat”.

Përkufizimi i bidati dhe llojet e tij

Para së gjithash, risi në konceptin fetar do të thotë: “Çdo gjë e re për të cilën nuk dëshmon asnjë argument i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.”³ Po ta shohim me kujdes, ky përkufizim nuk është larg atij etimologjik, i cili e përkufizon risinë “Me diçka që nuk ka shembull paraardhës”⁴. Allahu i Lartmadhëruar, në Kur'anin Famëlartë, thotë: “Thuaj: unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju...”⁵ Dallimi i vetëm është se në konceptin fetar, ajo i atribuohet fesë, ndërsa në atë gjuhësor përfshihet kuptimi fetar e më gjerë. Ndoshta

1. Muslimi, nr. 867, shtëpia botuese Selam, viti i botimit 1998, Rijad.

2. Buhariu, nr. 2697, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad dhe Muslimi 1718, shtëpia botuese Selam, viti i botimit 1998, Rijad.

3. Ibnul Haxher el Askalanij, Fet'hul Barij, vëll. 13 f. 312, shtëpia botuese Selam, viti i botimit 1997, Rijad.

4. Ibn Mendhur, Lisanul arab, vëll. 1, f. 229, shtëpia botuese Mearif, pa vit botimi, Kajro, El Fejumij, Misbahul muniyr, vëll 1, f. 53, shtëpia botuese Kalem, pa vit botimi, Bejrut.

5. Kur'an, El Ahkaf, ajeti 9.

përkufizimin më të qartë e jep imam Shafiu, i cili thotë: “Risitë janë dy llojesh: risi të cilat kundërshtojnë Kur’anin, hadithin, thënien e dikujt nga shokët e Profetit, ose konsensusin e dijetarëve. Këto konsiderohen risi që të devijojnë dhe të çojnë në humbje. Lloji i dytë janë ato vepra të mira të shpikura, por që nuk kundërshtojnë diçka nga ato që u përmendën. Këto nuk janë të përçmuara.”⁶ Imam Neveviu thotë: “Risitë janë çdo gjë që nuk ka ekzistuar në kohën e Profetit. Ato ndahen në dy pjesë: të pranuar dhe të refuzuara.”⁷ Përkufizime të ngjashme me ato që u përmendën më lart, por që në thelb synojnë të njëjtën ndarje, kanë dhënë edhe Imam Khatabij (399h), Ibn Abdil Berr (463h), Imam Gazaliu (505h), Abdurrahman Ibnul Xheuzij (597h), Ibnul Ethijr (630h), Ebu Shameh (665h), Ebul Fet’h El Ba’lij El Hanbelij (708h), El Kermanij (768h), Es-Subkij (771h), El Hafidh Ibnul Haxher el Askalanij (852h), Bedrudin el Ajni (885h), Xhelaludin es-Sujutij (911h), Ed-Dehleuij (1176h), Es-San’anij (1182h), Ibn Abidiyn (1252h), Abdullah ibn Sid-dijk El Gumarij (1413h) e me dhjetëra e dhjetëra të tjerë. Por nëse Profeti, pagja dhe begatia e Zotit qofshin mbi të, në thënien e tij nuk bën një ndarje si ajo që pamë nga citimet e mësipërme, atëherë si

mund të kuptohet fjala e tij? Profeti a.s. nuk ka për qëllim çdo risi, sepse kjo bie ndesh me përshtatshmërinë e besimit islam në çdo kohë dhe vend, por ajo që ai synon është çdo risi që cenon dhe kundërshton një prej bazave të besimit dhe nuk përfshihet në asnjërën prej rregullave dhe argumenteve të përgjithshme të Islamit. Ndërsa çdo risi, që shkon përshtat me frymën e sheriatit dhe me kriteret e tij të përgjithshme, është e pranuar. Përrjashtimi i risive të mira nga ky hadith, kuptohet nga thënia tjetër profetike: “Kush shpik në fenë tonë diçka që nuk i përket asaj (që nuk ka bazë në të), ajo (risi) është e refuzuar.”⁸ Profeti, pagja qoftë mbi të, trajton në këtë thënie, ato risi të cilat nuk kanë lidhje me Islamin dhe e dëmtojnë atë e jo çdo risi që mund të ketë origjinë, qoftë edhe tërthorazi. Atëherë kuptimi është që çdo risi, sjellje apo raport Zot-krijesë, që ka bazë në fe dhe ka lidhje me të, nuk refuzohet. Për këtë dëshmojnë fjalë të tjera të përcjella nga Profeti a.s., ku mes të tjerash qëndron: “Kush vendos një traditë (mënyrë) të re e të mirë [brenda kornizës së Islamit] ka për t’u shpërblyer për të dhe ka pjesë nga shpërblimi i çdokujt që vepron me të, pa iu pakësuar shpërblimi aspak, ndërsa kush vendos një traditë të re e të keqe ka për t’iu regjistruar si gjynah dhe do ketë pjesë nga gjynahu i çdokujt që punon me të, pa iu pakësuar ai gjynah aspak.”⁹

6. El Bejheki, Menakibu Shafij, vëll. 2, f. 469, shtëpia botuese Mektebetu Dari Turath, pa vit botimi, Kajro.

7. Nevevij, Tehdhijbul esmai ve lugat, vëll. 3, f. 36, shtëpia botuese Fejha, viti i botimit 2006, Damask.

8. Buhariu, nr. 2697, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad dhe Muslimi, nr. 4492, shtëpia botuese selam, viti i botimit 1998, Rijad.

9. Muslimi, nr. 6800, shtëpia botuese selam,

Imam Neveviu në lidhje me këtë hadith thotë: “Ky hadith i jep kuptimin (e duhur) fjalës së Profetit a.s. që thotë: ‘Çdo risi është humbje’, pra qëllimi i tij është risitë e urryera.”¹⁰ Juristë të tjerë të Islamit kanë bërë një ndarje tjetër, duke e klasifikuar bidatin në varësi të pesë gjykimeve (të njohura) sheriatike: ndalimit, të papëlqyerës, të lejuarës, obligimit dhe të pëlqyerës. Iz ibn Abdiselam thotë: “Bidat është çdo gjë që nuk ekzistonte në kohën e Pejgamberit, paqja qoftë mbi të. Ai ndahet në pesë pjesë: bidat i obliguar të kryhet, i ndaluar, i pëlqyer, i papëlqyer dhe i lejuar.

Për të kuptuar se në cilën prej kategorive bën pjesë, ai duhet të konfrontohet me rregullat e shariatit; nëse ai është pjesë e obligimeve, atëherë është obligim të kryhet; nëse është pjesë e ndalesave, atëherë është detyrë të lihet... e më pas i përmendi deri në fund të gjitha duke i ilustruar me shembuj, ku ndër të tjera përmendi: prej bidateve të obliguara është studimi i gramatikës së gjuhës arabe në mënyrë që të kuptohet fjala e Zotit dhe e pejgamberit të Tij... Angazhimi për të kuptuar fjalët e vështira të Kur’anit dhe thëniet profetike, sistemimi i rregullave të përgjithshme të së drejtës islame (usulul fikh), biografi e

viti i botimit 1998, Rijad.

10. Neveviu, *Sherh Sahijhu Muslim*, vëll. 4, f. 92, shtëpia botuese Kutubul Ilmijeh, viti i botimit 1995, Bejrut.

përcjellësve të thënieve profetike, si dhe vlerësimi i tyre. Prej bidateve të ndaluara veçojmë: bidatet e kaderive, xhebrijve, murxhive, antropomorfistëve, ndërsa nga bidatet e pëlqyera është: ndërtimi i fortifikimeve për të ruajtur kufijtë me shtetet e tjera, çdo veprim i mirë, i cili nuk është njohur në gjeneratat e para, falja e namazit të teravisë..., ndërsa nga bidatet e papëlqyera përmendet zbukurimi i xhamive (nëse nuk është e nevojshme), zbukurimi i (kopjeve të Kur’anit) Kur’anëve me ngjyrë ari ose gdhendja e kopertinës së tyre... E nga bidatet e lejuara është dhënia e dorës pas namazit të mëngjesit (sabahut) dhe pasdites (ikindisë), shumëllojshmëria në ngrënien e ushqimeve, lëngjeve, si dhe në veshjen e rrobave, zgjerimi i ndërtesave...” Po të njëjtën ndarje bën edhe imam Karafij.¹¹

Citime nga veprimet e shokëve të Pejgamberit a.s.

Ndarja e risive (bidatit) në dy pjesë ndërtohet mbi citatet dhe veprimet e shumë prej shokëve të Profetit a.s., të cilët bënë veprime (adhurime) sipas arsyetimeve të tyre konform argumenteve sheriatike, pra duke shfrytëzuar parimet e

11. El Iz ibn Abdiselam, *El kaulaidul kubra*, vll 2, f. 337-339, shtëpia botuese Kalem, viti i botimit 2000, Damask; El Karafij, *El Furuk*, vëll. 4, f. 155,156, shtëpia botuese Mektebetul Asrijeh, viti i botimit 2003, Bejrut.

Islamit, si dhe argumentet e përgjithshme të tij pa pasur nevojë që t'i ktheheshin Profetit, paqja qoftë mbi të, për çdo detaj. Abdullah bin Mes'udi thotë: "Atë që konsiderojnë myslimanët vepër të mirë ajo është e mirë te Zoti."¹² Pejgamberi a.s. pyeti Bilalin se cila është vepra më shpresëdhënëse për ty, gjatë kohës që ke qenë mysliman, sepse unë kam dëgjuar hapat e tua në xhenet? Ai i tha: "Sa herë që kam marrë abdes, ditën apo natën, kam falur namaz nafilë aq sa ka dashur Zoti."¹³ Kjo thënie nënkupton që Bilali vepronte një adhurim në kohë të caktuar pa marrë miratimin e Profetit paraprakisht, deri në kohën që ia tregoi atij. Nëse një gjë e tillë pa miratimin paraprak të Profetit, paqja qoftë mbi të, do ishte e ndaluar, atëherë ai do ta ndalonte atë me arsyen se adhurimi në një kohë të caktuar dhe në një kontekst të caktuar është i ndaluar, derisa të jepet leje nga tekstet sheriatike. Pra këtu kemi të bëjmë me një risi të mirë për të cilën nuk ka tekst specifik, por që dëshmon për argumentet e përgjithshme sheriatike, që nxisin për t'u afruar me Zotin e gjithësisë me namaz nafilë. Hubejbi, shoku i Profetit, kapet rob dhe para se ta ekzekutonin kërkon që të falë dy rekate namaz. Pasi u fal u ekzekutua.¹⁴ Më pas njerëzit këtë veprim të Hubejbit e konsideruan traditë të

pëlqyer, ndërkohë që ishin në situatë të ngjashme. Kjo ngjarje na tregon se Hubejbi veproi një adhurim në një moment të caktuar, për të cilin nuk kishte miratim sheriatik paraprak, por që futej në konceptin e gjerë të veprës së mirë, pavarësisht se Profeti e miratoi atë me heshtjen e tij, pasi Hubejbi kishte ndërruar jetë. Ndoshta nga argumentet më të spikatura është ndodhia e mbledhjes së Kur'anit në kohën e Ebu Bekrit fillimisht në fletushka dhe më pas në kohën e Othmanit, në libër. Sikundër është e njohur, Allahu ka marrë përsipër që ta ruajë Kur'anin ku thotë: "Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe Ne do ta ruajmë atë."¹⁵ Atëherë mënyra e mbledhjes së Kur'anit nga shokët e Profetit në libër ishte mënyrë e re dhe konsiderohet risi, për të cilën nuk ka argument të veçantë nga tekstet sheriatike, ndërkohë që më parë përgjithësisht ai ruhej i majorizuar, ose i shkruar në fletë (pavarësisht se letra ishte e rrallë në atë kohë), lëvore pemësh, kocka kafshësh, etj. Veprimi i mbledhjes së Kur'anit në libër, ose mbledhjes së fletëve të gjitha së bashku dhe ruajtjes së tyre në një vend të caktuar, ishte paksa e sikletshme edhe në këndvështrimin e disa prej shokëve të Profetit sikundër ndodhi me Ebu Bekrin dhe Zejdin, ndërsa thanë, kur Umeri propozoi mbledhjen e tij: "Si do të bësh diçka që nuk e ka bërë Profeti, paqja qoftë mbi të?!" E ndërsa Umeri r.a. mundohej që ta bindte Ebu Bekrin duke i thënë: "Pasha Allahun, ky veprim është mirësi e madhe". Më në fund Ebu

12. Hakimi, *el Mustedrek*, vëll. 3, f. 78, shtëpia botuese el Ma'rifeh, pa vit botimi, Bejrut.

13. Buhariu, nr. 1098, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

14. Buhariu, nr. 3045, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

15. Kur'an, El Hixhr, ajeti 9.

Bekri i bindur tha: “Më pas Allahu ma qetësoi kraharorin me atë që propozoi Umeri.”¹⁶ Umeri r.a. në këtë rast me inteligjencën e tij shfrytëzoi tekstet sheriatike si dhe nevojën emergjente, që kishin myslimanët në atë kohë, për të ruajtur fjalën e të madhit Zot që të mos humbte, duke thënë se ky veprim i panjohur më parë nga Profeti, paqja qoftë mbi të, e nga dikush tjetër nga shokët e tij të nderuar është mirësi, pra, pavarësisht se është diçka e re, risi, jo vetëm që nuk cenon parimet dhe bazat e besimit islam, por njëkohësisht është e nevojshme dhe e lavdëruar, sepse ruan Fjalën e Zotit autentike nga deformimi dhe humbja. Shokët e Pejgamberit i yshtën (bënë rukje, lexim Kur’ani për shërim) kryetarit të atij fisi, të cilët nuk i mikpritën ndërkohë që i zuri nata pranë tyre.¹⁷ Leximi pikërisht i sures Fatiha dhe këndimi i saj 7 herë pa asnjë argument, ose miratim paraprak nga Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, konsiderohet risi. Këtë e vërteton fjala e Profetit kur e pyeti: “Ku e di ti që ajo vlen për yshtje?” Dijetari Abdullah Mahfudh el Hadad thotë: “Kjo tregon qartë që sahabiu nuk kishte informacion paraprak që leximi i Fatihasë vlente për yshtje. Ai veproi në këtë mënyrë duke u arsyetuar që kjo gjë nuk kundërshtonte diçka nga besimi, sepse tradita profetike miratonte çdo veprim të mirë dhe gjithashtu nuk

shkaktonte ndonjë dëm, edhe pse Profeti nuk e kishte vepruar atë.”¹⁸ Po ashtu ndodhia e namazit të teravive në muajin e Ramazanit në kohën e Umerit r.a., ndërkohë që i pa njerëzit që faleshin 2-3 vetë me një imam dhe 3-4 vetë me imam tjetër, e dikush falej vetë, ai mendoi t’i bashkonte të gjithë me një imam dhe po ashtu bëri edhe me gratë (vendosi edhe për to një imam, që të faleshin të gjitha bashkë). Kur doli një natë më pas dhe i pa myslimanët të gjithë së bashku duke u falur, u kënaq dhe tha: “Oh sa risi e mirë që qenka kjo.”¹⁹ E si mund të konsiderohet risi kjo, ndërkohë që myslimanët e kanë falur në kohën e Pejgamberit me atë këtë namaz? Ky aludim rrëzohet duke kujtuar që Pejgamberi është falur me ta dy ose tre net dhe më pas nuk u fal më nga frika se do obligoheshin ta falnin gjithmonë dhe nuk do mundnin ta realizonin, pra ai është falur spontanisht me ta dhe nuk ka dalë me qëllim në xhami për ta falur këtë namaz me xhemat. Pra caktimi nga Umeri bashkimin me një imam për të falur namaz 30 net rresht si dhe përcaktimi i tij 20 rekate teravi²⁰, është diçka e re, pra risi të cilën nuk e kishte ligjëruar dhe as nuk e kishte ndaluar më parë Profeti a.s. Po ashtu falja e 20 rekateve nga të gjithë myslimanët brez pas brezi deri në ditët tona tregon se kjo është një risi

18. Abdullah Mahfudh el Hadad Ba’levij, *Es-sunetu vel Bid’atu*, f. 17, botim i cili nuk citon shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit.

19. Buhariu, nr. 2010, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

20. Maliku, *Munata*, nr. 250, shtëpia botuese Safa, viti i botimit 2001, Kajro.

16. Buhariu, nr. 4986, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

17. Buhariu, nr. 2276, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

e mirë dhe që nuk konteston asnjë bazë të besimit tonë. Laxhlaxhi, shoku i Profetit a.s., u thotë bijve të tij: “Kur të vdes dhe pasi të më vendosni në varr, thoni: ‘Bismilah, sipas traditës së Pejgamberit’ dhe pasi të më keni mbuluar me dhe, lexoni pranë kokës sime ajetet e para të sures Bekare dhe dy ajetet e fundit të saj, sepse unë kam dëgjuar Abdullah ibn Umerin që e shikonte këtë veprim të pëlqyer.”²¹ Ajo që të shkon ndërmend është që Abdullah ibn Umeri dhe Laxhlaxhi porositen që të veprohej diçka që nuk e ka vepruar e as ka këshilluar Pejgamberi a.s., por kjo në asnjë mënyrë nuk kundërshton ndonjë argument sheriatik, qoftë ai specifik, për situatën në fjalë, apo edhe të përgjithshëm. Ebu Hurejra r.a. bënte istigfar 12 mijë herë në ditë ndërkohë që pejgamberi bënte 70-100 herë.²² Abdullah bin Mes’udi falte 4 rekate namaz para namazit të xhumasë dhe 4 pas saj dhe urdhëronte nxënësit e tij që të vepronin në të njëjtën mënyrë.²³ Aliu dhe Abdullah ibn Umeri r.a. mendonin se nuk kishte diçka që quhej namaz i duhasë. Kur iu tregua Aliut r.a. që njerëzit e falnin atë, ai tha: “Faluni sa të mundeni, sepse Allahu nuk dënon dikë pse është falur.”²⁴ Salim, djali i Abdullah

ibn Umerit i ka thënë të atit: “Nuk të kam parë të falesh namazin e Duhasë!!” Ai u përgjigj: “Nuk e kam parë Profetin a.s. që ta falë atë.”²⁵ Po ashtu thoshte: “Nuk e kam falur asnjëherë namazin e duhasë që kur kam pranuar Islamin.”²⁶ Gjithashtu thoshte: “Këtë namaz nuk e ka falur njeri (që nga koha e Profetit) deri sa u vra Othmani, njerëzit nuk kanë shpikur diçka më të mirë se kjo.”²⁷ Kjo thënie nënkupton se Abdullah ibn Umeri nuk besonte se kishte në Islam një falje (namaz) që quhej namazi i duhasë, por ai e shikonte të lejuar këtë risi dhe të pëlqyer gjithashtu që të veprohej në një kohë të caktuar të ditës, sepse ajo nuk cenon ndonjë bazë të Islamit ose e kundërshton atë. Duke iu referuar asaj që thamë, kuptojmë se ajo që përcillet nga Abdullah ibn Umeri se, “Çdo risi është humbje dhe e urryer edhe nëse e konsiderojnë njerëzit të mirë.”²⁸ Qëllimi i tij është risitë e urryera dhe të ndaluara të cilat kundërshtojnë bazat e Islamit dhe nuk dëshmon për to asnjë argument.

4865, shtëpia botuese Mektebul Islami, viti i botimit 1983, Bejrut.

25. Musanefi i Abdurrezakut, vëll. 3, f. 81, nr. 4877, shtëpia botuese Mektebul Islami, viti i botimit 1983, Bejrut.

26. Musanefi i Abdurrezakut, vëll. 3, f. 81, nr. 4879, shtëpia botuese Mektebul Islami, viti i botimit 1983, Bejrut.

27. Musanefi i Abdurrezakut, vëll. 3, f. 78, nr. 4868, shtëpia botuese Mektebul Islami, viti i botimit 1983, Bejrut.

28. Lalekai, *Sherh Usulul I'tikad*, vëll. 1, f. 126, shtëpia botuese Tajbeh, viti i botimit 2002, Rijad dhe Ibn Nasr el Mervezij, *es-Suneh*, f. 29, nr. 82, shtëpia botuese Muesesetul Kutubi eth-Thekafijeh, vitit i 1988, Bejrut.

21. El Bejhekij, *Sunenul Kubra*, vëll. 4, f. 56, shtëpia botuese El Ma'rifeh, pa vit botimi, Bejrut.

22. Dhehebij, *Tedbkiretul hufadh*, vëll. 1, f. 35, shtëpia botuese Fikrul Arabij, pa vit dhe vend botimi.

23. Musanefi i Abdurrezakut, vëll. 3, f. 247, nr. 5524, 5525, shtëpia botuese Mektebul Islami, viti i botimit 1983, Bejrut.

24. Musanefi i Abdurrezakut, vëll. 3, f. 78, nr.

Në ditën e xhuma, në kohën e Profetit a.s., të Ebu Bekrit dhe Umerit, ezani këndohej para se të hipte imami në minber për të mbajtur ligjëratën, ndërsa në kohën e Othmanit ai urdhëroi që të thirrej një ezan tjetër (pra shtoi një tjetër) para se të hynte koha e namazit të xhumasë dhe kështu vazhdoi edhe më pas.²⁹ Kjo tregon se Othmani e shikonte të lejuar shpikjen (sajimin) e një adhurimi (sepse ezani konsiderohet adhurim), i cili ishte i dobishëm dhe nuk kundërshtonte ndonjë bazë të besimit islam. Dhe këtë ai e bëri për shkakun e vetëm që t'u jepte njerëzve mundësinë që të përgatiteshin për namazin e xhumasë para se të hynte koha e namazit dhe njëkohësisht që tregtia e tyre të mos i shkujdeste nga koha e faljes.

Nëse Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, ose shokët e tij kanë lënë diçka pa bërë a konsiderohet bidat veprimi i saj?

Një nga argumentet kryesore që dëgjojmë shpesh prej atyre që çdo risi e konsiderojnë gjynah dhe humbje, është koncepti që, nëse Pejgamberi a.s. nuk e ka vepruar diçka, atëherë veprimi i saj konsiderohet i ndaluar dhe risi (bidat). Kjo është nga gjërat më të çuditshme që mund të thuhet për këtë çështje. Jo çdo gjë që nuk e ka vepruar Profeti a.s. konsiderohet e ndaluar, qoftë ai edhe adhurim, nëse ai nuk ka ndaluar nga veprimi i tij. Arsytet që mund të kenë shtyrë Profetin, paqja qoftë mbi të, për

të lënë një veprim janë nga më të ndryshmet³⁰, mes tyre:

1- Lënia e gjërave të lejuara në origjinë, si p.sh. ushqimet, lëngjet etj. Askush nuk mund të mendojë se konsumimi i tyre është i ndaluar, për shembull: sikundër ai nuk e hëngri kurrë mishin e një zvarraniku (dabit).³¹

2-Lënia e një adhurimi si p.sh. leximin e sures Ikhlas në çdo rekat të namazit siç vepronte një nga shokët e tij prej ensarëve,³² ose lënia e tij (një adhurimi), por ndërkohë ka nxitur shokët e tij për ta vepruar atë ose i ka miratuar, si p.sh. nxitjen për të bërë dhikret (lutje të shumta) pavarësisht se nuk i përmbahej të gjithave.

3- Lënia nga frika se ndonjë adhurim bëhej obligim për popullin (bashkësinë) e tij, si p.sh. namazi i teravive,³³ etj.

4- Lënia për shkak të harresës sikundër i ka ndodhur në disa raste gjatë namazit.³⁴

5- Lënia duke mos i shkuar në mendje veprimi i diçkaje në veçanti, si p.sh. ligjërimi i tij në ditën e xhuma

30. Abdullah Sidijk el Gumarij, *Husnu tefehumi ve derke li mes'eleti derke*, f. 10, shtëpia botuese Mektebetul Kahireh, viti i botimit 2002, Kajro.

31. Buhariu, nr. 5536, 5537 shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

32. Buhariu, nr. 774 shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

33. Buhariu, nr. 2012, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

34. Buhariu, nr. 482, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

29. Buhariu, nr. 912 shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

i mbështetur te trungu i një palme. Më pas shokët e tij i sugjeruan që të vendoste një podium me disa shkallë.³⁵

6- Lënia e një veprimi për arsye se populli i tij ishte i ri në Islam dhe nuk mund ta suportonte atë, siç tregohet për dëshirën që kishte për të rindërtuar Qaben sipas modelit që e kishte ndërtuar Ibrahim i a.s.³⁶

Pra, siç shihet jo çdo gjë që Pejgamberi e ka lënë pa e vepruar, konsiderohet e ndaluar. Natyrisht që askush nuk mund të pretendojë e të shpikë (sajojë) adhurime nga mendja e tij, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me besimin islam e nuk i nënshtrohen argumenteve sheriatike, qofshin të drejtpërdrejta ose të tërthorta, si p.sh. të shtojë një rekat më shumë në një prej namazeve të obliguara, të obligojë agjërimin e 6 ditëve të muajit Sheval, agjërimi i të cilave është i pëlqyer, të obligojë ose të konsiderojë të pëlqyer qëndrimin në Mina në ditën e katërt, kur dihet se Allahu në Kur'an tregon se qëndrimi në të është dy ditë ose tre dhe jo më shumë.³⁷ Por, në të njëjtën kohë askush nuk mund të privojë veten apo të tjerët nga përkushtimi ndaj Zotit me adhurime, lutje, përmendje (dhikër) etj., nëse për to dëshmojnë tekstet fetare, pavarësisht nëse

nuk janë të drejtpërdrejta, por që i përmbahen kornizave të besimit dhe burimeve autentike të sheriatit. Mund të thuhet gjithashtu se çdo veprim që kryen njeriu, nuk mund të jetë jashtë pesë gjykimeve të sheriatit për të, veprim i ndaluar, i papëlqyer, i obliguar, i pëlqyer dhe i lejuar; ndërsa lënia nuk i nënshtrohet asnjërës nga këto pesë gjykimeve të sheriatit.

Ibn Hazmi, juristi i shkollës së dhahirive, teksa trajton çështjen e faljes së dy rekateve nafle para namazit të akshamit, si dhe kritikën drejtuar juristëve të shkollës së hanefive dhe malikive, të cilët argumentojnë se ky veprim është i papëlqyer me thënien e Ibrahim en-Nekhaiut se Ebu Bekri, Umeri dhe Othmani nuk e kanë vepruar, thotë: “Edhe nëse është e vërtetë se ata nuk e kanë falur, kjo nuk vlen si argument, sepse ata nuk kanë ndaluar nga ky veprim.”³⁸

Pra, si përfundim, mund të thuhet se lënia thjesht e një veprimi nga Profeti a.s. nuk mund të konsiderohet argument për të ndaluar veprimin e saj pa u shoqëruar me argument tjetër përkatës, që e ndalon atë, por mund të thuhet se një veprim i tillë është i lejuar. Nëse do të meditojmë në argumentet e sheriatit si dhe rreth thënieve të juristëve myslimanë, do të dalim në përfundimin se në përgjithësi bidatet

35. Buhariu, nr. 3584, 3585, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

36. Buhariu, nr. 126, shtëpia botuese Selam, viti 1999, Rijad.

37. Kur'an, El Bekare, ajeti 203.

38. Ibn Hazm, el Muhala, vëll. 2, f. 159,160, shtëpia botuese Ihjau turathil arabij, viti i botimit 1997, Bejrut.

(risitë) e ndaluara dhe të dëmshme janë ato që kanë lidhje drejtpërdrejt me bazat e Islamit dhe futjen e diçkaje të re në to, ndërsa për sa i përket detajeve dhe çështjeve të dorës së dytë, të tretë, adhurime të cilat nuk kanë formë e sasi të caktuar, ose kanë, por nuk i përkasin adhurimeve bazë të Islamit etj., dijetarët kanë dhënë opinionet e tyre në lidhje me to, duke i konsideruar si çështje që i nënshtrohen arsytimit njerëzor, diskutimit, si dhe qasjeve të reja. Vlen të përmendet si shembull dhikri dhe lutja pas namazit farz e të gjithë njerëzve së bashku, pavarësisht se në kohën e Pejgamberit, paqja qoftë mbi të, ajo kryhej individualisht, juristët myslimanë të kohëve të vonshme e konsiderojnë një veprim të tillë të lejuar, sepse nuk cenon asnjë prej bazave dhe shtyllave të Islamit; nuk po shtohet diçka nga ajo çfarë ka vepruar Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, por po kryhet në një mënyrë në të cilën ka dobi, që lidhen me unifikimin e radhëve të besimtarëve, gjë për të cilën nxit Libri i Zotit³⁹, kurimin e sëmundjes së përçarjes, si dhe mësimin e të rinjve me mënyrën e përmendjes së Allahut (dhikrin) pas faljes së namazit. Në shumë tekste sheriatike, madje, tregohet vlera e madhe kur besimtarët përmendin Allahun së bashku. Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, një ditë kaloi pranë disa

39. “kapuni fort pas litarit të Allahut dhe mos u përçani...” Kur’an, Ali Imran, ajeti 103.

besimtarëve, të cilët po përmendnin Zotin. Ai i pyeti: - Cila është arsyeja për të cilën jeni mbledhur?

Ata i thanë: - Jemi mbledhur për të përmendur Allahun dhe mirësitë që na ka dhuruar ndërkohë që na udhëzoi në Islam.

Ai u tha: - A vetëm për këtë jeni mbledhur?

Ata i thanë: - Vetëm për këtë o Pejgamber i Zotit.

Atëherë ai tha: - Unë nuk ju pyeta se dyshoj te ju, por sepse pak më parë Xhibrili erdhi tek unë dhe më lajmëroi se Allahu krenohet me ju përpara engjëjve.⁴⁰

Gjithashtu thotë: “Kur të kaloni pranë kopshteve të xhenetit shkoni dhe merrni nga frutat e tyre. Kur u pyet se cilat janë kopshte të xhenetit, u përgjigj: “Tubimet në të cilat përmendet Allahu (bëhet dhikr).”⁴¹

Mjeti merr gjykimin e qëllimit nëse ai nuk kundërshton një urdhër fetar

Në shkencën që merret me vendosjen e rregullave, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e gjykimeve sheriatike (usulul fikh), përmendet një rregull, i cili sqaron shumë paqartësi, të cilat lidhen me çështjen e risisë (bidatit). Ai thotë: “Mjeti merr gjykimin e qëllimit”⁴², që do

40. Muslimi, nr. 6857, shtëpia botuese selam, viti i botimit 1998, Rijad.

41. Suneni i Tirmidhiut, nr. 3819, shtëpia botuese er-Risaletu el Alemijeh, viti i botimit 2009, Bejrut.

42. El Karafij, *El Furuk*, vëll. 2, f. 39, shtëpia botuese Mektebetul Asrijev, viti i botimit

të thotë se një veprim i vlerësuar nga sheriat, ose i obliguar prej tij, mund të realizohet me çdo mjet, për të cilin nuk ka tekst sheriatik që e penalizon atë (mjetin), atëherë atij i jepet i njëjti gjykim që sheriat i ka dhënë qëllimit. P.sh. nëse për burrat shkuarja ditën e premte në xhami për faljen e namazit të xhumasë është obligim, (shkuarja në xhami konsiderohet qëllim) çdo mjet që të ofron mundësinë për të shkuar atje, nëse lënia e këtij mjeti bën që të humbasë prezencën në xhami, atëherë ai është obligim të përdoret. Nëse pjesëmarrja në namazet me xhemat është e pëlqyer, atëherë çdo mjet që të jep mundësinë për të falur atë namaz me xhemat në xhami është i pëlqyer të përdoret. Imoraliteti në Islam është i ndaluar (lënia e tij konsiderohet obligim), atëherë çdo mënyrë, rrugë apo mjet që të dërgon drejt tij është detyrë të lihet. Nëse numërimi i dhikrit pas namazit bëhet i vështirë për shkak të harresës ose mos përqendrimit, atëherë çdo mjet që të jep mundësinë për ta kryer atë saktësisht është jo vetëm i lejuar, por edhe i pëlqyer, etj. Kështu pra,

2003, Bejrut; Et-Tufij, Sherh mukhtesar er-reuda, vëll. 3, f. 89, shtëpia botuese Muesesetu Risaleh, viti i botimit 2011, Bejrut.

gjykohet për çdo çështje dhe veprim për të cilin nuk ka tekst sheriatik për t'u vepruar apo lënë; të gjitha mjetet që të japin mundësinë për të arritur qëllimin janë të pëlqyera, të obliguara të veprohen, ose të lihen, kjo në varësi të veprimit përkatës.

Përfundim

Nga ajo që u përmend më lart, kuptohet qartë koncepti i dijetarëve të Islamit, përgjithësisht, në lidhje me çështjen e risisë (bidatit), ide e cila është keqkuptuar, keqinterpretuar dhe injoruar shpesh nga studiues dhe autodidaktë gjithashtu, të cilët kanë krijuar një klimë konfliktuale. Prej tyre minimalisht kërkohet një heshtje ndaj lëshimit të akuzave, llagapeve dhe etiketimeve me gjasë se të gjithë ata që nuk mendojnë si ata, kanë devijuar nga rruga e Zotit dhe janë të rrezikuar të dënohen nga Ai në jetën e amshueshme për çështje të cilat i nënshtrohen arsytimit njerëzor. Debati konstruktiv është ai që i hap rrugën mirëkuptimit dhe justifikimit të mendimit ndryshe, e për rrjedhojë, unifikimit dhe vëllazërimit të besimtarëve, veprim i cili kënaq Zotin e gjithësisë, Profetin e Tij të nderuar e të gjithë besimtarët gjithashtu. Allahu e di më së miri.

Të mësuarit e normave civile në medresetë e Shqipërisë

**Dr. Genti Kruja, Universiteti “Bedër”,
Prof. Asoc. Dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës,
Dr. Robert Gjedia, Universiteti “Marin Barleti”**

Abstrakt

Kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar zhvillohet me anë të lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetari” dhe synon formimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave qytetare te nxënësit e këtij cikli arsimor, duke u mbështetur fort te filozofitë, praktikat e mira dhe modelet e qytetarisë evropiane dhe botës demokratike në veçanti, ku në thelb të tyre mbeten të drejtat dhe përgjegjësitë individuale, zbatimi i ligjit, kujdesi ndaj mjedisit, e drejta për punësim, siguria njerëzore dhe bashkëjetesa në komunitet. Përmbajtja e lëndëve të përmendura më lart nuk prek asnjë informacion ose praktikë edukimi, që lidhet me çështje të mësimit dhe edukimit fetar. Gjithashtu ky edukim ka një vend të posaçëm në kurrikul, që është i mjaftueshëm për të realizuar synimet dhe kompetencat e dëshiruara për nxënësit, kur kemi parasysh sasinë e orëve, peshën specifike të fushës kurrikulare, por edhe të lëndëve të mirëfillta të formimit qytetar që zhvillohen në të tria ciklet e arsimit parauniversitar, e krabasuar edhe me kurrikulat e sistemeve arsimore evropiane.

Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por gjithashtu kanë dhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila edhe kjo miratohet nga Ministria e Arsimit.

Lëndët fetare janë integruar në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Megjithatë njeriu që jeton në sistemin demokratik ka shumë përputhje me besimtarin (pavarësisht përkatësisë fetare), tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

Hyrje¹

Medresetë në Shqipëri kanë një traditë shekullore. Ato u themeluan shumë shpejt pas pranimit të Islamit nga shqiptarët që në shek. XV-XVI, vazhduan funksionin e tyre edhe pas shpalljes së pavarësisë, por, të përballura me vështirësi ekonomike, didaktike dhe arsimore, pa një kontroll qendror. Ato nuk kishin një plan-program, por vazhdonin të jepnin mësimdhënie me plan-programin e shumë viteve më parë.² Sipas informacioneve, që kalojnë në revistën e parë zyrtare të Komunitetit Mysliman Shqiptar *Zani i Naltë*, në muajin prill 1927, gjendeshin 12 medrese në qytetet: Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Kavajë, Durrës, Tiranë, Krujë, Shijak, Peqin, Elbasan, Korçë dhe Berat, të cilat vazhdonin funksionin e tyre.³ Krahas këtyre kishte edhe shumë mejtepe (kurse mësimore), pranë xhamive, që drejtoheshin kryesisht nga imamët e xhamive.

1. Ky studim është kryer në bazë të projektit “Të mësuarit e normave civile në shkollat e Fesë Islame - medresetë”, nga Forumi Shqiptar për Aleancën e Qytetërimeve, Tiranë, 2017.

2. Basha, Ali M., “Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë 2011: 174.

3. Vuçiterni, Salih, “Nji pergjigje Z. Hafis Xhaferit”, Kolana “Zani i Naltë; Vëllimi i Dytë, vitet 1926-1927-1928, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, 2015: 274-275.

Për shkak të mendimit se medresetë, që ekzistonin nuk u përgjigjeshin nevojave të kohës, u pa e arsyeshme hapja e medreseve me një stil të ri. Kështu, Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve iu propozua nga Këshilli i Naltë i Sheriatit formimi i një medreseje të re në Tiranë dhe më 2 qershor të vitit 1923, në Kongresin e Parë të Myslimanëve Shqiptarë, u mor vendimi për formimin e Medresesë së Naltë në Tiranë.⁴ Në numrin e tretë të revistës *Zani i Naltë* të vitit 1923, në nenin 9 të rregullores së medresesë përcaktohej se medreseja do të përbëhej nga tre kategoritë vijuese: “Kategorija fillestarë e medreses asht 3 vjet, mesatarja 5, dhe e nalta 4 vjet”.⁵ Pra Medreseja do të ishte edhe si një shkollë e lartë, por për arsye financiare nuk u arrit që ajo të ishte një Institut i Lartë, duke qenë ndoshta edhe i pari universitet në trojet shqiptare. Megjithatë, këtu mbetet për t’u vlerësuar iniciativa, guximi dhe largpamësia intelektuale e drejtuesve të Komunitetit Mysliman Shqiptar të atyre viteve me në krye dijetarë të tillë si: Haxhi Vehbi Dibra e Hafiz Ali Korça.

Vendimi për hapjen e Medresesë

4. Basha, 2011: 93.

5. Kruja, Genti, (editor), “Rregullore mbi Medresen e Myslimanve”, *Zani i Naltë*, vëllimi i parë, vitet 1923-1924/-1925, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, Tiranë, 2014: 87.

së Tiranës u pranua edhe nga ana e qeverisë shqiptare të asaj kohe. Medreseja e Tiranës e filloi aktivitetin e saj nën emrin *Medreseja e Naltë*. Sipas vendimit të marrë në Kongresin e III të Myslimanëve Shqiptarë të mbajtur në vitin 1929, u mbyllën të gjitha medresetë e tjera, me përjashtim të medresesë së Tiranës. Për shkak këtij vendimi, emri i medresesë së kryeqytetit u ndryshua, duke u emërtuar si *Medreseja e Përgjithshme*.⁶ Sipas nenit 57 të statutit të Kongresit të III Medreseja e Përgjithshme përfshin vetëm 2 kategori, atë të unikes dhe të mesmes.⁷

Ndërtesa e bërë për Medresenë e Tiranës përfundoi në vitin 1931. Ajo brenda disa vitesh u bë një institucion serioz, që ndihmoi në formimin e identitetit kombëtar dhe fetar të nxënësit. Medreseja, qysh nga fillimi i edukimit, zbatoi një program bashkëkohor. Në programin, që ndiqte medreseja iu dha përparësi disa lëndëve që lidheshin me kulturën e përgjithshme, si gjuha dhe letërsia, ashtu siç ndodhte edhe në shkollat shtetërore.⁸

Cilësia e mësimdhënies në medrese nuk lidhej vetëm me një shkak, apo me disa lëndë, por lidhej me të gjitha lëndët, që gjendeshin në program dhe kjo gjendje sillte si rezultat rritjen e nivelit shkencor dhe atij kulturor-fetar të nxënësve. Feja

islame në të njëjtën kohë zbret në problemet e edukimit dhe kështu ka dhënë ndihmën e saj në formimin e nxënësve, të cilët bashkë me moralin islam marrin edhe moralin e të qenët një bashkëqytetar i mirë.⁹

Menjëherë pas instalimit të komunizmit në Shqipëri në vitin 1944, filloi edhe presioni e persekutimi ndaj prijësve fetarë, duke u arrestuar e burgosur shumë hoxhallarë dhe mësues të medresesë së Tiranës. Duke vazhduar procesin e edukimit nën kushte të vështira, në vitin 1964 medreseja u mbyll përfundimisht¹⁰. Ndërkohë, në vitin 1967, u ndaluan të gjitha besimet fetare me ligj dhe u mbyllën komunitetet fetare dhe veprimtaritë e tyre. U shkatërruan mbi 1.000 xhami, kisha, teqe dhe varreza. U sekuestruan bibliotekat e të gjithë klerikëve, ku shumica e librave u dogjën dhe u asgjësuan. Kjo frymë ateiste, vazhdoi deri në vitin 1990.

Komuniteti Mysliman, i cili qe mbyllur në vitin 1967, u riinstitucionalizua edhe njëherë për të vijuar veprimtarinë e tij në vitin 1991.¹¹

Me riinstitucionalizimin e Komunitetit Mysliman u hap

9. Balla, Xhemal, "Haxhi H. Mahmut Dashi, jeta dhe vepra 1873-1961", Tiranë: West Print. 2010: 60-61.

10. Po aty, 2011: 539.

11. Zaimi, Ali & Kruja, Genti (editorë), "Katalog i Veprimtarisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, botimet KMSH, Tiranë, 2014: 9.

6. Basha, 2011: 93.

7. Po aty, 215.

8. Basha, 2011: 99.

sërish Medreseja e Tiranës, e cila u ndoq prej hapjes së Medresesë së Shkodrës. Ndërsa në vitet pasardhëse u hapën medrese në Durrës, Kavajë, Berat, Korçë dhe Elbasan (ndërsa medresetë e hapura në Gjirokastrë, Kukës dhe Peshkopi janë mbyllur pas disa vitesh funksionimi).

1. Statuset zyrtare të medreseve në Shqipëri

Sipas pikës së parë të nenit 7 të ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, thuhet: “Arsimi parauniversitar është laik”, dhe ndërsa shprehet kështu, në pikën e dytë të të njëjtit nen, shkruhet: “Përjashtim bëjnë ato institucione arsimore, që themelohen nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të këtij ligji” (Ligji nr. 69/2012, neni 7/1, 7/2).

Po në të njëjtin ligj, në pikën e katërt të nenit 42, shprehet: “Institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare, ose që themelohen, apo administrohen nga bashkësitë fetare, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave” (Ligji nr. 69/2012, neni 42/4).

Sipas burimeve arkivore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, lejimi i hapjes së medreseve me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe me statusin e shkollave jopublike, ka nisur në vitin 1995. Në vendimin nr. 654, të datës 29.11.1995, shprehet se u është dhënë leje e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë; Medresetë zhvillojnë kurrikulën zyrtare për ciklet e arsimit parauniversitar, por gjithashtu kanë dhe pjesën e kurrikulës me orientim fetar, e cila edhe kjo miratohet nga Ministria e Arsimit.

Lëndët fetare janë integruar në kurrikulat zyrtare të medreseve në mënyrë të tillë që të jenë mbështetëse edhe të tematikave të trajtuara nga lëndët e edukatës qytetare. Meqenëse njeriu që jeton në sistemin demokratik ka shumë përputhje me besimtarin (pavarësisht përkatësisë fetare), tematikat e përbashkëta të këtyre lëndëve janë të shumta.

Lëndët fetare që zhvillohen në medresetë e ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm të lartë janë “Kur’ani Famëlartë - Komentimi i tij”, “Tradita profetike dhe Kultura Islame”, “Njohuri Besimi e Kulture Islame”, “Njohuri të Traditës Profetike e Predikim”, “Njohuri të Adhurimit Islam”, “Modul Profesional: Civilizim Islam”, “Njohuri të Traditës Profetike dhe të Predikimit”, “Besimi”, “Edukatë Islame”.

Ndërsa, sipas vendimit nr. 560, i datës 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, u jepet leja (licenca) për kryerjen e veprimtarive mësimore medresesë “Mahmud Dashi” në Tiranë, medresesë “Hafiz Ali Korça” në Kavajë, medresesë “Liria” në Cërrik, medresesë “Hoxha Tahsin” në Gjirokastrë dhe medresesë “H. Sheh Shamia” në Shkodër.¹² Pesë medreseve të tjera, asaj “Mustafa Varoshi” në Durrës, medresesë “Vexhi Buharaja” në Berat, medresesë “Sulejman Laçi” në Kukës, medresesë “Raif Kadiu” në Peshkopë dhe medresesë së Korçës, u kërkohet që të mos marrin nxënës të rinj, por u lejohet kryerja e veprimtarive arsimore gjer në maturimin (diplomimin) e nxënësve të marrë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7952, të datës 21.6.1995.¹³

Megjithëse medresetë kryejnë veprimtarinë e tyre arsimore prej vitit 1991, dhënia e lejeve, të përkohshme, apo të vazhdueshme në periudhën 1995-1996, tregon se ato i kanë kryer veprimtaritë e tyre bazuar në lejen fillestare, që u është dhënë prej autoriteteve.

Medresesë “Vexhi Buharaja” në Berat i rijepet leja e funksionimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 248 datë 28.05.1999. Në të njëjtën

mënyrë edhe medresesë “Mustafa Varoshi” në Durrës i rijepet leja e funksionimit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 653 datë 29.12.1999, ndërsa përsa i përket medresesë “Abdullah Zëmbllaku” në Korçë, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 04.12.2002 i jepet licenca për arsimin e mesëm, kurse për kryerjen e veprimtarive arsimore të arsimit 9-vjeçar u është dhënë licenca me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1067, datë 21.10.2009.¹⁴

Sot, medresetë e Gjirokastrës, Kukësit dhe Peshkopisë nuk i vazhdojnë veprimtaritë e tyre. Sipas burimeve të KMSH-së, Medreseja e Gjirokastrës, megjithëse është e licencuar, për shkak të pamundësive financiare, nuk i vijon veprimtaritë e saj arsimore qysh prej vitit 2009, kurse medreseja e Kukësit dhe e Peshkopisë, për shkak se nuk janë të licencuara, kanë rreshtur se kryeri veprimtarinë e tyre që në vitin 1996, me përjashtim të nxënësve, që ishin në proces mësimi gjer në diplomimin e tyre.

Sot janë gjithsej 7 medrese, që vijnë veprimtaritë e tyre arsimore edukative në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Durrësit, Kavajës dhe Beratit. Sponsorizimi i medreseve të Tiranës, Korçës, Beratit, Elbasanit dhe Kavajës bëhet nga Fondacioni “Sema”, ndërsa medreseja e Shkodrës bëhet nga Fondacioni

12. Kutlu, Adil, “Perceptimi i prindërve lidhur me edukimin fetar në Shqipëri: rasti i medreseve”, tezë doktrature, UET, Tiranë, 2016: 169.

13. Po aty.

14. Po aty.

“Istanbul” dhe ajo e Durrësit nga Fondacioni “Mirësia”. Për sa i përket strukturës administrative të medreseve, ato administrohen sipas protokolleve të parashikuara prej Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe fondacioneve respektive, ndërkohë që drejtorët e shkollave përzgjidhen nga KMSH, fondacionet mbështetëse kanë të drejtën e emërimit të një koordinatori.

2. Informacione të përgjithshme rreth medreseve

Në vijim, në bazë të burimeve të përftuara prej drejtorive të secilës prej medreseve, do të rrekemi të japim një informacion të përmbledhur në lidhje me secilën prej tyre, duke marrë si bazë vitin shkollor 2015-2016 dhe 2016-2017 (aktual).

2.1. Medreseja “Haxhi Mahmud Dashi”, Tiranë

Në organigramën e medresesë së Tiranës bëjnë pjesë të gjithë përbërësit e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, si për vajza ashtu edhe për djem, që nga klasa e gjashtë. Vetëm se, nxënësit e arsimit të mesëm, djem dhe vajza, strehohen në konvikte të ndryshme, ndërsa nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë ndjekin vetëm procesin mësimor gjatë ditës. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit shkollor 2015-2016 ishte 445 nxënës (207

djem, 238 vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 416 (178 djem, 238 vajza) nxënës gjithsej.

2.2. Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër

Edhe medreseja e Shkodrës, po ashtu, përbëhet prej programesh të arsimit 9-vjeçar dhe atij të mesëm. Ndërkohë që shkolla 9-vjeçare nis nga klasa e gjashtë deri në të nëntën, shkolla e mesme përbëhet nga klasa e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë. Në medresenë e Shkodrës ofrohen kushte të ndara strehimi, si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Nxënësit nga klasa e gjashtë deri në të nëntën ndjekin vetëm procesin mësimor gjatë ditës. Numri i nxënësve të regjistruar për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 1068 (425 djem, 643 vajza) nxënës gjithsej.

2.3 Medreseja “Liria”, Elbasan

Medreseja “Liria” në Elbasan është një shkollë e mesme, ku studiojnë vetëm nxënës djem. Medreseja “Liria” në Elbasan, nga viti 1995 kur ka nisur aktivitetin e saj, deri në vitin 2012-2013, ka qenë e vendosur në Cërrik, ndërsa prej vitit 2013-2014, ajo i vijon veprimtaritë e saj në qendër të qytetit të Elbasanit. Kjo medrese ofron edhe kushte akomodimi në konvikt për nxënësit, që zgjedhin të vijnë nga rrethet. Në

fund të vitit shkollor 2015-2016, ky institucion ka pasur gjithsej 151 nxënës, ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 numëron 144 nxënës gjithsej.

2.4. Medreseja “Hafiz Ali Korça”, Kavajë

Medreseja e Kavajës, e cila e nisi aktivitetin e saj arsimor-edukativ si një shkollë e mesme jopublike vetëm për nxënës djem, prej vitit shkollor 2012-2013 nisi të arsimojë edhe nxënës vajza, por në një tjetër godinë. Kjo medrese nuk përfshin nxënës të arsimit 9-vjeçar. Ajo ofron kushte strehimi në konvikt më tepër për nxënësit që vijnë nga jashtë Kavajës, si për djem ashtu edhe për vajza. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit arsimor-akademik 2015-2016 ishte 253 nxënës (116 djem, 137 vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 258 (121 djem, 137 vajza) nxënës gjithsej.

2.5. Medreseja “Hafiz Abdullah Zëmplaku”, Korçë

Medreseja e Korçës, e cila që mbyllur për një periudhë kohe, pas vitit 2009 rinisi veprimtarinë e saj si shkollë e mesme jopublike për djem dhe vajza. Megjithatë kjo shkollë ka ofruar edhe arsim 9-vjeçar, sot ajo nuk ka nxënës të ciklit të ulët. Edhe ajo ofron kushte të njëjta strehimi në konvikt për djemtë dhe vajzat

që vijnë nga rrethet apo edhe nga brenda Korçës. Numri i nxënësve të regjistruar në fund të vitit shkollor 2015-2016 ishte 273 nxënës (101 djem, 172 vajza), ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 271 (112 djem, 159 vajza) nxënës gjithsej.

2.6. Medreseja “Haxhi Mustafa Varoshi”, Durrës

Medreseja e Durrësit, që dikur ka pranuar edhe nxënës djem, sot është një shkollë e mesme që u drejtohet vetëm vajzave. Veç kësaj, ndryshe nga medresetë e tjera, ajo gjendet në qendër të qytetit të Durrësit, por nuk ofron kushte akomodimi në konvikt. Në fund të vitit shkollor 2016-2017 në të ka pasur të regjistruar gjithsej 105 nxënës.

2.7. Medreseja “Vexhi Buharaja” në Berat

Medreseja e Beratit është një institucion i arsimit të mesëm, në të cilin arsimohen vetëm nxënës djem. Kjo medrese, e cila pranon nxënës edhe nga jashtë qytetit, ofron kushte të strehimit të nxënësve në konviktin e vetë shkollës. Në fund të vitit shkollor 2015-2016 numri i nxënësve të regjistruar ka qenë gjithsej 64 nxënës, ndërsa për vitin aktual mësimor 2016-2017 është 77 nxënës gjithsej.

Filozofia e medreseve të Shqipërisë sot

Filozofia e medreseve të Shqipërisë, edukimin e ka parë nga tri kënde të gërshetuara mes vete: human-psikologjik, kombëtar-social dhe universal.

Për sistemin arsimor të Komunitetit Mysliman sot, ndarja e të menduarit fetar nga shkencat natyrore shkon kundër frymës së Kur'anit, sepse ai e rekomandon qartë lidhjen e besimit me shkencat natyrore.

Sistemi edukativ i medreseve hapi rrugën për një epokë të re, duke ribashkuar sistemin edukativ bashkëkohor me sistemin klasik të medreseve të dikurshme. Kështu, mund të vërehet se nuk ekziston ndonjë mospërputhje apo përplasje dialektike ndërmjet shkencave natyrore dhe vlerave, qofshin ato fetare, etike, sociale apo individuale. Medresetë sot bashkojnë mendjen dhe zemrën nëpërmjet përqendrimit në një objektiv, që merr parasysh mënyrën se si duhen integruar dija dhe edukimi te njerëzit dhe te jeta sociale.

Në sistemin edukativ të këtyre shkollave, një person shihet si pjesëmarrës aktiv në proceset sociale. Shkollat i përkasin një modeli, që vendos balancën ndërmjet botës materiale dhe shpirtërore, pa e zvogëluar ndonjëherë në dëm të tjetrës, në mënyrë që të ndërtojë një

model aktiv, i tillë që është në gjendje të mbartë përgjegjësinë e dialogut kulturor dhe shoqëror.

Metodologjia

Qëllimi i studimit: Të identifikojë dhe të analizojë se si realizohet edukimi qytetar te Medresetë. Ndikimi dhe roli i të mësuarit të normave civile te shkollat fetare - medresetë.

Objektivat e studimit:

1. Shqyrtim i dokumentacionit zyrtar, kurrikular të medreseve, por dhe i kurrikulës shtetërore për formimin qytetar.
2. Tryeza pune të ekipit që menaxhoi, zhvilloi dhe hartoi këtë studim
3. Fokus grupe me drejtuesit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor 2016)
4. Pyetësorët për mësuesit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor, 2016)
5. Pyetësorët për nxënësit e të shtatë medreseve në Shqipëri (shtator-tetor, 2016)
6. Përpunim statistikor i gjetjeve (nëntor-dhjetor, 2016)
7. Paraqitje e gjetjeve dhe rekomandimeve te grupet e interesit, që janë të interesuar për trajtimin e çështjeve të edukimit qytetar nëpërmjet lëndëve fetare në shkolla 9-vjeçare, shkolla të

mesme, specialistë të edukimit në institucionet qeverisëse të arsimit në nivel lokal dhe qendror, por dhe nga fakultetet që përgatisin mësues.

Ky kërkim ka përdorur një nga përjasjet mikse të kërkimit shkencor, paradigmen e triangulimit bashkërendues, e cila lejon kombinimin e njëkohshëm të kërkimit sasior dhe atij cilësor. Të dyja metodologjitë u kombinuan me qëllim adresimin e çështjes kërkimore. Kjo përjasje u përzgjedh për një sërë arsyesh të cilat do të prezantohen shkurtimisht më poshtë.

Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të kërkimit

Projekti kërkimor synoi të adresonte çështjen kërkimore nga disa aspekte të ndryshme; përfshirë këtu matje të aktorëve: drejtues, stafit akademik, si dhe nxënësve të medreseve. Për këtë arsye u përdorën pyetësorët si mjetet më të mira për mbledhjen e të dhënave kur bëhet fjalë për matjen e perceptimeve mbi normat civile në shkollat fetare.

Mjetet për mbledhjen e të dhënave dhe kampioni

Të dhënat cilësore marrin trajtën e fjalëve (të folura ose të shkruara) dhe imazheve vizive (të vrojtuar ose të krijuara). Kryesisht

shoqërohen me strategji studimi, si studim i rastit, teori fushe, etnografi dhe fenomenologji, dhe me metodat kërkimore, si intervista, dokumente dhe vëzhgime. Të dhënat cilësore sidoqoftë mund të përftohen edhe ndryshe. Për shembull, përdorimi i pyetjeve me fund të hapur, si pjesë e një pyetësi sondazh, mund të japë përgjigje në formë teksti - fjalë të shkruara që mund të trajtohen si të dhëna cilësore.

Intervistat janë një sugjerim tërheqës për studiuesit e projektit. Në shikim të parë, ato nuk duket se përfshijnë shumë gjëra teknike. Intervistat janë diçka më shumë se sa thjesht një bashkëbisedim. Intervistat përfshijnë një sërë supozimesh dhe kuptimesh rreth situatës, që normalisht nuk janë të lidhura me një bashkëbisedim të rastësishëm (Descombe 1983; Silverman 1985).

Për të qenë më specifik, intervistat - në veçanti intervistat *në thellësi* - e lënë veten në mbledhjen e të dhënave bazuar në:

- *Opinione, ndjenja, emocione dhe eksperiencë*
- *Çështje të ndjeshme*
- *Informacione të privileguara*

Intervistat gjysmë të strukturuar

Në intervistat gjysmë të strukturuar intervistuesi është i përgatitur që të jetë fleksibël në

aspektin e qëllimit të temave të marra në konsideratë dhe që të lejojë të intervistuarin të zhvillojë ide dhe të flasë më gjerësisht rreth çështjes së ngritur nga studiuesi. Përgjigjet janë të hapura (open-ended) dhe ka më shumë theksim në përpunimin e interesit të intervistuesit.

Fokus grupet

Fokus grupi me drejtues u realizua me të gjithë drejtuesit e medreseve, përkatësisht me 10 të tillë. U realizuan 16 pyetje që siguruan të dhëna për moshën, kualifikimin e drejtuesve, por edhe gjetje për kualifikimin e mësuesve, që zhvillojnë edukimin qytetar nëpërmjet lëndëve fetare dhe jofetare, por edhe informacione rreth zhvillimit të lëndëve të qytetarisë në medrese. Në veçanti u mbledhën të dhëna për nxënësit, nga vijnë ata, sa jetojnë në konvikte, si dhe rreth bashkëpunimit shkollë-familje, por edhe të bashkëpunimit me njësitë vendore arsimore (DAR-et), por edhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Me interes janë të dhënat sasiore se sa nxënës të medreseve vijojnë shkollat e larta dhe çfarë degësh studiojnë ata.

Pyetësi për mësuesit u hartua me 9 pyetje. Pyetjet ishin të llojeve të ndryshme dhe mundësonin vjeljen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, p.sh., pyetjet me

alternativa, por edhe me anë të pyetjeve të hapura, që na mundësonin mbledhjen e ideve, mendimeve dhe gjykimeve, që mësuesit kishin për zhvillimin e lëndëve të formimit qytetar si: “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” sipas kurrikulës shtetërore, por dhe të 9 lëndëve fetare, që janë pjesë e kurrikulës së medreseve, që ofrojnë edukim qytetar. Përmbajtja e pyetjeve kishte të bënte me procesin e zhvillimit të kurrikulës lidhur me përbërës të saj si: përmbajtja e kurrikulës së edukimit qytetar, kompetencat qytetare, që synohen të krijohen te nxënësit, projektet kurrikulare që zhvillohen dhe tematikat e tyre, veprimtaritë kros dhe ekstrakurrikulare, metodologjitë që zbatohen në klasa dhe jashtë tyre për edukimin qytetar, por edhe identifikimin e pikave të dobëta dhe të forta që janë ndeshur për zhvillimin e kësaj lënde. Të gjithë këto elemente kurrikulare, të paraqitur në pyetësor, prekin kurrikulën e lëndëve fetare dhe atyre jofetare, që synojnë formimin qytetar. Gjithashtu ato mundësojnë edhe identifikimin e tematikave të përbashkëta, që zhvillojnë lëndët fetare dhe jofetare, por edhe të atyre çështjeve, që i trajtojnë veçmas. Pyetësi, nga ana tjetër, shërbeu për të siguruar të dhëna edhe për shkallën e kualifikimit të mësuesve të edukimit qytetar në medrese, moshën e tyre, tregues që kanë rëndësi për zhvillimin e këtij edukimi.

Pyetëtori për nxënësit u hartua me 10 pyetje. Pyetjet ishin të llojeve të ndryshme dhe mundësonin mbledhjen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht me anë të pyetjeve me alternativa, por edhe me anë të një pyetje të hapur, që mundësonte të dhëna për idetë, mendimet dhe gjykimet që nxënësit kishin për edukimin e tyre qytetar nëpërmjet lëndëve fetare dhe jofetare. Po ashtu, pyetëtori siguron të dhëna për tematikat e trajtuara në edukimin qytetar, projektet kurrikulare të zhvilluara, por edhe për klimën dhe bashkëpunimin në shkollë, si dhe për mjediset fizike të shkollës dhe sigurinë në to.

Kampionimi dhe popullata e intervistuar

Për pyetëtorët e mësuesve janë përfshirë 31 mësues që janë afërsisht 20% e numrit total të mësuesve të medreseve në Shqipëri. Për pyetëtorët e nxënësve janë përfshirë 505 nxënës gjithsej, që tejkalojnë më shumë se 20% të numrit total të tyre, por edhe është marrë në konsideratë me përparësi shpërndarja e plotësimit të pyetësorëve nga nxënës të të gjitha klasave në medrese. Numri i drejtuesve të pyetur ishte 10, që përbën 100% të tyre si drejtues të medreseve.

Popullata: Realizimi i këtij punimi u mendua të bëhet me mësues, nxënës dhe drejtues të medreseve.

Kampioni: 505 nxënës, 31 mësues, 10 drejtues nga të gjitha medresetë e vendit.

Dokumentacion dhe instrumente:

Në realizimin e studimit në fjalë janë përdorur këto instrumente:

- *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar*
- *Programet lëndore të lëndëve të “Edukimit për shoqërinë” dhe “Qytetaria” në arsimin publik, parauniversitar*
- *Dokumentacioni zyrtar, kurrikular i medreseve për ciklin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe për ciklin e mesëm të lartë (klasat 10-12)*
- *Programet e lëndëve fetare që ofrojnë edukim qytetar*
- *Literaturë e printuar dhe ajo on-line për edukimin fetar*
- *Pyetësorë*
- *Fokus-grup me pyetje për drejtuesit*

Etika. Ky studim u krye me lejen, mbështetjen dhe bashkëpunimin vullnetar të mësuesve, drejtuesve dhe nxënësve të 7 medreseve, ku një rol mbështetës dha Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Pjesëmarrësit në studim u informuan rreth rëndësisë së të dhënave, si dhe iu garantua privatësia. Rezultatet e studimit janë bërë publike vetëm për qëllimin e studimit.

Pjesa 1. Analizë deskriptive e kurrikulës së formimit qytetar

1.1 Kurrikula e edukatës qytetare në lëndët jofetare

Institucionet arsimore “Medrese” janë shkolla të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë që zhvillojnë procese të edukimit dhe arsimit në 7 qytete të Shqipërisë, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Kavajë, Elbasan, Korçë, Durrës dhe Berat.

Kurrikula, që ato zbatojnë është tërësisht e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kjo nënkupton atë që ciklet arsimore të medreseve zbatojnë kurrikulën zyrtare përkatëse, që lidhet me përmbajtjet e paraqitura në dokumentacionin zyrtar, kurrikular si: Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar¹⁵, Kompetencat dhe rezultatet e të nxënit, Programet lëndore¹⁶, Udhëzuesit e ndryshëm për zhvillimin e kurrikulës, si dhe tekstet shkollore.

Ndonëse këto institucione zhvillojnë edhe edukim fetar, kurrikulat e të cilave rast pas rasti miratohen për zbatim në Ministrinë

e Arsimit¹⁷, nga ana tjetër medresetë ofrojnë dhe edukim qytetar konform përmbajtjes dhe kërkesave të kurrikulës zyrtare.

Kurrikula e edukimit qytetar, që zhvillohet edhe në ciklet arsimore të medreseve, është pjesë e kurrikulës bazë të arsimit të detyrueshëm dhe e arsimit të mesëm të lartë në Shqipëri. Pas viteve ‘90 të shekullit të kaluar, që kur Shqipëria nisi proceset demokratike e deri në ditët e sotme, hartuesit e arsimit e konsiderojnë të domosdoshëm formimin e qytetarisë demokratike të brezave të rinj në mënyrë që ata të jenë të aftë të jetojnë dhe të përballojnë sfidat e demokracisë.

Përgjatë periudhës 26 vjeçare (1990-2016) fusha kurrikulare e shkencave shoqërore ka pasur brenda saj lëndë të tilla si: “Edukata shoqërore” për klasat 1-5 (cikli fillor), “Edukata qytetare” për klasat 6-9 (cikli i mesëm i ulët), “Qytetaria” për klasat 10-11 (cikli i mesëm i lartë).

Reformimi i vijueshëm ndër vite i kurrikulës së arsimit parauniversitar ka sjellë që në 3 vitet fundit 2014-2016 të kemi fushën kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”, brenda së cilës kanë vend lëndët e historisë, gjeografisë, edukimit për shoqërinë dhe qytetaria.

Në ciklin fillor (klasat 1-5)

15. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Dokument i MAS. 2014. <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Korniza-Kurrikulare.pdf>
16. <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>

17. Shkresë zyrtare e MAS datë 07.10.2014, me Nr.6608/1 prot., “Miratim i planeve mësimore të medreseve” drejtuar Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH).

raporti i vendit, që zë në kurrikul fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” me lëndët e saj, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 6% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

Në ciklin e mesëm të ulët (klasat 6-9) raporti i vendit që zë në kurrikul fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” me lëndët e saj që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 6% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

Klasat 1-5 të ciklit fillor

Nr	Lëndët	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5
1	Edukim për shoqërinë	1 orë/javë	1 orë/javë	-	-	-
2	Qytetari	-	-	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë

Në ciklin e mesëm të lartë (klasat 10-12) raporti i vendit që zë në kurrikulën bërthamë/bazë fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”¹⁸ me lëndët e saj, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me edukimin qytetar, sipas planit mësimor zyrtar rezulton të zërë 16% krahasuar me fushat e tjera kurrikulare dhe lëndët e tyre përbërëse në tërësi.

18. <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
<http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-6-9.pdf>

Pra, vërehet një rritje nga cikli në cikël gjatë arsimit parauniversitar i peshës specifike që zë kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar.

Po të analizojmë vetëm vendin dhe peshën që zënë lëndët e mirëfillta të edukimit qytetar si: “Edukim për shoqërinë”, “Qytetaria” në të tria ciklet e arsimit parauniversitar do të kishim të dhënat e mëposhtme:

Sipas planit të ri mësimor zyrtar të arsimit parauniversitar, që zhvillohet aktualisht në klasat 1-2 të ciklit fillor, zhvillohet lënda “Edukim për shoqërinë”, ndërsa nga klasa 3-10 zhvillohet lënda “Qytetaria”.

Raporti i orëve të lëndëve “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,23 %.

Klasat 6-9 të ciklit të mesëm të ulët

Nr	Lënda	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9
1	Qytetari	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë	1 orë/javë

Raporti i orëve të lëndës “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,30 %.

Klasat 10-12 të ciklit të mesëm të lartë¹⁹

Nr	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Qytetari	2 orë/javë	-	-

Raporti i orëve të lëndës “Qytetaria” krahasuar me numrin total të orëve të planit mësimor të këtij cikli rezulton 0,35 %.

Fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve Edukim për shoqërinë, Qytetari, Histori, Gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve “Edukim për

shoqërinë”, “Qytetari”, “Gjeografi” dhe “Histori” janë ngushtësisht të lidhura me kompetencat, që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë shkallë, i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, evropiane me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptuale dhe metodologjikë, të cilat nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme dhe që e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij. Tematika e trajtuar në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” përmes lëndëve të saj, ku edhe “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” bëjnë pjesë, ka të bëjë me:

1. Pushteti, autoriteti, qeverisja
2. Proceset natyrore dhe shoqërore
3. Kultura
4. Ndërvarësia njerëz-vende-mjedise
5. Kronologjia, ndryshimi, vazhdimësia
6. Individët, grupet, shoqëria
7. Prodhimi, shpërndarja, konsumi

19. <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2014/10/Udhhezues-per-gjimnazin-Varianti-i-fundit.pdf>

1.1.1 Programet e edukimit qytetar

Programet e lëndëve “Edukim për shoqërinë”, “Qytetari” mbështeten tërësisht në konceptet dhe praktikat e qytetarisë demokratike. Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe të shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si e tillë, ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë. Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- *Përmasën politike*, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- *Përmasën ligjore*, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.
- *Përmasën kulturore*, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- *Përmasën shoqërore dhe ekonomike*, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave

të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.

- *Përmasa evropiane*, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.

- *Përmasën globale*, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvlerësive dhe solidaritetit global.

Edukimi për qytetari demokratike synon:

- Të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;

- Të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;

- Të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;

- Të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programet e lëndëve të qytetarisë synojnë:

- T’u japin nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe

mënyrat e zbatimit të tyre.

- T'u japin nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

- T'u japin nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Lëndët “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetaria”²⁰ gjithashtu synojnë të përmbushin edhe njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat e kompetencave zyrtare, kyçe për arsimin parauniversitar, përkatësisht:

1. Kompetenca qytetare
2. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
3. Kompetenca e të menduarit
4. Kompetenca e të nxënësve
5. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
6. Kompetenca personale
7. Kompetenca digjitale

Temat që zhvillon lënda e qytetarisë prekin çështje të tilla që lidhen thelbësisht me edukimin qytetar, si:

1. Ligji
2. Kushtetuta
3. Të drejtat e njeriut
4. Arsimi
5. Shëndeti
6. Mjedis
7. Konsumatori
8. Puna dhe e drejta e punës
9. Siguria në rrugë
10. E drejta për informim dhe ligji për median
11. Bashkëjetesa në komunitet

Nga ana tjetër, lëndët “Edukimi për shoqërinë” dhe “Qytetaria” zhvillojnë edhe veprimtari mësimore ndërkurrikulare, që trajtojnë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetaria” fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedis
- Ndërvlerësimi
- Bashkëjetesa paqësore

Rolet dhe kompetencat e mësuesit për realizimin e mësimdhënies dhe mbështetjen e proceseve të të nxënësve në fushën e qytetarisë kanë pësuar

20. <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programe-t-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/#feature3>

ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta;*

- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj;*

- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive;*

- *aftësinë për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;*

- *aftësinë për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, si dhe ndërmjet nxënësve; respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;*

- *aftësinë për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse, që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;*

- *aftësinë për ta parë veten dhe nxënësin, si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar; bindjen në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;*

- *aftësinë për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të*

zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;

- *gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësimë prej tyre;*

- *aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.*

Aspekt tjetër i theksuar i kurrikulës së edukimit qytetar është trajtimi i nxënësve me nevoja të veçanta dhe ai i nxënësve të talentuar, i cili kërkon që mësuesit të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme, etj. Nga ana tjetër, mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme

didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj. Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme, ku sugjerohet dhe:

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për njohuri për shoqërinë
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit për temat që studion
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software
- Përdorimi i simulimeve software
- Përdorimi i grafikëve software
- Paraqitja grafike e të dhënave

Element tjetër përbërës i të ushtruarit praktik të nxënësve në formimin qytetar që kërkon kurrikula e gjimnazit është edhe kryerja e 18 orëve shërbim komunitar nga secili nxënësi, që ka të bëjë me shërbimet që nxënësit mund të ofrojnë në institucione shtetërore, shkolla, spitale, biblioteka, etj., por edhe me kontribute ndaj mjedisit dhe komunitetit dhe kjo në varësi të kontekstit dhe rrethanave që ka secili gjimnaz dhe komuniteti përreth tij.

Përmbledhje

Kurrikula e edukimit qytetar në arsimin parauniversitar zhvillohet me anë të lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetari” dhe synon formimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave qytetare të nxënësit e këtij cikli arsimor, duke u mbështetur fort te filozofitë, praktikat e mira dhe modelet e qytetarisë evropiane dhe botës demokratike në veçanti, ku në thelb të tyre mbeten të drejtat dhe përgjegjësitë individuale, zbatimi i ligjit, kujdesi ndaj mjedisit, e drejta për punësim, siguria njerëzore dhe bashkëjetesa në komunitet. Përmbajtja e lëndëve të përmendura më lart nuk prek asnjë informacion ose praktikë edukimi, që lidhet me çështje të mësimit dhe edukimit fetar. Gjithashtu ky edukim ka një vend të posaçëm në kurrikul, që është i mjaftueshëm për të realizuar synimet

dhe kompetencat e dëshiruara për nxënësit, kur kemi parasysh sasinë e orëve, peshën specifike të fushës kurrikulare, por edhe të lëndëve të mirëfillta të formimit qytetar që

zhvillohen në të tria ciklet e arsimit parauniversitar, e krahasuar edhe me kurrikulat e sistemeve arsimore evropiane.²¹

21. Vazhdon në numrin e ardhshëm.

Bibliografia:

- Balla, Xhemal (2010), “Haxhi H. Mahmut Dashi, jeta dhe vepra 1873-1961”, Tiranë: West Print
- Basha, Ali M. (2011), “Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë.
- Kruja, Genti, (editor), (2014), “Rregullore mbi Medresen e Myslimanve”, Zani i Naltë, vëllimi i parë, vitet 1923-1924/-1925, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, Tiranë.
- Kutlu, Adil, (2016), “Perceptimi i prindërve lidhur me edukimin fetar në Shqipëri: rasti i medreseve”, Tezë doktrature, UET, Tiranë.
- Vuçiterni, Salih, “Nji pergjigje Z. Hafis Xhaferit”, Kolana “Zani i Naltë, Vëllimi i Dytë, vitet 1926-1927-1928, botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, 2015: 274-275.
- Zaimi, Ali & Kruja, Genti (editorë), (2014) “Katalog i Veprimtarisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, botimet KMSH, Tiranë.

Dokumente:

- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Dokument i MAS. 2014.
- Shkresë zyrtare e MAS datë 07.10.2014, me Nr.6608/1 prot. “Miratim i planeve mësimore të medreseve” drejtuar Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH).
- VKM, Nr. 654, të datës 29.11.1995 për funksionimin e Medreseve (burime arkivore në KMSH).

Webliografia:

- <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-1-5.pdf>
- <http://izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Kurrikula-berthame-6-9.pdf>
- <http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2014/10/Udhezues-per-gjimnazinVarianti-i-fundit.pdf>
- <http://www.izha.edu.al/programe-lendore/programet-e-arsimit-baze-kurrikula-e-re/#feature3>
- <http://www.asa3.org/ASA/education/options/public.htm#rel>
- <http://gainpeace.com/index.php?option=comcontent&view=article&id=108:what-is-islams-view-about-education-science-and-technology&catid=54:catidebliografi=54&Itemid=108>
- [http://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Inviting God into the Classroom. Prof. Robert Nash College of Education and Social Service at Vermont.A case for religion in public schools](http://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Inviting%20God%20into%20the%20Classroom.%20Prof.%20Robert%20Nash%20College%20of%20Education%20and%20Social%20Service%20at%20Vermont.A%20case%20for%20religion%20in%20public%20schools)
- <http://www.uvm.edu/~uvmpr/vq/VQFALL01/religion.html>
- <https://www.aarweb.org/sites/default/files/pdfs/Publications/epublications/AARK-12CurriculumGuidelines.pdf>

Vakëfet në Shqipëri nga periudha osmane deri në regjimin komunist

MA. Uran Kalej

Abstrakt

Krijimi i vakëfeve dhe i institucioneve vakëfnore në territoret shqiptare, fillon pas ardhjes së osmanëve në Ballkan, duke nisur që nga gjysma e dytë e shek. XV. Këto institucione kanë luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në jetën social-ekonomike dhe religjioze të popullsisë shqiptare. Madje, nga studime të ndryshme, rezulton se disa nga qendrat urbane mesjetare shqiptare janë krijuar nga vakëfet. Kjo vlen edhe për Tiranën, e cila sot është kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë.

Në periudhën osmane, sasia e pronave bujqësore, xhamive, çezmave apo objekteve që dhuroheshin si vakëf, gjeti shtrirje të gjerë në të gjitha qendrat urbane dhe rurale të Shqipërisë. Kjo evidentohet edhe nga emërtimet që ato mbajnë, të cilat, në shumicën e rasteve, i përkasin personave që i kanë dhuruar apo ndërtuar.

Pas shpërbërjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane, tradita e dhurimit të pronave vakëf vazhdoi me të njëjtin intensitet. Por, vakëfet tani administroheshin nga Komuniteti Mysliman Shqiptar, i cili ishte një institucion i pavarur nga Kalifati Osman. Në periudhën 1920-1944 vihet re një rritje e nivelit të administrimit të vakëfeve. Për menaxhimin e tyre u hartuan rregullore të posaçme, të cilat përcaktonin me rigorozitet mënyrën e funksionimit. Të ardhurat që vinin prej tyre shkonin për restaurimin dhe ndërtimin e xhamive, për hapjen e kurseve dhe shkollave fetare, për kualifikimin e personelit, apo për zgjidhjen e problemeve të bashkësisë islame.

Një situatë aspak e favorshme për vakëfet në Shqipëri u krijua pas vitit 1945, kur u instalua regjimi komunist. Masat represive që qeveria shqiptare ndoqi në këtë periudhë fillimisht konsistonin në kufizimin, e më pas në asgjësimin e institucioneve fetare. Në këtë periudhë u hartuan ligje, të cilat pjesën dërrmuese të pronave vakëfnore ia kaluan shtetit; ndërkohë që, në vitin 1967, feja u ndalua me ligj dhe pjesa dërrmuese e xhamive u prishën. Ndërsa në ditët e sotme, qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj rikthimit të pronave vakëfnore është konfuz.

Fjalë kyçe: Shqipëria, Vakëf, Komuniteti Mysliman Shqiptar, Menaxhimi i Vakëfeve, Legjislacioni.

I. “Vakëfet” si koncept religjioz dhe funksionet

Në fjalorë të ndryshëm fjala “vakëf”, e cila rrjedh nga gjuha arabe, ka kuptim të njëjtë. Ajo përkufizohet si një pronë e dhuruar për qëllim humanitar ndaj banorëve të një lagjeje, fshati apo qyteti.¹ Personi dhurues ka për qëllim që t’u vijë në ndihmë, kryesisht personave në nevojë, komunitetit ku ai banon, ose myslimanëve në mbarë botën.

Në periudha të ndryshme të historisë islame, vakëfet, si koncept religjioz, dhe funksioni i tyre ka mbetur i njëjtë. Megjithatë, ajo që ka ndryshuar te vakëfet është fakti se, që nga shpallja e Islamit në shek. VI deri në ditët e sotme, numri i tyre ka njohur një rritje progresive nga shekulli në shekull. Madje, mund të thuhet se, ndryshe nga fazat e para të shfaqjes së vakëfit si fenomen social, me kalimin e viteve, ai u kthye në një institucion.²

Rritja e numrit të pronave të dhuruara si vakëf, solli për

rrjedhojë krijimin e njësive apo institucioneve të veçanta, që do të merreshin me menaxhimin e tyre, përkujdesjen dhe inventarizimin. Kjo vihet re pothuajse që në shek. VI-VII. Me kalimin e viteve mënyra e administrimit të tyre erdhi duke u perfeksionuar, çka solli si rezultat lindjen e një klase individësh të specializuar. Gjithashtu, në periudha, dinasti dhe shtete të ndryshme gjatë historisë islame u hartuan rregullore të posaçme, të cilat përcaktonin mënyrën e funksionimit dhe organizimit të pronave të lëna si vakëf.

II. Vakëfet në Shqipëri në periudhën osmane

Në Shqipëri ekzistenca e vakëfeve fillon pas ardhjes së osmanëve në Ballkan, duke nisur që nga gjysma e dytë e shek. XV. Në Arkivin Qendror të Shtetit, në Tiranë, ekziston një dokumentacion i pasur arkivor, i trashëguar nga administrata osmane, sipas të cilit dokumentohet qartë tradita dhe ekzistenca e vakëfeve që në periudhën mesjetare.³ Megjithatë, për shkak të vështirësive të shumta që burojnë nga mungesa e specialistëve të periudhës osmane dhe politika antifetare e shtetit shqiptar, gjatë periudhës komuniste, ky dokumentacion ka mbetur i

1. Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë: AIITC, 2005, f. 1074; Selçuk Akşin Somel, *Osmanlı İmparatorluğu Ansiklopedisi*, Istanbul: ALFA, 2014, s. 568-569.

2. Mehmet Ali Ünal, *Osmanlı müesseseleri tarihi*, Isparta, 1997, s. 122.

3. Kujtim Nuro, *Dokumente osmane në arkivat shqiptare*, Durrës: Amfioni & Zeti, 2000, f. 1-104.

pastudiuar.⁴ Kjo, si pasojë, ka sjellë faktin që në Shqipëri, ende dhe sot e kësaj dite, të mungojnë botimet shkencore lidhur me vakëfet. Gjithsesi, nuk kanë munguar edhe botime, të cilat, indirekt, kanë hedhur sadopak dritë mbi aspekte të veçanta të vakëfeve gjatë periudhës osmane.⁵

Sipas të dhënave të deritanishme një nga vakëfet më të vjetra në Shqipëri është ai i Iljaz bej Mirahorit, i cili, në vitin 1505, ktheu në vakëfe

4. Pjesa dërrmuese e dokumentacionit arkivor osman, pjesë e të cilit janë edhe dokumentet lidhur me pronat vakëf, ndodhet në gjendje aspak të mirë fizike, duke rrezikuar seriozisht memorien historike të shqiptarëve gjatë periudhës osmane. Vakëfndamet dhe dokumentet e gjykatave sherie të Beratit, Shkodrës, Gjirokastrës, etj., përbëjnë një argument bazë referencial për të ndërtuar dinamikën e zhvillimit të vakëfeve në trojet shqiptare. Shkatërrimi i tyre përbën një kërcënim serioz, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për historinë e qytetërimit islam në Ballkan. *Shih*: Gazmend Shpuza, “Rreth regjistrave të kadinjve në Shqipëri (sixhilet e Beratit, Elbasanit, Korçës dhe Tiranës me shtrirje kohore ndërmjet shekujve XVI-XX)”, *Perla*, nr. 4, 1997, f. 31-42.

5. Petraq Pepo, “Katër dekrete (fermane) të sulltan Bajazitit II për Mirahor Iljaz Beun”, *Studime Historike*, nr. 3, 1967, f. 217-242; Selami Pulaha, “Materiale dokumentare osmano-turke në Arkiva shqiptare mbi Shqipërinë (shek. XV-XIX)”, *Studime Historike*, nr. 3, 1966, f. 133-148; Stavri Naçi, “Pashallëku i Shkodrës i parë në kuadrin e zhvillimit të tij ekonomik e shoqëror në shekullin XVIII”, *Studime Historike*, nr. 2, 1967, f. 55-77; Ferit Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII)*, Tiranë: Toena, 2001.

pronat në fshatrat Peshkopje, Vithkuq, Leshnjë, Boboshticë. Këto prona atij i qenë dhuruar nga Sulltan Bajaziti II (1481-1512) për shërbimet e kryera ndaj Perandorisë Osmane. Madje, tani është konfirmuar fakti se qyteti i njohur i Korçës është themeluar nga pronat e lëna vakëf të Iljaz beut.⁶ Ky personalitet historik, që kur ishte gjallë, ngriti në fshatin Peshkopi të Korçës 5 institucione vakëfnore: një xhami, një teqe, një hamam, një imaret dhe një medrese. Ato do të mbaheshin me të ardhurat e siguruara nga fshatrat e kthyer si vakëf.⁷ Institucionet vakëfnore të ngritura nga Iljaz beu, shërbyen si një bërthamë urbane pranë të cilave u ndërtua më pas qyteti i Korçës. Popullsia e zonave përreth u vendos pranë tyre, duke krijuar kështu lagjet, rrugicat dhe mjedisin social.

Një dukuri e ngjashme vihet re në disa qytete të Shqipërisë. Institucionet vakëfnore të periudhës së hershme osmane ishin baza dhe faktori kryesor i themelimit apo rithemelimit të qyteteve shqiptare. Nisur nga ky fakt dalim në përfundimin se vakëfet kanë

6. Petraq Pepo, “Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë - berati i Bajazitit të II dhe Vakëfndameja e Mirahor Iljaz Beut”, *Buletini për Shkencat Shoqërore*, 1956, f. 271-272.

7. *Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shekullit XVIII - fillimi i shekullit XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit)*, përgatiti: Petraq Pepo, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1981, f. 5.

luajtur një rol të rëndësishëm për urbanizimin e Shqipërisë dhe të popullsisë myslimane shqiptare. Vakëfet, krahas dimensionit humanitar, social dhe religjioz, kanë ndikuar edhe në rritjen e mirëqenies së popullsisë shqiptare në aspektin material. Në aspektin social ato kanë harmonizuar klasat shoqërore (të varfrit me të pasurit, fshatarët me qytetarët, etj), duke i dhënë mundësi shkollimi dhe banimi të gjitha kategorive të popullsisë myslimane shqiptare.

Një shembull interesant në vazhden e këtij argumenti është edhe historia e themelimit të Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Qyteti u themelua në vitin 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini, i cili në fillim ndërtoi një xhami, një furrë buke dhe një hamam. Këto ndërtesa shërbyen si bërthama fillestare rreth të cilave me kalimin e viteve u vendos popullsia e fshatrave përreth.⁸

Në Arkivin Qendror të Shtetit ekziston një sasi e madhe dokumentacioni, sipas të cilit konkludohet se në shek. XVII numri i pronave të dhuruara si vakëf është mjaft i përhapur pothuajse në të gjitha trevat e Shqipërisë. Në mesin e këtij dokumentacioni vihen re vakëfname (aktdhurimi), rregullore mbi funksionimin dhe kushtet e vakëfeve, ankesa lidhur me menaxhimin e tyre, etj. Madje, nga

shqyrtimi i këtyre dokumenteve vihet re se, një pjesë e mirë e personelit që shërbente në institucionet vakëfnore, apo në xhami si: imamët, myezinët, etj., mbështeteshin ekonomikisht me të ardhura që rridhnin (buronin) nga pronat e lëna vakëf. Kjo tregon se institucioni i vakëfit ka luajtur rolin e një rregullatori social, në përputhje me nevojat që një vend dhe popullsi e caktuar ka pasur në një kohë të caktuar.

Në periudhën osmane vakëfet në territorin e Shqipërisë kanë luajtur një rol multifunksional. Ato, siç u shpjegua edhe më sipër, nuk ishin vetëm institucione bamirësie, që kishin si qëllim kryesor ardhjen në ndihmë të shtresave në nevojë, por ishin edhe bërthama urbane, qendra ku zhvillohej dhe kultivohej besimi, kultura dhe qytetërimi islam.

Studimi i kësaj tradite të shkëlqyer islame në Shqipëri, e cila fillon në shek. XV-XVI me ardhjen e osmanëve në Ballkan, përbën një nevojë emergjente. Njohja e dinamikës së ndërtimit të institucioneve vakëfnore në këtë periudhë do të ishte një bazë e fortë për zhvillimin e mëtejshëm të saj.

III. Vakëfet në Shqipëri pas shkëputjes nga Perandoria Osmane

Më 24 shkurt 1923, në Tiranë zhvilloi punimet Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar. Në Kongres

8. Kristo Frashëri, *Historia e Tiranës*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2004, f. 472.

merrnin pjesë 36 delegatë. Që në mbledhjen e parë të delegatëve, Haxhi Vehbi Dibra u zgjodh Kryetar i Kongresit Mysliman dhe punimet u zhvilluan nën kryesinë e tij. Në fjalën e hapjes, ai theksoi karakterin liberal e demokratik të fesë islame.⁹ Kongresi vendosi shkëputjen zyrtarisht të bashkësisë islame nga Kalifati Osman dhe miratimin e një statuti mbi bazën e të cilit do të funksiononte Komuniteti Mysliman Shqiptar. Në statutin e ri një vend i posaçëm i kushtohej edhe organizimit dhe administrimit të vakëfeve. Sipas nenit 32, vakëfet do të menaxhoheshin nga një drejtor i përgjithshëm që do të zgjidhej nga Kongresi i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Drejtorja e Përgjithshme e Vakëfeve do të ishte e lidhur me Këshillin e Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman. Ajo do të kishte në organikë një drejtor, një sekretar, një arkëtar dhe një ndihmës. Në Prefektura dhe nënprefektura do të emëroheshin nëpunës të veçantë, të cilët do të bashkëpunonin me myftinjtë. Rrogat e nëpunësve të vakëfeve do të nxirreshin nga të ardhurat që rridhnin prej tyre.¹⁰

Nga dokumentacioni i shqyrtuar vihet re se organizimi i vakëfeve në Shqipëri pas shkëputjes nga Perandoria Osmane, është realizuar

me seriozitet dhe korrektësi. Të ardhurat që nxirreshin prej tyre shkonin në dobi të popullsisë, për ndërtimin dhe restaurimin e xhamive, shkollave dhe rrogave të personelit fetar.

Në raport me shtetin, nga pikëpamja juridike e politike, deri në vitin 1945 nuk ka pasur asnjë pengesë apo problem. Komuniteti Mysliman Shqiptar ka pasur të gjitha hapësirat e nevojshme për t'i administruar vakëfet në përputhje me nevojat e veta.

Në periudhën nga viti 1923-1945, legjislacioni për menaxhimin e vakëfeve erdhi duke u perfeksionuar. Komuniteti Mysliman Shqiptar hartoi regjistra të posaçëm ku evidentoheshin qartë vendi se ku ndodheshin vakëfet, gjendja fizike e tyre dhe të ardhurat vjetore që ato sillnin. Kjo dëshmon për një kulturë të lartë juridike, përgjegjësi dhe ndershmëri të personaliteteve të Komunitetit Mysliman Shqiptar në këtë periudhë historike.

IV. Vakëfet në periudhën e regjimit komunist (1945-1967)

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, ashtu si e gjithë ekonomia shqiptare në përgjithësi, edhe ekonomia vakëfnore u përball me një krizë të thellë. Ajo u shkaktua nga dy faktorë kryesorë:

1) Nga prapambetja e trashëguar.

9. Gazment Shpuza, "Rëndësia dhe mesazhi i Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923", *Perla*, Viti XI 2006 Nr. 2 (41), f. 107.

10. *AQSH*, F. 482, V. 1923, D. 3, fl. 195-197.

2) Nga dëmet që pësoi vendi gjatë pushtimit italian dhe gjerman.

Por, në këtë proces, ndikim të ndjeshëm negativ, patën edhe reformat e para ekonomike të ndërmarra nga Partia Komuniste, të cilat prekën pronën vakëfnore.¹¹

Në vitin 1945, në Shqipëri u instalua regjimi komunist. Kjo solli për pasojë fillimin e një fushate antifetare, e cila synonte kufizimin e veprimtarisë së bashkësisë islame, e më pas eliminimin përfundimtar të saj. Megjithatë, bashkësia islame shqiptare bëri përpjekje maksimale për rigjallërimin dhe normalizimin e shërbimeve e të jetës fetare dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë vakëfnore, e cila mbështetej në pronat e paluajtshme dhe të luajtshme që zotëronin institucionet fetare.

Komuniteti Mysliman Shqiptar zotëronte prona të mjaftueshme, që siguronin dhe garantonin vazhdimësinë normale e të plotë të veprimtarisë së institucioneve fetare. Prona vakëfnore ishte e llojeve të ndryshme, por vendin kryesor, si pronë e paluajtshme, pas xhamive, e zinin tokat, vreshtat, ullishtat, dyqanet, punishtet artizanale, etj. Në këtë periudhë kishte edhe prona të luajtshme, si kope me bagëti të llojeve të ndryshme. Karakteristikë

kryesore e kësaj periudhe ishte fakti se të ardhurat nga prona vakëfnore zvogëloheshin vit pas viti.¹²

Regjimi komunist, për të goditur Komunitetin Mysliman Shqiptar në aspektin ekonomik, nuk hezitoi të nxiste një grup personash, në vitin 1945, që të krijonin një komision të posaçëm në qytetin e Vlorës për administrimin e vakëfeve. Ky komision do të vepronte i pavarur nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve në Tiranë.¹³ Veprimin e tyre, ky grupim e justifikonte me faktin se, me të ardhurat e vakëfeve, në radhë të parë, duhej të plotësoheshin nevojat lokale. Gjithsesi, duke hapur se politika e qeverisë komuniste synonte nxitjen e diversionit midis radhëve të bashkësisë islame.

Një vështirësi tjetër e institucioneve vakëfnore në këtë periudhë ishte ajo e përdorimit të një pjese të tyre nga shteti për interesa publike. Ky veprim nuk bazohej në asnjë ligj dhe rregullore të kohës. Ai ishte një akt arbitrar, i cili një pjesë të vakëfeve i nxori jashtë funksionit të tyre normal. Nga këto prona nuk përfitonin më as besimtarët myslimanë dhe as zyra financiare e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Kjo i shtyu disa drejtues fetarë që t'i drejtonin qeverisë dhe administratës lokale ankesa. Por, pavarësisht këtyre ankesave, situata erdhi duke u përkeqësuar. Kështu, në vitin

11. Shyqyri Hysi, *Myslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, Tiranë: Mësonjtorja, 2006, f. 107.

12. *Po aty*, f. 108.

13. *AQSH*, F. 482, V. 1945, D. 62, fl. 7.

1947, xhamia e qytetit të Peqinit u përdor si kabanon për punëtorët që merreshin me ndërtimin e hekurudhës, ndërsa institucionet vakëfnore si zyra për administratën. Kjo e shtyu Komunitetin Mysliman Shqiptar të protestonte ashpër, duke e konsideruar këtë si fyerje që u bëhej besimtarëve në një qytet ku nuk kishte asnjë xhami tjetër për të kryer ritin e faljeve. Megjithatë arbitrariteti i shtetit vazhdoi duke shkelur të gjitha të drejtat universale.

Një metodë tjetër abuzive që ndoqi qeveria komuniste për konfiskimin e vakëfeve ishte shpallja e tyre si monument kulture. Kjo synonte paralizimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve, qoftë në aspektin ekonomik, qoftë në aspektin fetar. Kështu u veprua për shembull me xhaminë e Plumbit në qytetin e Vlorës, e cila u konsiderua si objekt me vlera artistike. Shembuj të ngjashëm vihen re në të gjitha qytetet e Shqipërisë.

Një goditje jashtëzakonisht të rëndë vakëfet e morën nga Reforma Agrare e vitit 1945. Ky ligj legjitimonte ndërhyrjen e shtetit në pronat fetare dhe përdorimin e tyre në funksion të politikës ekonomike të regjimit komunist.¹⁴ Ministria e Bujqësisë udhëzoi administratën lokale që në ato zona ku bujqit nuk kishin tokë të mjaftueshme të

përdorreshin vakëfet. Kjo padrejtësi nuk mbështetej në asnjë bazë juridike shqiptare dhe ndërkombëtare. Në përfundim të Reformës Agrare, sasia e pronave vakëf kishte pësuar një rrudhje të ndjeshme. Më 7 nëntor 1946, Komuniteti Mysliman Shqiptar hartoi një raport ku pasqyroheshin të gjitha problematikat. Sipas këtij raporti, 155 xhami në qytete të ndryshme të Shqipërisë, Reforma Agrare i kishte shpronësuar tërësisht. Ndërkohë që më parë ato kishin në pronësi të tyre nga 4 deri në 220 dynym tokë.¹⁵

Një goditje tjetër që regjimi komunist i dha vakëfeve ishin edhe pasojat që vinin nga politika fiskale. Kështu, më 31 mars 1945 u miratua ligji “Mbi tatimin e fitimit”,¹⁶ i cili tatonte të gjitha llojet e pasurisë duke përfshirë edhe rrogat e nëpunësve. Regjimi komunist përfshiu në listën e tij fiskale edhe vakëfet, pavarësisht se ato ishin institucione bamirësie.

Masat represive mbi institucionet fetare dhe vakëfet vazhduan të shtoheshin vit pas viti, duke e ngushtuar aq shumë sferën e veprimtarisë së tyre, sa që mbyllja e tyre do të vinte vetvetiu. Kjo ndodhi në vitin 1967 kur, në shembullin e Revolucionit Kulturor Kinez, feja u ndalua me ligj, xhamitë u shkatërruan, ndërsa vakëfet u konfiskuan nga shteti. Në kushte

14. Shyqyri Hysi, “Reforma Agrare dhe Komuniteti Mysliman”, *Kërkime universitare*, Gjirokastër, nr. 6, 2002, f. 127-134.

15. *AQSH*, F. 482, V. 1946, D. 224, fl. 3.

16. Ligji “Mbi tatimin e fitimit”, *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 31.3.1945.

të tilla ekzistenca e tyre mori fund. Kjo vazhdoi deri në vitin 1991, kur regjimi komunist ra në të gjitha vendet e Evropës Lindore.

V. Vakëfet pas vitit 1991 deri në ditët e sotme

Me vendosjen e pluralizmit politik, institucionet fetare në Republikën e Shqipërisë rifilluan aktivitetin e tyre normal. Por, vështirësitë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ishin të jashtëzakonshme. Kjo për faktin se shumica e xhamive ishin shkatërruar, personeli i kualifikuar mungonte, vakëfet e konfiskuara nga regjimi komunist nuk u kthyen plotësisht. Madje, mund të thuhet se, ende sot e

kësaj dite vetëm një përqindje e vogël e tyre i është rikthyer Komunitetit Mysliman Shqiptar. Legjislacioni i miratuar pas viteve '90 ia shpërndau tokën fshatarëve, duke neglizhuar të drejtën e Komunitetit Mysliman Shqiptar mbi pronat vakëf. Një dukuri e tillë ndodhi edhe në qytete ku, për shkak të tranzicionit politik, individë të ndryshëm kanë përfituar padrejtësisht prona nga vakëfet. Megjithatë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka punuar dhe vazhdon të punojë për evidentimin e dokumentacionit të vakëfeve, si dhe një numër i konsiderueshëm gjyqesh dhe ankimimesh, pranë gjykatave shqiptare, lidhur me rikthimin e vakëfeve, ndiqen me përpikëri.

100-vjetori i shkollës normale të Shkodrës

Prof. dr. Njazi Kazazi
Departamenti i Gjuhësisë
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Siç dihet gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u kthye në një shesh lufte. Në vitin 1916, në territorin e Shqipërisë ndodheshin ushtritë e 5 shteteve të ndryshme. Me gjithë kushtet e vështira të luftës, ku vendi ynë pësoi dëme shumë të mëdha ekonomike dhe ishte i ndarë në tri zona pushtimi, forcat përparimtare, atdhetarët dhe mësuesit popullorë, u përpoqën të shfrytëzonin ato mundësi të krijuara, në dobi të zhvillimit të kulturës dhe të arsimit tonë kombëtar.

1. Hyrje:

Në monografinë “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër” (nga fillimet deri në vitet ‘20 të shek. XX), Shkodër, 2014, botim i U.SH. “L. Gurakuqi” dhe Institutit të Studimeve Albanologjike, faqe 188, kemi trajtuar, veç të tjerave edhe Shkollat e mesme-Medresetë (1896-1925), Kolegji Saverian i Jezuitëve (1877), Kolegja Papnore, Gjimnazi “Illyricum”(1921), Shkolla normale

e Motrave Stigmatine (1922), Shkolla Normale (1917), Gjimnazi i shtetit (1922), etj.

Po japim në mënyrë të përmbledhur pjesën e trajtuar në këtë monografi:

Këtë vit mbushen plot 100 vite që kur u hap Shkolla Normale. Kjo shkollë u hap 8 vjet më vonë se shkolla Normale e Elbasanit, që hodhi themelet e përgatitjes në vend të mësuesve për arsimin tonë kombëtar. Nuk është e rastit që drejtori i parë i Normales së Elbasanit, Luigj Gurakuqi, të jetë

edhe organizatori dhe themeluesi i Normales së Shkodrës.

Luigj Gurakuqi i porositi drejtorinë e shkollave normale, që të punonin seriozisht me nxënësit, duke vënë në dukje: “Mësuesit e shkollave fillore, përveç njohurive të plota që duhet të kenë si në gjuhë e çdo degë tjetër të diturisë, duhet të njohin edhe mjeshtërinë e mësimin në teori dhe praktikim...”¹

Siç dihet gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u kthye në një shesh lufte. Në vitin 1916, në territorin e Shqipërisë ndodheshin ushtritë e 5 shteteve të ndryshme. Me gjithë kushtet e vështira të luftës, ku vendi ynë pësoi dëme shumë të mëdha ekonomike dhe ishte i ndarë në tri zona pushtimi, forcat përparimtare, atdhetarët dhe mësuesit popullorë, u përpoqën të shfrytëzonin ato mundësi të krijuara, në dobi të zhvillimit të kulturës dhe të arsimit tonë kombëtar.

Në zonën e pushtimit austro-hungarez, në gusht të vitit 1916, u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit, që kryente detyrat e organit më të lartë arsimor në tri drejtori:

1. Drejtoria e arsimit me qendër në Shkodër ku hynte: Malësia e Madhe, Dukagjini, Puka, Mirdita, Lezha, Bregu i Matit, Kruja, Dibra e Vogël, Luma, Krasniqja, Gashi.

2. Drejtoria e arsimit me

1. Vehbi Hoti, “Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar”, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002: 216.

qendër në Tiranë, ku përfshiheshin Durrësi, Shijaku, Kavaja, Peqini, Elbasani, Gramshi, Librazhdi, deri në vijën e frontit nga ana Lindore e Juglindore.

3. Drejtoria e arsimit me qendër Beratin, ku bënë pjesë Lushnja, Fieri, Skrapari, Mallakastra.²

Drejtori i përgjithshëm i arsimit u emërua Luigj Gurakuqi për Shkodrën, në fillim qe Gjergj Pekmezi, i cili dha dorëheqjen sepse u zgjodh kryetar i “Komisës Letrare”, në vend të tij u emërua Mati Logoreci; për Tiranën, Sotir Peci; ndërsa për Beratin, Sali Gjuka.

2. Gjendja e arsimit në Shkodër dhe më gjerë:

“Në vitin 1916-17 funksionin 231 shkolla fillore me 294 mësues, kurse në vitin 1917-18 funksionin 200 nga të cilat 35 në qytete dhe 165 në fshatra.”³

Në Shkodër u hapën shkolla në lagjet Perash, Parrucë, Rus i vogël, Dudas, Ajasëm, Shkolla e vajzave në Rrugë të Gjanë, u hap shkolla qytetëse. Në fshat u hapën shkolla në Vrakë, Zagorë, Blinisht, Nikaj-Mërturë, Pukë, Dukagjin, etj. Dhe në përfundim të shkrimit “Shkollat

2. Kolë Koci, “Arsimi gjatë luftës së parë botërore në zonën e pushtimit austro-hungarez”, “Arsimi popullor”, 1965, nr. 4, f. 87.

3. Ilir Kanini, “Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore (Zona e pushtimit Austro-hungarez 1916-18)”, Tiranë, 2001: 57-72.

në Shqipëri”⁴, lexojmë: “Me çilë këto shkolla për një vjetë në një vend të varfën si Shqypënia, pa dyshim asht një punë e madhe fort”.

Për këtë Sali Nivica shkruante: “Prap se prap një pllavë vend si ndodhemi na nuk kishte mundësi me ngreh kaq institute qi nuk mban mend historia ndër ne!”⁵

Ky numër shkollash në këtë zonë nuk u arrit asnjëherë më vonë deri në çlirimin e vendit. Por me gjithë këtë rritje të menjëhershme të mësimi të shkollave para drejtorisë së përgjithshme të arsimit del detyra e mprehtë e përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve. Për këtë Luigj Gurakuqi udhëzon që “... përveç të diplomuarve, ata që kishin një arsim të mjaftueshëm e qi mbas një provimi të bamë jeshin shpresë se mund rritshin praktikën e nevojshme për detyrën e tyre,...të pranoreshin mësues të përkoshëm, me kusht qi të ndjekshin rendet e shpejta qi do të hapeshin në pushimet e verës.”⁶

3. Fillimet e shkollës:

Me vendimin nr. 683/III, datë 23. 03. 1917, u vendos që të hapën dy shkolla normale, njëra në Shkodër

4. “Posta e Shqipnies”, V. I, Nr. 4. 16 dhjetor 1916, f. 4.

5. Sali Nivica: “Shkollat shqiptare në kohë të Austris”, “Populli”, Viti I, Nr. 24, Shkodër 28. 06. 1919, f. 3.

6. L. G. “Përparimi i arsimit në Shqipëri”, “Posta e Shqipënies”, Viti II, Nr. 14, Shkodër, 26. 01. 1918, K/A.

dhe tjetra në Elbasan me drejtorë mësuesit e shquar të kësaj kohe Gaspër Beltoja⁷ dhe Aleksandër Xhuvani. Në këtë shkollë kanë “...me u përgatitë djem për zyra mësuesish ndër shkolla popullore të Shqipënies... në këto shkolla të sigurohet mirë mësimi i gjuhës shqipe, pse pa gjuhë shqiptari s’del shqiptar.”⁸

Pranë këtyre shkollave u hapën edhe kurse pedagogjike, siç e përmendëm më lart, me mësues provizorë në Shkodër, Tiranë, Elbasan Krujë e Berat që siç thekson Luigj Gurakuqi “... fitimi që u nxuar prej sish qe mjaft i pëlqyeshëm...”⁹

Pra, siç shihet atdhetarët shqiptarë, drejtues të arsimit e përqendruan punën në disa drejtime për përgatitjen e kuadrit mësues si në:

a) Hapjen e rendeve të shpejta të shkollave normale dhe shkollave normale të plotë;

b) Kurset e kualifikimit për mësuesit e përhershëm dhe ata provizorë;

c) Dërgimin e nxënësve shqiptarë në shkolla jashtë shtetit.

Kështu, më 1917, u dërguan në Austri 60 shqiptarë (nga të cilët 33 vazhduan mësimet në shkollat

7. Shefik Osmani: “Dy linja paralele në botimet e didaktit G. Beltoja”, “Revista pedagogjike”, 1977/2, f. 122.

8. Cituar sipas Islam Dizdarit: Historiku i shkollës pedagogjike “Sh. Juka” (dorëshkrim), Pjesa II. f. 16.

9. Luigj Gurakuqi, art. i cituar, f. 1.

pedagogjike, 10 në gjimnaz dhe 20 për tregti e zanate), të cilët mbaheshin nga fondet shtetërore.¹⁰

Po kështu u dërguan edhe 13 vajza për të vazhduar shkollën pedagogjike në Austri.¹¹ Të gjitha këto masa Luigj Gurakuqi do t'i përshëndeste kështu: "Nisja e mbarë e punës në këtë kohë të shkurtër jep shpresë të plotë se arsimi e dituria do të bëjnë një përparim të shpejtë të kombit tonë."¹²

Ndërsa për muajin mars të gjithë studiuesit janë në një mendje, për datën e fillimit të punës së shkollës normale ato ndryshojnë. Flitet për 23 dhe 27 mars.¹³

Këtë vit shkolla shërben si rend i shpejtë i Normales për përgatitjen e mësuesve në formën e një kursi pedagogjik, që vazhdoi deri më 13.09.1917.

Këtë rend e ndoqën 7 nxënës, në mes të cilëve Gani Dizdari, Shaqir Xhyheri, etj.

Në muajt korrik-gusht 1917, shkolla shërbeu si kurs pedagogjik për aftësimin e mësuesve të fshatrave të Shkodrës dhe të Krujës (ashtu siç theksuam më lart), ku morën pjesë 40 mësues.

Më 15 shtator 1917 u hap klasa gatimore e normales. Çdo nxënës

duhej të kishte kryer shkollën fillore të plotë me pesë klasë, pastaj shkollën qytetëse me tri klasë dhe mbi bazën e dëftesës pranohej në klasën gatimore të normales.

Klasën gatimore (të hapur më 15. 09. 1917 e deri më 15. 06. 1918) e ndoqën 6 nxënës (tre nga të cilët u larguan brenda vitit). Kaluan në fund të vitit 17 nxënës dhe mbetën 6.¹⁴

Në një dëftesë të kësaj shkolle, konsultuar në AQSH, Tiranë, lexojmë këto vlerësime: sjellje, cënë, besim, këndim, shkrim, gramatikë, hartim, gjuhëgjermanishte, aritmetikë e gjeometri, histori natyre, dituri natyre, gjeografi, histori, kaligrafi, vizatim, këngë, gjimnastikë, trajtë e përjashtme.¹⁵

Në bazë të "Programës për rendin përgatimor të një shkolle normale...", dërguar shkollës nga drejtoria e arsimit Shkodër, kuptohet qartë që organizimi i shkollës normale dhe qëllimi i rendit përgatitor, ishin nën varësinë e kësaj drejtorie.¹⁶

Në pikën A, ku shtrohen rregullat e përgjithshme, theksohet: "Në Shqipni nuk kemi pasur gjer më sot shkolla qytetëse të rregullueme

14. Halim Shpuza, "Shkolla Normale e Shkodrës" në gazetën "Mësuesi", Viti i 12-të, nr. 22, 22 mars 1972: 8.

15. AQSH, Fondi 668, Dosja 3, Fleta 2, viti 1920.

16. "Programa për rendin përgatitor të një shkolle normale", MPSH, FPA, Dosja 1-2, Fleta 1669/1. Shkresa përcjellëse firmosur nga M. Logoreci.

10. "Posta e Shqipënisë", Viti I, Nr. 87, 06. 10. 1917, f. 2.

11. Po aty, Nr. 99 dt. 17. 10. 1917, f. 2.

12. Luigj Gurakuqi, art. i cituar, f. 1.

13. Islam Dizdari në shkrimin cituar shënon dt. 23, kurse Halim Shpuza jep datën 27 mars 1917.

mirë, për të hedhur themelet e një shkolle normale duhet të nisemi një rend përgatitor... rendi përgatitor i shkollës normale ka sidomos për qëllim t'u (japë) nxënësve lavrim ma të gjanë në gjuhën dhe në njiheshim.”¹⁷

Në qarkoren-lajmërim për shkollën normale theksohet se “... ata kanë për t'u arganizua gjithë n'atë mënyrë si pat qenë shkolla e Elbasanit ndë 1909 ndënë qeverimit otoman” dhe porosit “qi nxansvet e vobegtë

sidomos atyre që janë të përjashtëm t'u jepet ndihmë nga mjetet e vendit (p.sh. 50-60 korona).”¹⁸

Shkolla u mbajt me fondet e shtetit dhe me ndihmën e popullit.

Gjatë periudhës 1917-1920 mësuesit e forcat e tjera arsimore bënë përpjekje për të përvijuar e përcaktuar përmbajtjen e mësimit në shkollën normale, hartuan programe, grumbulluan lëndë në shumicën e rasteve ua dhënë me shënime, përgatiten tekste mësimore etj.

17. MPSH, FTP, D. 2, Nr. 1096.

18. Po aty, fq. 2.

4. Plani mësimor i shkollës Normale:

Sipas programit klasa gatimore kishte këtë plan mësimor:

Lëndët:

1. Besim	Orë në javë:
2. Gjuhë mësimi	2 orë në javë
a) Këndim,	7 “
b) Ushtrime përmendësh ligjërimi,	
c) Gramatikë,	
d) Ortografi,	
e) Punë me shkrim.	
3. Gjuhë e dytë (Gjermanisht)	5 “
4. Dheshkronjë e histori	2 “
5. Njehsim	3 “
6. Mësim trajtash gjeometrike dhe vizatim me dorë të lirë	3 “
7. Histori e dituri natyre	3 “
8. Bukurshkrim	1 “
9. Violinë	2 “
10. Kangë	1 “
11. Gjimnastikë	2 “

Shuma: 31 orë gjithsej

Duke i hedhur një sy programit të mësipërm, sipas origjinalit të konsultuar në Muzeun e Shtetit Shkodër, mund të nxjerrim këto përfundime:

Programi i hartuar nga L. Gurakuqi, M. Logoreci e G. Beltoja e mësuesit e tjerë, synonte përgatitjen fillestare, të domosdoshme të nxënësve për të vazhduar normalen. Ky rend përgatitor, siç theksohet edhe në fillim të programit (Pika A) bëhej i domosdoshëm për faktin se në "...Shqipëri nuk ka pasur qytetëse të plota e të rregullta, për të hedhë themelin e kësaj shkolle duhet të nisim sivjet me një rend përgatitor."¹⁹

- Programi synonte edhe në zgjedhjen e nxënësve. "Ata që nuk tregoheshin të zellshëm dhe të aftë brena tre muajve...largohen".²⁰ Kriter tepër i goditur që fatkeqësisht është harruar pas Luftës, duke ulur cilësinë e përgatitjes së mësuesve.

Raporti i grup-lëndëve i shprehur në përqindje ishte:

Lëndët	Sasia e orëve	Vendi që zinte në përqindje %
Besim	2	6
Shoqërore	14	42
Mat-natyrore	7	26
Speciale (estetika)	7	26

Vendin kryesor në planin mësimor e zinte gjuha shqipe me 7 orë në javë e cila kishte ndarjet themelore: këndim, gramatikë, drejtshkrim, zhvillim i ligjëratës e punët me shkrim.

5. Përfundime:

Dhamë disa cilësi të shkollës Normale të Shkodrës, me rastin e 100-vjetorit të saj, që pati një jetë të gjatë në historinë e shkollës shqiptare, për të cilën është shkruar.²¹

19. MPSH, FPA, D. 1, Fleta 1996/1.

20. Po aty.

21. Shkolla e mesme pedagogjike "Shejnaze Juka" (1952-1992) në **"Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane"** të autores Dr. Zenepe Dibra, EBP "Gjergj Fishta", Lezhë, 2016, fq. 590, shkruar nga Njazi Kazazi.

Teknologjizimi i arsimit, sfidë apo progres?

Nuredin Nazarko

Abstrakt

Të arsimobesh sot konsiderohet si një nga gjërat më se normale, madje edhe më të rëndësishmet. Rëndësia e arsimit të qenies njerëzore është kthyer në një bindje aksiomatike, aq sa nuk na intereson më nëse dikush i ka kapacitetet dhe potencialet për të përthithur dhe shprehur njohuritë. Të bindur katërçipërisht se pa kaluar nga hallkat e zinxhirit arsimor nuk ka shans të jesh një qenie njerëzore, të gjithë po rendin të arsimoben, duke ëndërruar më pas një fund të suksesshëm përgjatë përkohësisë. Njeriut i pëlqen të ëndërrojë, të imagjinojë dhe suksese imagjinare, sepse kështu ndoshta lehtëson barrën dhe peshën e tensionit, që buron nga vështirësitë e mëdha në rrugën e të arsimuarit. Evoluimi i shumë ideve dhe praktikave në shoqërinë njerëzore, nuk mund të mos prekte edhe arsimimin. Revolucioni tekniko-informatik ka gjeneruar shumë ëndërrime të shumë syresh, ëndërrime të cilat janë duke i dhënë formë realitetit të të arsimuarit. Ndërtimi i realiteteve mbi baza ëndërrimesh e përfytyrimesh të nxitura nga instrumente artificiale, nuk mund të zbresë në skenë asgjë më shumë përtej mundësive. Të ndodhur mes kësaj gjendje, është detyrë e jona, si qenie në botë, që të përpiqemi, sado flashkët, për të qartësuar idetë dhe përfytyrimet tona, për të larguar vellon e bukur të teknologjizimit, zbukuruar me lulet e progresit. Është më se e natyrshme që ne të përpiqemi t'i çojmë gjërat drejt përmirësimit, drejt lehtësimit. Nuk duhet që, për hir të këtij përmirësimi apo lehtësimi, t'i largohemi qëllimit të parëhershëm. Nuk duhet ta konsiderojmë veten të vetëmjaftueshëm dhe të panevojsbëm për askënd, meqenëse tashmë zotërojmë shkencën, teknologjinë. Këndellja nga këto ëndrra është sfida jonë.

Fjalë kyçe: Teknologjizim, Arsimim, Qenie në mundësi, Progres, Sfidë

Hyrje

Mendojmë se nuk është e tepërt nëse arsimin e përcaktojmë si zemra e një shoqërie, për nga rëndësia që ka për të ndikuar në formësimin dhe zhvillimin e saj. Ashtu sikundërse zemra pompong gjakun drejt organeve për t'i mbajtur në jetë, ashtu edhe arsimi dërgon drejt segmenteve të shoqërisë njerëzit e nevojshëm për t'i shërbyer asaj në profile të ndryshme, me qëllim që të marrë atë çfarë është e nevojshme për të qëndruar në jetë.

Krahasimi i arsimit me zemrën dhe vlerësimin e tij me vlerën, peshën dhe rëndësinë që ka zemra për njeriun, jo thjesht në përmasën e saj fizike, nuk është aksidental dhe i atypëratyshëm. Në qoftë se shoqëria është e nevojshme për njerëz të arsimuar e të kualifikuar, detyrimisht është arsimi ai që i jep atë për të cilën ka nevojë, si p.sh. mësues, pedagogë, juristë, mjekë, inxhinierë, arkitektë, etj. Gjithçka që i duhet dhe i nevojitet shoqërisë kalon nga arsimi dhe pikërisht për këtë shkak arsimit duhet t'i kushtohet një rëndësi e posaçme dhe krejtësisht e veçantë. Nuk duhet thjesht të teoretizojmë rreth rëndësisë së tij.

Kur themi që duhet t'i kushtohet një rëndësi e posaçme dhe krejtësisht e veçantë, nuk e kemi fjalën thjesht dhe vetëm për të mundësuar furnizimin e shoqërisë me profesionistët e nevojshëm. Me "rëndësi e veçantë dhe e posaçme"

nënkuptojmë jo thjesht aftësimin profesional të individit, por, mbi gjithçka, edukimin e qenies njerëzore, që dëshiron të arsimohet. Edukimi dhe profesionalizmi i qenies njerëzore, që dëshiron të arsimohet, duhet të jetë kryefjala e çdo reforme që ndërmerret ndaj hallkave të sistemit arsimor, me qëllim që arsimi t'i shërbejë formësimit të qenies njerëzore sot, që nesër të kemi në shoqëri jo thjesht profesionistë, por edhe qenie njerëzore më së pari.

Përse duhet të na shërbejë arsimi?

Arsimi duhet t'i shërbejë edukimit dhe profesionalizmit të qenies njerëzore. Shpesh kuptimin e edukimit apo profesionalizmit e konsiderojmë gati të parëndësishëm, pasi që kuptimësinë e tyre e quajmë të përfunduar që kur kemi arritur në konkluzionin se tek edukimi ne shohim njeriun e urtë, të butë, të komunikueshëm, qytetarin e mirë, ndërsa te profesionalizmi shohim aftësinë për të kryer dhe përfunduar një punë sa më saktësisht.

Jemi të mendimit se qenia njerëzore asnjëherë nuk duhet të përfundojë në kufijtë e shterueses për çështje të cilat janë pjesë të përkohësisë së tij, aq më tepër kur konceptet që përpiqet t'i shterojë me një shpjegim përfundimtar tipik shkencor, janë të rëndësishë jetike për qenien njerëzore. Këtë fat nuk duhet

ta kenë edhe dy konceptet mbi të cilat përpigjet të ndërtohet sistemi arsimor, edukimi dhe profesionalizmi.

Të kuptuarit dhe të interpretuarit e asaj çfarë ke kuptuar është çështje e rëndësishme e qenies njerëzore. Mundësitë për ta arritur këtë ekzistojnë, për aq sa ekziston edhe qenia njerëzore. Qenia njerëzore në përkohësi është një projekt i hapur ndaj mundësive për realizimin e vetvetes. Kështu, njeriu nuk mund t'i shterojë mundësitë që shtrihen para tij, për realizimin e vetvetes në përkohësi. Njëra prej këtyre mundësive që shtrihet para qenies njerëzore është edhe mënyra se si i kuptojmë dhe interpretojmë konceptet themelore, që afektojnë përfytyrimet dhe qëndrimet tona si qenie në mundësi, madje edhe si e shohim dhe kuptojmë vetë kuptimin e interpretimin.

Sikundërse është e kuptueshme projekti i Dasein është Qenie në mundësi. Kjo *Qenie – drejt – mundësi*, që realizohet, është vetvetja, një mundësi për Qenien, dhe është kështu, si rrjedhim i mënyrës, se si këto mundësi, të pazbuluara, shfaqin përplasjet e tyre te Dasein. Projekti i të kuptuarit, ka mundësinë e tij – që të zhvillojë vetveten. Këtë zhvillim të të kuptuarit ne e quajmë “interpretim”. Brenda interpretimit, të kuptuarit afrohet në mënyrë të kuptueshme, mënyrë kjo që është kuptuar prej interpretimit. Brenda interpretimit, të kuptuarit nuk bëhet diçka tjetër. Bëhet vetvetja. Një interpretim i tillë

është nxjerrë thelbësisht si pjesë e kuptimit; i dyti nuk mund të rrjedhë prej të parit. Interpretimi nuk është as mbledhje e informacionit mbi atë çfarë është kuptuar, më saktë është zbulim i mundësive tashmë të projektuara si pjesë e kuptimit. (Heidegger, 1962, 188-189).

Qenia njerëzore, duke qenë Qenie në mundësi dhe në zhvillim të përhershëm, si rrjedhojë e mundësive ende të pazbuluara përbrenda saj, ka përpara vetes të gjithë hapësirën e mundshme për të kuptuar dhe interpretuar drejt, në rastin tonë edukimin dhe profesionalizmin.

Çfarë kuptojmë ne me edukim dhe profesionalizëm?

Synimi i edukimit të vërtetë s'është që të ndryshojë njeriun drejtpërdrejt (sepse shikuar hollë e hollë, kjo nuk është as e mundshme), por që me shembull, këshillë, pamje o me çfarëdo tjetër, të vërë në lëvizje një rrjedhë të brendshme të përjetimeve, të detyrojë një vendim fare të brendshëm në dobi të së mirës. Pa këtë s'ka ndryshim të vërtetë të njeriut, arrihet vetëm ndryshimi i sjelljeve, që mund të jetë i shtirur ose fare i përkohshëm. Sjellja që nuk angazhon gjakimin tonë më të thellë, që ka ngelur në sipërfaqe, s'është edukim, por dresurë. Edukimi përfshin pjesëmarrjen tonë vetjake, përpjekjen tonë vetjake. Prandaj rezultati i edukimit është gjithmonë i ndryshëm dhe i paparashikueshëm. (Izetbegović, 2009, 125).

Edukimi i kuptuar dhe interpretuar drejt, ka si fokus njeriun me të gjitha mundësitë e tij, të zbuluara apo të pazbuluara ende, prandaj dhe synon ta trondisë, ta vendosë në lëvizje përbrendësinë e njeriut drejt së mirës. Gabimisht besohet se këtë gjë mund ta realizojë vetëm arsimi. Minimizohet deri në zhdukje roli i familjes. Është e rëndësishme të theksohet se arsimi mund të hapë horizonte të reja ku qenia njerëzore dëshiron të arrijë, ku qenia njerëzore mund të arrijë të shfaqë mundësitë ende të pazbuluara brenda saj, por mbjellja e farës së edukimit të njëmendtë mbetet detyrë thelbësore e familjes. Pa rolin përcaktues të familjes në edukim, suksesi i arsimit në këtë pjesë mund edhe të vihet në dyshim. Ne nuk mund ta përcaktojmë të suksesshme një shoqëri ku vetëm arsimi përfytyrohet dhe perceptohet si edukues i breznive të reja. Përkrahësit e këtij përfytyrimi mund edhe të kërkojnë statistika të prekshme për përqindjen e qenieve njerëzore që janë edukuar nga sistemi arsimor, duke e konsideruar edukimin një eksperiment në fund të të cilit duhet të kemi një substancë konkrete në provëz. Por a mund të jetë edukimi i njëmendtë substancë konkrete në provëz?

Edukimi është i pakapshëm dhe subtil, fare i tërthortë, ndikim në shpirtin e njeriut me dashuri, me shembull, me përdëllim, madje edhe me dënime, që vënë në lëvizje

një aktivitet të brendshëm dhe e ndryshojnë njeriun. Dresura, shtazore në esencë, është sistem i masave dhe i veprimeve që shtaza njerëzore të detyrohet në sjellje të caktuar, në të a.q. sjellje të drejtë. Edukimi i përket njeriut, dresura shtazës. (Izetbegović, 2009, 125).

Për sa i përket profesionalizmit duhet të themi se nuk është e mjaftueshme që puna që ka marrë përsipër qenia njerëzore për ta kryer, të kryhet saktë. Përtej saktësisë, ajo çfarë është më e rëndësishme, sidomos kur fokusi i veprimtarisë është qenia njerëzore në formim, profesionalizmi më shumë sesa saktësi, është përgjegjshmëri. Përgjegjshmëria nga ana e vet është vetë ekzistenca njerëzore, sepse të ekzistosh, do të thotë të jesh përgjegjës për mënyrën se si e jetëson jetën tënde si qenie në mundësi, apo si qenie në botë. Kryerja me përgjegjshmëri e një profesioni të caktuar është rrjedhim i drejtpërdrejtë i të kuptuarit dhe interpretuarit të ekzistencës njerëzore. Prandaj kur shtruar pyetjen se përse duhet të na shërbejë arsimi, kishim si synim të nxirrnim në pah pikërisht rolin që mund të luajë arsimi për ta grishur qenien njerëzore drejt horizonteve dhe mundësive që ende nuk i ka zbuluar brenda vetvetes, pa devijuar kuptimin e njëmendtë të gjërave dhe në rastin tonë të edukimit dhe profesionalizmit.

Teknologjizimi i arsimit - një tendencë tunduese

Nevoja e shoqërisë për të pasur profesionistë në gjirin e saj, gjithmonë e ka grishur njeriun për të sjellë modele arsimimi, në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të shoqërisë. Bazuar në nevojat e shoqërisë dhe në dëshirat konsumeriste të saj, reformimi i vazhdueshëm i arsimit synon që të ketë gjithmonë një përputhshmëri ndërmjet këtyre nevojave dhe kurrikulave që do të mësohen e studiohen. Për të pasur një efikasitet sa më produktive dhe duke iu përshtatur ritmeve bashkëkohore të zhvillimeve teknologjike, edhe arsimi nuk mund të shpëtonte nga tendenca teknologjizuese. Lehtësirat që ka krijuar teknologjia janë më se të prekshme edhe në fushën e arsimit. Sot mund të kemi një qasje shumë më të shpejtë dhe më rezultative ndaj njohurive, e-book, bibliotekave online, etj. Natyrisht që kjo lehtësi për akses të mundësitë e sigurimit të shpejtë të diçkaje që na nevojitet, si p.sh. përdorimi i një fjalori online, shkarkimi falas i llojeve të ndryshme të librave, mund të konsiderohet me të drejtë një mundësi e madhe për këdo që dëshiron të lexojë.

Zhvillimi i teknologjisë dhe fuqizimi i saj duke ndërhyrë pothuaj në çdo sferë të jetës në ditët e sotme, dha efektet e veta edhe te ndryshimi mbi mënyrat e transmetimit të njohurive. Transmetimi i njohurive

tashmë ka si kryefjalë përdorimin e teknologjisë së informacionit. Klasat teknologjike në shumë vende janë një realitet i prekshëm dhe më se normal. Kjo tendencë pritet të gjejë zbatim edhe në vendet më pak të zhvilluara dhe që e kanë të vështirë ta anashkalojnë këtë realitet të ri të krijuar nga ndërhyrja e teknologjisë deri edhe në detaje të jetës së njeriut. Pritshmëritë janë të mëdha. Besimi se me teknologjizimin e arsimit do të hapet një epokë e re dhe tepër produktive, duket të jetë tepër nderzullitës. Në sajë të kësaj nderzullie, jemi gati të investojmë qoftë edhe shuma të konsiderueshme për krijimin e klasave teknologjike, me shpresën se duke ndërfutur teknologjinë të njohuritë, këto të fundit do të na ngjallin më shumë interes në sajë të zbukurimeve teknologjike, që do të shoqërojnë shpjegimet apo komentet mbi njohuritë. *De facto*, kjo lloj mënyre e transmetimit të njohurive, duket të jetë tepër tunduese. Në qoftë se arrin të realizosh orë mësimore ku integrohet edhe teknologjia e informacionit, do të konsiderohesh i suksesshëm dhe ndjekës i ritmeve bashkëkohore të zhvillimit.

Sfidë apo progres

Duke iu referuar dy parashtrimeve të mësipërme, mbërrijmë te pyetja së cilës nuk mund t'i shmangemi dhe as ta

lëmë në harresë, përderisa çështja që shtrohet është e një rëndësie të veçantë. Teknologjizimi i arsimit është një sfidë apo progres?

Mund të themi pa asnjë mëdyshje se kur përmendet fjala progres, apo kur diskutohet për progres, natyrisht që nëpër mend nuk mund të na kalojë asgjë negative rreth progresit, madje gjithmonë progresi është konsideruar lëvizje në drejtimin pozitiv, përparim dhe zhvillim. Ky perceptim ndaj progresit nuk është i rastësishëm. Zhvillimi materialist, veçanërisht pas Revolucionit II Industrial e thelloi rrënjosjen me karakter pozitiv të progresit në vetëdijen e njeriut, aq sa, sot, termi progres është kthyer në emëruesin e të gjitha zhvillimeve që çojnë drejt rritjes së fuqisë materiale, apo rritjes së mundësive për sundim ndaj natyrës.

Lëvizjen nëpër këto rrugina ne e quajmë Progres. Kjo ishte motoja e madhe e shekullit të kaluar. Njerëzit e panë historinë para tyre si një rrugë në të cilën marchoi me trimëri dhe gjithmonë përpara “njerëzimi”- në kuptimin e këtij termi të racave të bardha, ose më saktësisht, banorët e qyteteve të tyre të mëdha, apo edhe më saktë, “të arsimuarit” midis tyre.

Po për ku? Për sa kohë? Dhe çfarë ka më pas?

Ishte paksa qesharak ky marshim drejt pafundësisë, drejt një objekti, të cilin njerëzit nuk e kishin menduar seriozisht, apo kuptuar qartësisht me

veten e tyre, ose realisht, nuk kishin guxuar ta parashikonin, sepse një objektiv është një fund. Askush nuk bën gjë pa menduar për çastin kur ai do ta ketë fituar atë që dëshironte. Askush nuk fillon një luftë, një udhëtim, apo madje edhe një shëtitje të thjeshtë pa menduar për drejtimin dhe fundin e saj. Çdo qenie njerëzore vërtet krijuese e di dhe i druhet boshësisë që pason pas kryerjes së një pune.” (Spengler, 2010, 22)

Shqetësimi që ne duhet të kemi para se ky proces të marrë trajtën e plotë është pikërisht boshësia. A do të jetë arsimi më i zhvilluar, më progresiv, sikundërse na pëlqen ta dëgjojmë të thuhet, në përfundim të teknologjizimit? A do të arrijë teknologjizimi i arsimit të shmangë pikërisht boshësinë, të cilën nuk duam ta mendojmë si fundin e pashmangshëm të një ndezullie të ushqyer nga fuqia e afektimit teknologjik?

Njeriu ishte dhe është tepër i cekët dhe frikacak për të duruar faktin e vdekshmërisë së çdo gjëje që jeton. Ai e mbështjell atë me një optimizëm të progresit të bojatisur me ngjyrë rozë, stivon mbi të lulet e literaturës, zvarritet pas strehës së idealeve për të mos parë asgjë. (Spengler, 2010, 23)

Duke iu referuar teknologjizimit të arsimit, thjesht dhe vetëm si progres i paevitueshëm, apo si arsimi i së ardhmes, që çuditërisht besohet se do të jetë ende më e mirë nën fuqinë

ndërhyrëse në rritje të teknologjisë në jetën e qenies njerëzore, i shmangemi përballjes me një të vërtetë të madhe, perkufizimin e veprimtarisë sonë nga fuqia e makinës dhe nënshtrimin para saj.

Makina punon dhe e detyron forcërisht njeriun të bashkëpunojë. E tërë kultura arrin një nivel aktiviteti të tillë që toka fërgëllon nën të. (Spengler, 1928, volume two, 503)

Padroni i botës po bëhet skllav i makinës, e cila po e detyron atë - po na detyron ne të gjithëve, jemi apo nuk jemi të vetëdijshëm për këtë - të ndjekë kursin e saj. (Spengler, 2010, 87)

Përpara se ne të përshkojmë tejpertej shkretëtirën e akullit të makinës nën vapën përcëlluese dhe etjen torturuese për ujë, le të mendojmë për mirazhin në fund të horizontit ku shikimi ynë thyhet dhe bëhet njësh me të. Teknologjizimi i arsimit masivisht dhe thellësisht doemos do të na vendosë përballë kësaj gjendje serioze. Më lehtë e kemi ta përfytyrojmë një vend nga imazhet që na vijnë nga teknologjia, sesa ta vizitojmë dhe përfytyrojmë më pas nga gjurmët që ka lënë në shpirtin tonë kjo vizitë. Edhe kur soditim natyrën, nuk e soditim më për të medituar rreth saj. Çdo gjë e soditur, në zemrën dhe trurin tonë perkthehet në mundësi për shfrytëzim dhe përfitim, një ujëvarë në energji elektrike, një pyll në lëndë drusore, etj. Asgjë jashtë termave të fitimit.

Të gjendur nën presionin në rritje të teknologjizimit, të përçimit të njohurive dhe nën presionin e kohës së pamjaftueshme (*45 apo 60 minuta për orë mësimi*) për të shpjeguar e komentuar koncepte të rëndësishme, rrjedhojat nuk do të jenë aspak në kohezion me pritshmërinë për një arsim cilësor dhe më njerëzor. Qoftë shpjeguesi, qoftë dëgjuesi detyrohen të konturojnë veprimtarinë e tyre mbi ide të gatshme apo të sugjeruara nga dikush tjetër. Jo se këto ide të gatshme apo të sugjeruara i konsiderojmë tërësisht të pavlefshme, por të ofruarit e zgjidhjeve të gatshme mban peng, madje e çon drejt shterpësisë forcën menduese, duke e asgjësuar gati tërësisht, pasi që me rëndësi është aftësimi dhe jo të menduarit.

Familje, monogami, romancë. Kudo mbyllje në vetvete, kudo kanalizim i ngushtë i impulseve dhe energjisë. “Por çdokush i perket çdokujt.” - e përmbylli ai duke cituar një proverb hipnopedik. Studentët pohuan me kokë, duke rënë dakord prerazi me pohimin, të cilin më shumë se gjashtëdhjetë e dy mijë përsëritje në errësirë ia kishin bërë ta pranonin jo thjesht si të vërtetë, por si aksiomatik, të vetëkuptuar e krejtësisht të padiskutueshëm. (Huxley, 2012, 45)

Fuqia e teknologjisë po e strukturon arsimin drejt shërbimit ndaj nevojave që ka shoqëria. Rrjedhimisht, nuk është më arsimi

që modelon shoqërinë, por është forca e modelit shoqëror që po e detyron arsimin të mbështillet e çmbështillet sa herë që nevojat e shoqërisë ndryshojnë kurs.

Bartja e dijeve nuk ka më për qëllim të formojë një elitë të aftë që të udhëheqë kombin në emancipimin e tij; ajo i jep sistemit lojtarë të aftë që të kryejnë si duhet rolin e tyre në postet pragmatike për të cilat institucionet kanë nevojë. (Lyotard, 1996, 102)

Thëllimi i teknologjizimit dhe perceptimi i këtij procesi si zgjidhjedhënësi i dembelizmit për të lexuar nga ana e nxënësve, studentëve, mësuesve apo dhe pedagogëve, natyrisht që ka dhe përjashtime, nuk është as më shumë dhe as më pak se një ndezulli e pastër. Pasi të realizohet kjo ndezulli do të na nxjerrë në shtegun e boshësisë dhe çfarë shtrihet pas saj. Atëherë ndoshta të frikësuar do të themi: Po tani? Lojtarët e sistemit mund të jenë të aftë, specialistë të zotë, por nuk janë ende gati për të jetuar, nuk janë ende gati për të menduar, sepse zgjidhjet janë të servitura tërësisht të gatshme.

Vendi i “kjo do të jetë kështu” dhe “duhet të jetë kështu” është zënë nga e papërkulshmja “kjo është kështu”, “kjo do të jetë kështu”. (Spengler, 2010, 19)

Nën moton e të papërkulshmes, “kjo është kështu”, “kjo do të jetë kështu”, rreziku më i madh që i

kanoset qenies në mundësi është rrënimi i të menduarit, në emër të performativitetit të sistemit shoqëror.

- Po Shekspirin a e lexojnë?
- e pyeti i egri ndërsa ata po ecnin rrugës për te Laboratorët Biokimikë, matanë Bibliotekës së shkollës.

- Sigurisht, që jo, - tha madama dhe u skuq në fytyrë.

- Biblioteka jonë, - tha doktor Gafni, - nuk përmban vetëm libra reference. Nëse të rinjtë kanë nevojë për argëtim, këtë munden ta marrin te kinemaja e ndjesive. Ne nuk i nxisim të plotësojnë dëshirat me dëfrime vetmitare. (Huxley, 2012, 138)

Në erën e teknologjizimit të arsimit, qëllimi përfundimtar do të jetë rendi dhe uniformiteti, konformizmi dhe asgjësimi i personalitetit. Të gjithë të arsyetojnë në të njëjtën mënyrë. Të gjithë t'i zgjidhin problematikat në të njëjtën formë. Të gjithë të përvetësojnë dhe memorizojnë të njëjtat ide. Të gjithë të zhvishen nga ndjenjat njerëzore, duke i kthyer drejt nënshtrimit ndaj dëshirave konsumeriste.

Humbja e unit, zëvendësimi i tij me një pseudo-un, e lë individin në një gjendje të thellë pasigurie. Ai është i mbërthyer nga dyshimi, pasi duke qenë, në thelb, një refleks i asaj që të tjerët presin prej tij, në njëfarë mënyre ka humbur identitetin e vet. Për të mundur panikun që buron nga humbja e identitetit, është i

detyruar të konformohet dhe të kërkojë identitetin e vet në miratimin e vazhdueshëm dhe në njohjen e vazhdueshme nga ana e të tjerëve.

Në qoftë se nuk e di më se kush është, të tjerët do t'ia mësojnë, në qoftë se, të paktën, konformohet me modelin e tyre, në qoftë se i imiton. Unë do të jem ky që ju dëshironi që unë të jem.

Shndërrimi i individit në një automat në shoqërinë moderne e ka shtuar ndjenjën e pafuqisë dhe të pasigurisë së njeriut të mesëm. Prandaj ky është gati për t'iu nënshtruar autoriteteve të reja që i premtojnë sigurinë dhe lirinë nga dyshimi. (Fromm, 1998, 155)

Edhe pse ende jemi duke u ndezullitur nga ideja se teknologjizimi i arsimit do të na lehtësojë e do të hapë dritare të reja në përçimin e njohurive, nuk do të vonojë koha kur do të na duhet të kryejmë një operacion të thellë reflektimi, mbi krijesat aidentitare që i kemi kultivuar para syve tanë në emër të një performativiteti më të mirë, si kusht për kontributin pozitiv në shoqëri. Por a mund të konsiderohet një kontribut pozitiv, fakti që këta individë aidentitarë janë të gatshëm, që në emër të sigurisë dhe çlirimit nga dilemat, të hedhin poshtë dhe të shkelin me të dy këmbët lirinë, si gjënë më të panevojshme dhe të neveritshme të njeriut?

Çfarë lirie është ajo, gjykove ti, nëse bindja është blerë me bukë?

Ti kundërshtove; njeriu, the ti, nuk rron vetëm me bukë. Por e di ti, se në emër të kësaj buke, shpirti i tokës do të rebelohet kundër teje, do të ndeshet me ty, do të mposhtë dhe njerëzit do t'i shkojnë pas duke ulëritur: “Kjo egërsirë na dha zjarrin nga qiejt!” E di ti, se do të kalojnë shekuj dhe njerëzimi, me buzët e përfaqësuesve të vet të urtë, me gjuhën e shkencës do të deklarojë se krimi nuk ekziston, pra, nuk ekziston as mëkati, ekziston vetëm uria, uria dhe të uriturit.” (Dostojevski, 1994, 250-251)

Një arsim i teknologjizuar, me shumë gjasa mund të na çojë drejt këtij përfundimi, pasi që përmes fuqisë së teknologjisë ai do të mrekullohet prej mundësive që do t'i ofrohen për konsum. Nënshtrimi ndaj vërshimit të dëshirave, thjesht dhe vetëm konsumeriste, do të jetë një masë opake, që do të ketë impakt të fuqishëm pengues ndaj përpjekjeve për realizimin e qenies në mundësi. Nën pushtetin e të jetuarit për t'u ushqyer, teknologjizimi i arsimit vetëm se do ta fuqizojë edhe më tepër këtë pushtet. Realisht do të kemi njerëz të arsimuar, por që nuk duan të mendojnë me terma të tjerë jashtë konsumit. Ky përfundim mund të jetë një shërbim i mirë për ekonominë e konsumit që operon në termat e prodhim - konsum - fitim, por nuk mund të jetë i tillë për qenien në mundësi. Masa e magnetizuar nga një arsim i teknologjizuar, do të ketë

si fokus kryesor të veprimtarisë së saj vetëm funksionin dhe asgjë tjetër jashtë funksionit.

HEIDEGGER: Çdo gjë funksionon. Kësisoj, është pikërisht kjo, ajo çfarë është e çuditshme. Çdo gjë funksionon dhe funksioni po na detyron forcërisht gjithmonë e më tepër në më shumë funksione, dhe teknologjia është duke i penguar dhe larguar njerëzit prej tokës gjithmonë e më shumë. Unë nuk e di nëse ju ndiheni i frikësuar; isha vërtet i frikësuar, kur kohët e fundit pashë fotografitë e tokës të marra prej hënës. Ne nuk kemi nevojë për një bombë atomike, gjithsesi; largimi i qenieve njerëzore nga toka tashmë është duke ndodhur. Ne kemi thjesht kushte teknologjie. Nuk ka më një tokë, në të cilën të jetojnë qeniet njerëzore sot.

Kohët e fundit pata një bashkëbisedim të gjatë me Rene Char në Provence – siç e dini, poet dhe luftëtar i Rezistencës. Baza raketash janë duke u ndërtuar në Provence, dhe vendi është shkretuar në një mënyrë të pabesueshme. Poeti, i cili sigurisht nuk mund të jetë pjesë e dyshimeve sentimentaliste apo lavdërimeve idilike, më tha që largësia e qenieve njerëzore nga toka, e cila është duke vazhduar të ndodhë, do të prekë fundin, nëse të menduarit dhe poezia nuk sigurojnë edhe njëherë një pushtet jo të dhunshëm.

(Der Spiegel, 1976, <http://web.ics.purdue.edu/~other1/Heidegger%20Der%20Spiegel.pdf>).

Kjo rrjedhojë e zaptimit të hapësirës ekzistenciale të qenies në mundësi nga pushteti i teknologjisë nuk mund të jetë as më shumë e as më pak rezultat i faktit që “shkenca nuk mendon”. (Heidegger, 2003, 102)

Në mes të këtij zaptimi gjendet edhe arsimi edhe ata të cilët hyjnë e dalin nga dyert e arsimit. Nën pushtetin e teknologjisë do të vazhdojë të dehumanizohet edhe më tej, i ndihmuar edhe nga vetë ata të cilët mundësitë e tyre për të përcjellë njohuri, dije, i përkuftizojnë në funksion të teknologjisë, duke mënjanuar pothuajse tërësisht pjesën e shpirtit në përçimin e njohurive. Janë apo jo të vetëdijshëm mbi gjendjen në të cilën gjendemi, janë apo jo të vetëdijshëm mbi statusin qenie në botë, çështja e këtij statusi është një çështje e rëndësishme drejt së cilës duhet të rikthehemi. Ky rikthim është kusht i domosdoshëm për rihapjen e një dritare shprese, që arsimimi i brezave të rinj të mos përfundet tërësisht nën pushtetin e teknologjizimit, bazuar në mitin e progresit.

Ky rikthim dhe kjo rihapje duhet të jenë të lidhur ngushtësisht me forcimin e dashurisë ndaj librit. Nuk duhet humbur shpresa se edhe në epokën teknologjike, mund të dashurohemi me librin dhe të

jetojmë me të, ashtu siç jetojnë të dashuruarit për njëri-tjetrin. Libri, kjo radhitje e magjishme fletësh do të jetë aty, përballë nesh, duke sfiduar ngërthimin tonë me teknikën. Duke qëndruar përballë nesh, duke na rrethuar i radhitur me rregull ose jo nëpër rafte, na grish vazhdimisht për t'iu qasur me dashuri.

Sa për mua, unë fshihesha diku për t'u lëshuar në një punë të çuditshme: leximin e librave të bibliotekës. (Borges, 2010, 223)

Libri është thjesht i pazëvendësueshëm dhe i pakrahasueshëm me çfarëdoj versionit elektronik. Magjia që buron nga fëshfërima e kalimit nga një fletë në tjetrën është tepër domethënëse për shpirtin që lexon. Teknika nuk mund të ta japë këtë domethënie të kësaj magjie, sado e sofistikuar të jetë. Është pikërisht kjo pamundësi e teknikës për të ndërhyrë në të tilla sfera, ajo që na gëzon. Vetëm kështu ne mund të kërcejmë drejt librit. Vetëm kështu, të dashuruarit me thellësitë do të jenë në gjendje të nxjerrin prej andej perlat dhe gurët e çmuar, vlera e të cilave dhe e të cilëve nuk mund të zhvlerësohet nga asnjëlloj shkëlqimi i rremë dhe fare i përkohshëm.

Përfundime

Ndalë së mësuari, fillo të dish, - na thotë poeti.

Përsikaj tendencave tunduese teknologjizuese të arsimit, rolit

gjithmonë e në rritje të teknikës në përkufizimin e përfytyrimit dhe veprimtarisë së qenies njerëzore, duke e bërë njeriun të besojë për të vërteta qoftë edhe gjëra të paqena, duke e thatëzuar paqshëm të menduarit të kjo qenie, ka ende shpresë se jo gjithçka do të tretet e përfundet nën pushtetin e teknologjisë dhe miteve të ushqyera prej saj.

Roli i arsimit në epokën e teknologjizimit, duhet të jetë në shërbim të qenies njerëzore si qenie dhe jo si automat. Për t'i shërbyer këtij qëllimi, shërbimit ndaj qenies njerëzore si qenie në botë, arsimit me të gjithë hallkat e tij duhet të jetë gjithmonë e më tepër kulturor.

Po qe se do të duhej të vlerësojmë përmbajtjen kulturore të arsimit shkollor, do të thoshim: shkolla është pjesë përbërëse e civilizimit; ajo kontribuon kulturën vetëm nëse nuk është dresurë, nëse zhvillon mënyrën e të menduarit kritik, nëse i lë hapësirë lirisë shpirtërore të njeriut. Shkolla që servir dhe imponon zgjidhjet e gatshme etike e politike, nga aspekti i kulturës, është barbare. Ajo nuk krijon personalitete të lira, veç të nënshtuara dhe si e tillë mbase kontribuon civilizimin, por e shpie prapa kulturën. (Izetbegović, 2009, 71)

Kritika që adresuam përkundrejt teknologjizimit të arsimit si kontribuues i civilizimit, nuk nënkupton domosdoshmërisht rrënimin e plotë të tij. Njeriu ka

nevojë edhe për pjesën qytetërimore, por arsimi nuk duhet të jetë shëgert i kontributit të mbisundimit të pjesës qytetërimore përkundrazi pjesës kulturore të qenies në botë.

Kur kritikohet civilizimi, nuk kërkohet që të flaket. Edhe sikur të donim, civilizimi nuk mund të flaket. Ajo që duhet bërë dhe mund të bëhet është të rrënohet miti mbi të. Rrënimi i këtij miti është kusht për humanizimin (kthimin e njerëzores te qenia njerëzore, N.N.) e mëtejme të botës dhe detyra më e madhe e kulturës. (Izetbegović, 2009, 91)

Në pyetjen që parashtruam si tematikën e kësaj trajtese, teknologizimi i arsimit, sfidë apo progres, ne nuk synonim qysh në fillim që të përfundonim në një përgjigje shteruese. Ne dëshiroam (donim) që nëpërmjet kësaj trajtese të grishim mundësitë ende të pazbuluara të qenies në mundësi, për t'u kthyer me një kthim të njëmendtë drejt statusit qenie në botë, që të mos marrakotet nën pushtetin e përfytyrimeve dhe miteve të teknologjizuara mbi të ardhmen e tij.

*Ducunt Fata volentem, nolentem
trahunt*

Referencat

- Heidegger, M. (1962). *Being and time*. San Francisco: Harper Collins.
- Izetbegović, A. (2009). *Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit*. Shkup: Logos
- A.
- Spengler, O. (2010). *Njeriu dhe teknika*. Tiranë: Helgas's Secrets.
- Spengler, O. (1928). *Decline of the west, volume two*. New York: Knopf Doubleday.
- Huxley, A. (2012). *Më e mira e botëve*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Lyotard, J-F. (1996). *Gjendja postmoderne: raport mbi dijen*. Pejë: Dukagjini.
- Fromm, E. (1998). *Arratisje nga liria*. Tiranë: Phoenix.
- Dostojevski, F. (1994). *Vëllezërit Karamazov, vëllimi I*. Tiranë: Tirana.
- Heidegger, M. (2003). *Leksione dhe konferenca*. Tiranë: Plejad.
- Borges, J. L. (2010). *Biseda*. Tiranë: Tirana Times.
- Der Spiegel. (1976, May 31). *Der Spiegel Interview with Martin Heidegger (1966)*. Riqjetur nga <http://web.ics.purdue.edu/~other1/Heidegger%20Der%20Spiegel.pdf>

Korpusi i mbishkrimeve osmane në Vlorë dhe Gjirokastrë

Dr. Mehmet Tütüncü

Qendra Botërore e Kërkimeve për Gjuhën Turke dhe Arabe,
Haarlem, Hollandë

Abstrakt

Ky është një studim dhe botim rreth mbishkrimeve osmane në jug të Shqipërisë, të përcaktuara si zona ndërmjet Vlorës dhe kufirit grek. Gjatë viteve të fundit, janë zbuluar shumë mbishkrime të reja (kryesisht të varreve), nga studiues të huaj dhe vendas. Mbishkrimeve të njohura nga literatura (Evlija Çelebi dhe të tjerë) u janë shtuar këto mbishkrime të reja të zbuluara. 25 mbishkrime nga kjo zonë, të cilat datojnë që nga viti 1542 deri në 1897, janë botuar këtu si pjesë e Korpusit të mbishkrimeve osmane në Shqipëri. Mbishkrimet janë studiuar në kontekstin e tyre historik dhe kulturor. Ato përmbajnë informacione në lidhje me aktivitetet në fushën e ndërtimit, jetën dhe kulturën e asaj zone gjatë shekujve të sundimit osman në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Mbishkrime osmane, xhami.

1. Hyrje

1.1 Korpusi i mbishkrimeve osmane në Shqipërinë Jugore (mbishkrimet e varreve dhe themelet)

Shqipëria e Jugut nuk është shumë e pasur me mbishkrime osmane. Midis Vlorës dhe kufirit grek ekzistojnë

vetëm 25 mbishkrime të regjistruara. Katër nga këto mbishkrime (nr. 2-5), janë të njohura nga veprat e Evlija Çelebiut dhe literaturës përkatëse. Këto mbishkrime në ditët e sotme kanë humbur. Megjithatë, ato janë mjaftueshëm të rëndësishme për historinë e rajonit për t'i përfshirë këtu në Korpusin tonë. 21 mbishkrime të tjera ekzistojnë ende dhe kryesisht janë publikuar për herë të parë në këtë

punim. Mbishkrimet përgjithësisht janë në gjendje të keqe dhe janë kryesisht të dëmtuar. Sidomos gjatë regjimit komunist, mbishkrimet janë shkatërruar qëllimisht. Kudo që të

jetë e nevojshme, mbishkrimet do të shoqërohen me seksionet përkatëse të përshkrimeve të qyteteve dhe ndërtesave të paraqitura nga Evlija Çelebiu.

Tabela 1. Inventari i mbishkrimeve
Vendi Data

Vlorë, Xhamia e Sulltan Sulejmanit	935 Hixhri -1528-29 E.S.
Çezma e Iljaz Pashës (Evlija 140)	949 Hixhri -1542 E.S.
Mbishkrimi në kështjellën e Kaninës.	1528 E.S - 1542 E.S.
Gjirokastra. Xhamia e Sulltan Bajazidit	1645 E.S -1669 E.S.
Gjirokastër, Xhamia e Teqesë	1145 Hixhri -1732-33 E.S. (?)
Gjirokastër, Xhamia e Pazarit	1177 Hixhri -1763-64 E.S.
Gjirokastër, Varri i Shejh Hasanit Halveti	1221 Hixhri -1806-07 E.S.
Gjirokastër, Varri i Shejh Sulejman Halvetiut	1268 Hixhri -1852 E.S.
Gjirokastër, Mbishkrimi te burimi Avli Manat	1273 Hixhri -1858 E.S.
Libohovë, Gurvarri	1278 Hixhri -1861-62 E.S.
Libohovë, Gurvarri	1283 Hixhri -1866-67 E.S.
Gjirokastër, Xhamia dhe kroi i Haxhi Muratit	1284 Hixhri -1867-68 E.S.
Libohovë, Gurvarri	1287 Hixhri -1870-71 E.S.
Gjirokastër, Xhamia e Dunavatit	1304 Hixhri -1887 E.S.
Libohovë, Gurvarri i Maliq Pashës	1309 Hixhri -1892 E.S.
Delvinë, Gurvarri Xhërmëhallë,	1315 Hixhri -1897 E.S.
Libohova, Gurvarri i Safet Beut	Pa datë

Tabela 2. Mbishkrimet publikohen në vijim sipas qyteteve ku janë gjetur

Vlora dhe Kanina	3 mbishkrime
Gjirokastra	9 mbishkrime
Libohova	5 mbishkrime

Janë gjithsej nëntë varre të cilët i mbijetuan vandalizmit të shekullit të 20-të dhe 16 ndërtesa apo mbishkrime të restauruara si dhe dy grafite, të cilat janë zbuluar kohët e fundit (nr 24); grafiti tjetër është zhdukur kohë më parë (nr. 4).

2. Vlorë

Vlorë, porti i dytë më i madh në Shqipëri, sot i është i pozicionuar në një gjë natyror madhështor. Ajo shërbeu si bazë për operacionet e 1480 kundër Italisë së Jugut, gjatë fushatës së Fatih Sulltan Mehmetit dhe Gedik Ahmet Pashait; më 1537, Sulltan Sulejmani qëndroi për më shumë se një muaj në Vlorë gjatë fushatës së Korfuzit. Gjatë periudhës së sundimit të tij, ai urdhëroi të ndërtoheshin disa vepra të rëndësishme në kalanë e Kaninës, në Vlorë u ndërtua një xhami e vogël dhe e bukur si dhe kalaja e Vlorës. Ekzistojnë 3 mbishkrime që nga koha e Sulltan Sulejmanit, të gjitha të përshkruara nga Evlija Çelebi. Vetëm mbishkrimi i xhamisë ka mbijetuar deri në ditët e sotme. Evlija Çelebiu e përshkruan Vlorën si më poshtë:

Porti dhe kalaja e Vlorës

Vlorë u themelua nga Sulltan Sulejmani, i cili urdhëroi që ajo të ndërtohej në formën e një oborri (avlu) me pamje nga deti, për të mbrojtur gjirin e Vlorës nga sulmi i venedikasve dhe kur përfundoi ndërtimi i qytetit, atij iu dha emri Avluya. Ky emër figuron në Zyrat e Gjendjes Civile Perandorake si Sanxhaku i Vlorës-Avlonya. Kalaja e Vlorës është ndërtuar në një terren të ulët me rërë, në hyrje të Gjirit të Vlorës dhe Gjirit të Dukatit. Është me formë tetëkëndore dhe është shumë e fortë dhe solide, një mur vërtet madhështor i Sulltan Sulejmanit. Njerëzit thonë se osmanët nuk dinë të ndërtojnë kështjella,

por ai që nuk ka parë pallatet e Szegedit, në kufirin e Eger, kalanë e Bender, në brigjet e lumit Dniestër në kufirin e Ochakov, dhe këtë kala të Vlorës, nuk mund ta kuptojë dot se sa mjeshtërore mund të jenë veprat osmane të ndërtimit. (Përkth. nga Dankoff dhe Elsie 1999, f. 135)



Figura 1. Mbishkrimi i Sulltan Sulejmanit

2.1 Mbishkrimi i Sulltan Sulejmanit

Ky është padyshim një nga mbishkrimet më historikë dhe më të rëndësishëm të prezantuar në Korpusin tonë (Fig. 1). Kjo për shkak se ai i referohet dy personave të rëndësishëm: i pari është një udhëheqës fetar dhe tjetri është Sulltan Sulejmani. Mbishkrimi është fiksuar tashmë në muret e Xhaminë e Pashallerrevës-s, e cila është ndërtuar në shekullin e 20 nga Reshid Pasha. Mbishkrimi është kopjuar pa gabime nga Evlija Çelebi në *Seyahatname*-n e tij të famshme:

Në të gjitha ato, ekzistojnë [...] minberë lutjesh. Në mesin e tyre ngrihet magjepsëse Xhamia e Sulltan Sulejmanit me një kupolë të gdhendur në gur, e mbuluar me plumb dhe me një minare të rrëzuar. Mbi derën e kibles mund të vërehet tabela ku

shkruhet: Kjo xhami është një vend me vlerë të madhe shpirtërore. (Përkth. nga Dankoff dhe Elsie 1999, f. 138)




Figura 2. Dorëshkrimi i Evlija Çelebiut, ku paraqitet teksti i mbishkrimit i cili bën fjalë për Vlorën

ابتدا يعقوب شيخ سالكين * التدي مسجد في سبيل الله اوين
ثانيا سلطان سليمان الزمان * قلدي جمعه ابارك الله اخوين
دي حسبي بو ماقماك تاريخن * نور حق بو (ل) جامع المقر بين
في ٩٤٩ ١٥٤٢/١٥٤٣

ibtida Yakub Seyh-üs Salikin
Etdi mescid fi sebilillah evin
Saniyen Sultan Süleyman-uz-
zeman

Kildi Cuma barekellahu aferin
Dedi hasbi bu makamm
tarihin

Nûr-i hak bu cami-ul-
mukarrabîn sene 949

I pari Jakubi, prijësi i të devotshmëve
E bëri shtëpinë e tij xhami (mesxhid)
për hir të Zotit

I dyti Sulltan Sulejmani, Solomoni i
epokës

E shndërroi atë në xhami xhemaati - i
lumtë!

Hasbi ka bartuar tabelën e këtij
tempulli:

Gjej dritën e së vërtetës: Xhamia e të
afërmve të Allahut

Viti 949 Hixhri [1542 E.S.]

Mbishkrimi (figura 2) është mjaft
i rëndësishëm për arsye se ai i referohet

Shejh Jakubit të Urdhrit Halveti, i cili ka predikuar në Shqipërinë e Jugut. Më vonë Sulltan Sulejmani e pat kthyer atë në xhami. Hasbi ka gdhendur një tabelë (një mbishkrim i cili daton në vitin 957), e cila ka 8 vjet diferencë me vitin që është shënuar numerikisht në mbishkrim. Një tjetër veçori e mbishkrimit është referenca për Sulltan Sulejmanin si “Solomoni i Epokës së tij.” Sulejmani e kishte shumë për zemër krahasimin me mbretin biblik Solomonin. Ekzistojnë edhe 2 mbishkrime në Jerusalem ku është përdorur kjo referencë (Tütüncü 2006 f. 34-35 dhe 38-39).

2.2 İlyas Paşa Çeşmesi (Çezma e Iljaz Pashës)

Një mbishkrim i dytë i përmendur nga Evlija Celebiu është mbishkrimi i një çeizme. Kjo çeizme ndodhet pranë teqesë së Jakub Efendiut dhe quhet Çezma e Iljaz Pashës. Ky mbishkrim së bashku me çeizmen janë shkatërruar kohë më parë.

Siç citohet të ketë shkruar Evlija Celebiu: “Ekzistojnë 4 kroje dhe 8 çeizma, më e njohura prej të cilave është Çezma e Iljaz Pashës pranë teqesë së Jakub Efendiut me mbishkrimin e mëposhtëm:




Figura 3. Dorëshkrimi i Evlija Çelebiut, në të cilin paraqitet teksti që i referohet çeizmës së Iljaz Pashës

**Buldum ilyas Paşanın
tarihini yevmü't-tenad**

**Çünkü dedim tarihini ve-
hüve hayrû'l-ibad/ Sene...**

*Në ditën e grumbullimit unë gjeta
datën e Iljaz Pashës*

*Prandaj unë paraqita mbishkrimin
e tij: "Dhe ai është më i miri prej
shërbëtorëve të Zotit.*

*Viti... (Përkth. nga Dankoff, Elsie
1999, f. 141)*

Rreshti i fundit përmban një
datë përfundimtare në abxhade e
cila llogaritet:

*ve-hüve hayrû'l-ibad 70 + 810
+108 = 935*

935 Hixhri përkon me
1529/1528 E.S.

Ky burim daton qysh nga
koha e Sulltan Sulejmanit. Nëse
data e bjed është e saktë, atëherë
ky është mbishkrimi më i vjetër në
Shqipërinë e Jugut.

2.3 Mbishkrimi në kështjellën e Kaninës

Në Kaninë, në një mal me
pamje nga Avlonya (Vlora), në
gjirin dhe rrethinat e saj, u ndërtua
një kështjellë. Kjo kështjellë sipas
Evlia Çelebiut, ka pasur një
mbishkrim në të (Fig. 4).

Evlia e përshkruan Kaninën si
më poshtë:

Kalaja e Kaninës ka tri porta,
njëra ndodhet përballë jug-lindjes
dhe lidh kështjellën me qytetin e

hapur nga ana tjetër. E dyta shikon
nga veriu dhe hapet në rrugën që
zbret në Vlorë. E treta ndodhet nga
jugu dhe hapet mbi vendbanimin e
vogël ekstramural (Varos). Pranë
kësaj porte ndodhet kështjella,
e cila ka një portë që shikon nga
lindja dhe komunikon me kalanë
kryesore. Kalaja përmban vetëm 20
shtëpi të ndërtuara në stilin e vjetër
me çati me tjegulla. Ajo gjithashtu
ka një depo magazinimi për grurë
dhe municione si dhe puse për
ujë. Mbi portën veriore ndodhet
një mbishkrim me shkronja sa e
gjithë faqja të vendosur mbi një
pallakë katrore prej mermeri të
bardhë, e cila tregon datën kur
Sulltan Sulejmani ka riparuar dhe
rindërtuar kështjellën. Rrugët në
këtë kala janë të gjitha me orientim
lart e poshtë. Nuk ka tregje, kroje,
banja turke dhe ndërtesa publike
brenda mureve, por qyteti është
hapur në jug të kalasë dhe përmban
300 shtëpi guri me çati me tjegulla,
si dhe kopshte e vreshta, të gjitha
të grumbulluar mbi njëra-tjetrën.
Këtu, gjithashtu nuk ekziston asnjë
gjurmë e ndonjë pazari. Ekziston
vetëm Xhamia e madhe e Sinan
Pashës me minaren e saj të lartë dhe
elegante. Këtu ndodhet gjithashtu
edhe një teqe e Haxhi Bektash
Veliut, e cila është zbukuruar po
ashtu nga Sinan Pasha...

Në afërsi të teqesë, ndodhet i
varrosur themeluesi dhe bamirësi
i kompleksit, Gazi Sinan Pasha, së

bashku me të gjithë familjen dhe provizionet e tij në një mauzoleum me një kupolë të hijshme - Allahu pastë mëshirë për shpirtrat e tyre. Me pak fjalë, kjo është një e teqe pasur dhe e famshme, përtej aftësive të mia për ta përshkruar. (Përkth. nga Dankoff, Elsie 1999, f. 131-132) (Fig. 5)



Figura 4. Kështjella e Kaninës



Figura 5. Guri i varrit të Sinan Pashës

Mbishkrimi që ka të bëjë me themelimin e kalasë së Kaninës nga Sulltan Sulejmani është zhdukur tashmë. Një gur varri në buzë të kalasë i referohet vendvarrimit të Sinan Pashës. Guri i varrit ka një kokë të mbështjellë me një shpatë me dy tehtë. Ky model shpate

është i ashtuquajtur “Zulfikari i kalifit Ali”, dhe me sa duket është bërë me qëllim për të evidentuar lidhjen e Sinan Pashës me urdhrin bektashi, siç thuhet nga Evlija. Kjo përbën një referencë të hershme për themelimin e urdhrit Bektashi në Shqipëri.



Figura 6. Pamje e përgjithshme e Gjirokastrës nga kalaja



Figura 7. Kalaja e Gjirokastrës

3. Gjirokastra

Nuk e teprojmë po të themi se Gjirokastra është qendra më e rëndësishme urbane e Shqipërisë jugore dhe në të njëjtën kohë qyteti më i bukur në të gjithë vendin dhe më piktoresku i Ballkanit. Qyteti shtrihet në disa kodra.

Vendbanimi i përhapur në një sipërfaqe të gjerë është i dominuar nga një kështjellë. Gjirokastra ka shtëpitë dhe pallatet më të bukura dhe më origjinale të banimit të shekujve 18 dhe 19. Ajo ka shpëtuar nga shkatërrimi i komunistëve, sepse ishte vendlindja e Enver Hoxhës. Gjirokastra është qytet në të cilën ndodhen disa xhami, dy teqe Halveti, një medrese, çezma origjinale otomane dhe teqe bektashiane, një Xhami e pazarit si dhe një xhami e teqesë. Në Gjirokastër ndodhen disa mbishkrime, të cilat nuk janë botuar. Gjatë ekspeditës tonë ne kemi marrë fotografi nga këto mbishkrime.

3.1 Xhamia e Sulltan Bajazitit në Gjirokastër

Evlija Çelebiu thekson se ka ekzistuar një grafit i shkruar në një nga shtyllat brenda Xhamisë së Sulltan Bajazitit (Fig. 6-7).

Në të ndodhen gjithsej tetë minberë lutjesh. Sipër në kala ndodhet Xhamia e Sulltan Bajazitit II. Në njërën prej kolonave gjendet mbishkrimi i poshtëm me shkrimin karakteristik të asaj kohe:

Bu çebirden Kandiye gazasrnda yediyüz aded hanedan sahibleri şehid haneleri mesdud kalmiçdir. Ve yedi bin added hüddaman bu çebirden Kandiye'de şehid-I şehadet camin nuş etmişlerdir.

Deyü tahrir etmişlerdir

«Shtatëqind kryefamiljarë nga ky qytet ranë në betejën e Candia si martirë të besimit. Shtëpitë e tyre janë të mbyllura. Dhe shtatë mijë shërbëtorët nga ky qytet kanë pirë kupën e martirizimit në Candia».

Në të vërtetë, shumë shtëpi janë mbyllur dhe shërbëtorët e tyre janë martuar me gra të ish zotërinjve të tyre.




Figura 8. Dorëshkrimi i Evlija Çelebi, ku paraqitet tekstin i shkruar në Xhaminë e Bajazitit në kalanë e Gjirokastrës

3.2 Xhamia e Teqesë (1145)

Sipas Frashërit dhe Dashit, ka pasur një mbishkrim, në të cilin thuhej se ajo është ndërtuar në vitin 1733/1732) 1145 E.S.). Kjo xhami duhet të jetë ajo që është përshkruar nga Evlija Çelebiu, si Xhamia e Teqesë. Nga banorët e zonës ajo njihej edhe si Xhamia e Meshit. Sipas Machiel Kiel (1990, f. 142), ajo ishte ende në këmbë në vitin 1967, por duhet të jetë shkatërruar pak kohë më pas. Ne nuk kemi asnjë ide se çfarë ishte shkruar në këtë mbishkrim përveç fakteve të rrëfyera nga Frashëri dhe Dashi.

3.3 Xhamia e Pazarit

E vetmja Xhami e paprekur e cila u ka mbijetuar shkatërrimeve është Xhamia e Pazarit (Fig. 9). Ka një mbishkrim të lartë mbi hyrjen e mbetur të sinjalizuar nga Machiel Kiel (1990, f. 142). Ashtu siç ka sinjalizuar edhe më parë Kiel, vetëm 4 rreshta të vegjël të mbishkrimit janë paksa të lexueshme. I pari përmban prezantimin si «Zotëruesi i Punëve të mira» dhe rreshti i dytë e i tretë përmbajnë emrin e kujdestarit i cili është i paqartë për shkak të papastërtive. Rreshti i fundit përmban datën e lexueshme 1177.

Sahib ul hayrat vel basenat
1177Hixbri = 1763/1764

3.4 Mbishkrimi në Xhaminë e Haxhi Muratit

Në Gjirokastrë ndodhet një Xhami me minaren gjysmë të shkatërruar. Ajo duhet të jetë Xhamia e cila është përshkruar nga Evlija Çelebi si më poshtë:

Në këmbët e hamamit ndodhet Xhamia e Haxhi Muratit. Në të shkohet nëpërmjet një palë shkallëve prej guri. Ajo është një ndërtesë e lartë prej guri me minare të ndërtuar me mjeshtëri dhe me një çezmë uji me shije të mrekullueshme. Brenda në xhami tavani është zbukuruar me dekorime të imëta.

Përshkrimi sipas Evlija Çelebiut (cit. Dankoff, Elsie 1999 f. 76-77) ende mund të vërehet qartë. Ajo është me formë katrore në bazë dhe minarja e saj është gjysmë e rrënuar. Ajo aktualisht përdoret si shtëpi banimi. Poshtë Xhamisë ndodhet një pus i cili ende ka ujë të mrekullueshëm. Në këmbët e minares ndodhet edhe një tjetër çezmë. Ka një palë shkallë që të çojnë deri në hyrje të Xhamisë, e cila, me siguri, ka më shumë se 6 shtresa prej guri. Oborri i Xhamisë është ende plot me pemë dhe rrethinat janë populluar me ndërtesa të vjetra. Çezma e ndërtuar mbi pus tregon një mbishkrim sipas të cilit kjo xhami emërtohet si «Xhamia e Haxhi Muratit».

Mbishkrimi paraqet emrin e kujdestarit të saj Haxhi Muratit (Fig. 11). Por kjo xhami u rindërtua më vonë nga dikush tjetër, i quajtur Muin Arslan. Ky mbishkrim është pa datë. Prandaj, ne nuk kemi asnjë informacion se kur është ndërmarrë ky aktivitet i rindërtimit.



Figura 9. Mbishkrimi i Xhamisë së Pazarit, Gjirokastrë



Figura 10. Xhamia e Haxhi Muratit, Gjirokastrë

1 *Havz ile yapılmışdır ki fâide-yi ziyâde ola*

2 *Esâsından yapıdıran ki duâda artık ola*

3 *Câmi' ile berâber müessisi Hacı Murad*

4 *Havzı yabdıran (cami) berâber cennetle şâd*

5 *Cümle ehl-i î mân ve havz ile yabdırana*

6 *Muîn Arslan nâib yeğen sâhib İbn Güfte*

7 *Bu gün bana yarın sana işte gitti enbiyâ*

8 *Lutf ile ihlâs ile cümleye münâsib duâ*

Kjo është ndërtuar me një pishinë që të ketë dobi të madhe

Ai që e ka ndërtuar duhet të marrë shumë lëvdata,

Ndërtimi u krye nën urdhrat e Haxhi Muratit

Ai që ndërtoi pishinën së bashku me xhaminë duhet të jetë i lumtur në Xhennet,

Të gjithë besimtarët dhe ai që ndërtoi pishinën

Është Muîn Arslan, guvernatori Yegen Sahib Kufte

Një ditë për mua një ditë tjetër për ty, kështu ata kanë ikur të gjithë

Ju lutemi, me respekt bëni një dua për shpirtin e tyre.

حوضيله بالمشدر كه فائده زياده اوله
اساسندن ياديران كه دعاده ارتوق اوله
جامع ايله برابر مؤسسسى حاجى مراد
هوضى ياديران جامع بارابر جنتله
جمله اهل ايمان وحوضيله ياديرانه
معين ارسلان نائب يكن صاحب ابن گفته
بو كون بكا يارين سكا ايسته كيتدى انبيا
لطف ايله اخلاصيله جملهيه مناصب دعا

Rreshti i fundit përmban një datë në abxhad dhe kur llogarisim shkronjat sipas vlerës së tyre përkatëse numerike, rezulton që viti i saktë i mbishkrimit është viti 1284 Hixhri.

لطف ايله اخلاصيله جملهيه مناصب دعا

$$75+184+93 + 77+767+46+119 = 1284$$

Viti 1284 Hixhri është viti 1867/68 E.S.



Figura 11. Mbishkrimi në Xhaminë e Haxhi Muratit Gjirokastër



Figura 12. Xhamia e Dunavatit, Gjirokastër (1384/1887)



Figura 13. Mbishkrimi në Xhaminë e Dunavatit, Gjirokastër

3.5 Xhamia e Dunavatit

Kjo Xhamia tani përdoret si depo. Emri i saj përkon me emrin e lagjes ku ndodhet Xhamia e Dunavatit.

Në të ekziston një mbishkrim që daton në vitin 1304.

1. *Makâm-ı mescidgâhı ravza-i pür feyz-i mevlânâ*

2. *Harâb olmuş idi bâd u nâ-vât câmi-i ulyâ*

3. *Zamâniyle bu hayrı bânî-i mükerremîn hayr eylemiş bünyâd*

4. *Ve lakîn pek harâba yüz tutup kalmış tek tenhâ*

5. *Ki sâhib-i hayr bânisi demektir Karagöz-şâde*

6. *Edîb bin Ömer sarf etti nakd-i himmeti ihyâ*

7. *İlahi kudretinle isti'ân et yerm-i mahşerde*

8. *Meded sen afv-ı gufrân-ı hüdasın evvel ve âhir*

9. *Salâ ve nesrin okunsun şarkı her dem tarîh-i*

tâmmın

10. *Temelden kıldı bu Edîb Efendi câmi-i inşâ*

11. *Min gurreti's-şehri şilbicce senetin 12 Erbaa ve selâse*

Ky vend i adhurimit dhe një kopsht i të mësuarit dhe shkencës për Zotin tonë

Kjo xhami elegante e Dunavatit ka qenë e rrënuar

Në kohët e vjetra një person i veprave bamirëse e pat ndërtuar atë

Por më vonë ajo mbeti e vetmuar dhe në gjendje të shkatërruar

Themeluesi i saj quhej Karagozzade

Edib Bin Omer ka shpenzuar para për rindërtimin

O Zoti im, të lutem na ndihmo në Ditën e Gjykimit

Ndihmona se Ti je Ai që na fal neve O Zot, përpara dhe më pas

Sala dhe Nesrin do të lexohen në çdo kohë në datën e saj

Edip Efendie e ka ndërtuar nga themelet këtë xhami

Në fillim të muajit të Dhulhixhes në vitin 1304.

مقام مسجدکه ی روضه • رفیض مولانا
خراب اولمش ایدی بودناوات جامع علیا
زمانیله بو خیری بانیء مکرمین خیر ایلیمیش بنیاد
ولکین • ک خاربه یوز طوتوب قالمش تک تنها
که صاحب خیر بانسی دیمکدر قاره کوززاده
ادیب بن عمر صرف ابتدی نقد همتی احیا
الهی قدرتکله استعن ایت یوم محشرده
مدد سن عفو غفران خداسک اول و اخر
صلا و نسرین اوقونسون شرفی بر دم تاریخی تامک
تملن قلدی بو ادیب افندی جامع انشا

من غرة الشهرى زیلحه سنة
اربع و ثلاثماية و الف سنة

Rreshti i dytë i distikut të pestë përmban një datë të shkruar në ebxhed. Shkronjat e ekuivalentuara në numra japin datën 1304 e cila është e shkruar e plotë edhe në distikun e fundit:

تملن قلدی بو ادیب افندی جامع انشا

$352+114+145+17+8+144+524=1304$

Ditët e para të Dhulhixhes në arabisht korrespondojnë me datat 23-21 gusht 1887.

3.6 Varri i Shejh Hasanit dhe Huseinit Halveti (1181/1767)

Në Gjirokastër ndodhet një Teqe Halveti (Fig. 14). Në kopshtin e kësaj teqeje gjenden 2 tyrbe me mbishkrime. Njëra nga tyrbet ka një mbishkrim shumë të dëmtuar (Fig. 15). Ai jep datën e vdekjes së Shejh Hysejnit (1181) dhe rindërtimin e teqesë nga Muhtar pasha në vitin 1221, rreth 40 vjet më vonë. Muhtar Pasha ishte njëri nga djemtë e Ali Pashë Tepelenës.

Tarih merhum ve Magfur lebu halife??

Seyh buseyin Halife Salfi...

Vefat tarih sene 1181 = 1767/1768

... (Tamir) Muhtar pasha 1221 = 1806/1807

تاریخ مرهوم و مغفور له خلفه
شیخ حسین خالفة سلفی سنة
وفت تاریخ ۱۱۸۱ ۱۷۶۷/۱۷۶۸
.....

تعمیر مختار باشا سنة ۱۲۲۱ ۱۸۰۶/۱۸۰۷

Data e halifes së ndjerë dhe

Shejh Husejn Halife Salfi

Data e vdekjes 1181

Data e rindërtimit 1221 nga Muhtar Pasha



Figura 14. Teqeja e Shejh Hasan Halvetiut



Figura 15. Mbishkrimi në tyrben e Shejh Hysejn Halvetiut



Figura 16. Mbishkrimi i Shejh Sulejmanit
Figura 17. Çezma e Avlumanlatit

3.7 Teqeja e Shejh Sulejman Halvetiut, Rexhep 1268- Maj 1852

Një tjetër teqe Halveti ndodhet gjithashtu edhe në Gjirokastrë. Një mbishkrim është vendosur në hyrje të njëres prej ndërtesave (Fig. 16).

1. *Bu makamı İnşa edüb*
- 2.
3. *mekan olub inmege*
4. *makbul olsun*

5. *çiler He*
6. *hayr neva ali olub*
7. *sene 1268 mah receb Seyh Suleyman*

Halveti Tekke

تملن قلدی بو ادیب افندی جامع انشا
بو مقام انشا ایدوب
مکان اولب انمکه
ماقبول اولسون
او • لر ايله

حیر نوا علی اولوب
سنة ۱۲۶۸ ماه رجب

Kjo bekuar vendosur është ndërtuar nga ...

Ky është një vend i shenjtë e qoftë e pranuar

si një vepër e bujarisë

Në vitin 1268 në muajin Rexhep.

3.8 Çezma e Avlumanlatit (1273/1858)

Ky mbishkrim është gjetur në Teqenë e Zellishit. Ai është një mbishkrim me një nuancë lokale. Avli manalat është emri i një lagjeje të Gjirokastrës dhe mbiemri Buzgu është me origjinë shqiptare (Fig. 17).

*Sabibul Hayrat Avli Manalaat mahalli
Bende-i Ali Aba Salih Aga
Buzgu Hak Teâlâ hayrat
ve basenâtlerin kabul eyleye...
Amin sene 1273*

Zotëruesi i veprave të mira shërbëtor i familjes së Profetit të

Shenjtë në lagjen e Avli Manalat Salih Aga Buzgu. Zoti i pranofte veprat dhe lëmoshën e tij. Amin viti 1273.

tjetër që të mund të identifikojë personin e varrosur, ne e kemi hequr fare përkthimin.

3.9 Guri i fragmentuar i varrit

Emri i personit të vdekur nuk është ruajtur (figura 18).

Ab Mine-l-mevt

*Bu Cihan bagrna geldim bir mürrüvvet
gormedim Derdime derman aradim bir
ilacrn bulamadim Ab ila zâd kilarak
taẓeligime doymadim Çün eceli peymanesi
dolmuş murad almadim.*

*Hasretâ fâni cihanda tûl-i ômiür
sürmedim Firkatâ takdîr bu imiş tâ
eẓelden bilmedim*

Kjo është një pjesë e një gur varri me një poezi osmane shumë të lashtë dhe e famshme e karakterit ankues në lidhje me vdekjen dhe largimin nga kjo botë. Meqenëse nuk ka as emër e as ndonjë të dhënë



Figura 18. Guri i fragmentizuar i varrit

Bibliografia

Dankoff, Robert; Elsie Robert (eds.) (1999). *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*. The relevant sections of the *Seyahatnama* botuar me përkthim dhe hyrje, vëll. 4. Leiden; Boston; Koln: Brill Academic Pub.

Frashëri, Gjergj; Dashi, Sulejman (1987). «Zhvillimi i arkitekturës islamike shqiptare të xhamive (Probleme të periudhizimit)». *Monumentet*, 2, f. 51-76.

Macchiarella, Gianclaudio (2012a). «Delvina, Albania: A Sufi Architectural Enclave». Në: Cret Ciure, Fiorina; Nosilia, Viviana; Pavan, Adriano (bot.), *Multa & Varia: Studi offerti a Maria Marcella Ferraccioli e Gianfranco Girardo*. Milano: Biblion, f. 9-32.

Macchiarella, Gianclaudio (2012b). «Delvina: a Mystic Architectural Enclave». *Türk Donemi Kazıları ve Sanat Tarihi Araştırmaları Sempozyumu* (Eskişehir, Turkey, 19-21 October 2011).

Macchiarella, Gianclaudio; Tütüncü, Mehmet (2012). «Delvina Kitabeleri». *Gjatë punimeve të konferencës* (Eskişehir, Turkey, 19-21 October 2011), pp. 549-558.

Kiel, Machiel (1990). *Ottoman architecture in Albania (1385-1912)*. Istanbul: Research Centre for Islamic History, Art and Culture.

Kiel, Machiel (2013). «Tepelene, Türkiye Diyanet Vakfı». *İslam Ansiklopedisi*, vëll. 40, f. 475-479.

Tütüncü, Mehmet (2006). *Turkish Jerusalem (1516-1917), Ottoman Inscriptions from Jerusalem and Other Palestinian Cities*. Haarlem.

Aksut, Ali Kemali (1944). *Sultan Aziz'in Misir ve Avrupa seyahati*. Istanbul: Ahmet Sait Oğlu Kitabevi.

İslam Ansiklopedisi (2011), 40. Cilt, Tanzimat-Teveccüh. Ankara.

“Drita Islame”, si mjet i përgjegjshëm komunikimi masiv në trendin e zhvillimeve aktuale

**Doc. Dr. Ramadan Çipuri,
Universiteti Bedër**

Abstrakt

“Drita Islame” nuk ka qenë thjesht një gazetë apo një revistë që botohej nga KMSH në formën klasike që ne jemi mësuar t’i njohim organet e shtypit fetar. Ajo ka qenë një dritare komunikimi midis institucionit më të lartë mysliman në vend me publikun në tërësi.

E veçanta këtu qëndron në atë se “Drita Islame” ka arritur që t’i flasë jo vetëm publikut tradicional, që ne jemi mësuar të njohim, por të ashtuquajturve në shkencat e komunikimit si “publikë”, pra lloje të ndryshme publikësh brenda dhe jashtë vendit tonë.

Mesazhi i përcjellë nga “Drita Islame” është jo vetëm ai fetar, por trajton një sërë çështjesh problemore që kanë të bëjnë me edukimin, ekonominë, normat e sjelljes komunitare, çështje me karakter social e politik, etj.

1. Hyrje

Humbja e kufijve hapësinorë dhe kohorë, sidomos në një kohë kur e gjithë bota ndodhet nën ndikimin e stereotipave të shumtë, që mund të rrezikojnë ekuilibrat e

brishtë që kanë ekzistuar dikur, por që sot shfaqen të ekspozuar ndaj mundësisë për të dështuar, duket se i kanë dhënë një tjetër dimension medias tradicionale. Sidomos, me zhvillimin e mediave të reja, kjo ka përparuar akoma më shumë, duke ofruar platforma komunikimi akoma

më të mëdha, zhvillim ky që studiues të ndryshëm e vlerësojnë si fuqi prej pushteti “të pestë”, që media zotëron në ditët e sotme. Përgjegjësia e këtyre mjeteve të komunikimit masiv fiton gjithnjë e më shumë rëndësi në kushte të tilla ku, përmes një dritareje të vetme në internet, mediumi arrin të mbërrijë te çdo qytetar global, te të cilët mund të ndikojë në edukimin dhe në opinion e tyre, në qasjet që ata mund të kenë ndaj situatave, konflikteve dhe zhvillimeve të kohës.

Rëndësia është akoma më e madhe kur flitet për çështje të ndryshme, që vënë përballë njëritjetrit komunitete, kultura, ideologji dhe hapësira të mëdha gjeografike, të cilat formësohen nga besimi fetar, element ky që lidhet drejtpërsëdrejti me “gjuhën e zemrës” dhe që mund të reflektojë dhe ndikojë më shumë se gjithçka tjetër në komunikimin dhe reagimin qytetar. Në këtu punim do të analizohet rasti i gazetës, së fundmi prej disa vitesh revistës “Drita Islame”, si një mjet i rëndësishëm shtypi i Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH), mënyra se si ajo ka pasqyruar aktualitetin lokal dhe global nën misionin e një mediumi fetar të përgjegjshëm, si edhe përshtatja e saj me zhvillimet bashkëkohore të sektorit të medias.

Qasja e analizës është kryesisht cilësore, e mbështetur në një vështrim të detajuar të përmbajtjes së publikuar nga viti 1992 e deri më sot.

2. Tipare të rrugëtimit 25 vjeçar të gazetës-revistës “Drita Islame”

2.1. “Drita Islame” si zë publik i KMSH-së

Ka qenë traditë e kahershme që institucionet përfaqësuese të komuniteteve fetare të kenë mjetet e tyre të komunikimit masiv, kryesisht ato të shkruara në formën e gazetës, revistës, buletineve, etj., si dhe së fundmi të radiove, faqeve të internetit, etj. “Drita Islame” ishte i pari organ shtypi zyrtar i KMSH-së pas rënies së regjimit totalitar, i cili, duke nisur nga janari i vitit 1992, doli në mënyrë periodike çdo dy javë. Përmbajtja e gazetës karakterizohet jo vetëm nga botimi i mesazhit islam për një popull të etur për besim, por përmes analizave, sugjerimeve dhe kritikave të ndryshme ka funksionuar edhe si një zë publik dhe elitar i parisë myslimane me besimtarët, shtresat e shoqërisë dhe institucionet publike e private, të gjitha këto në lidhje me çështje të nxehta që preknin realitetin shqiptar. Që në numrin e parë, gazeta shpalosi misionin e saj shoqëror e kombëtar, ku “synonte zgjimin e ndërgjegjes fetare në besimtarët e saj në bazë të mësimave morale të Kur’anit, duke e zhveshur nga të gjitha mbresat e dëmshme të lëna nga ateizmi për afro gjysmë shekulli”¹.

Siç ka vijuar edhe më vonë,

1. Redaksionale. 1992. «Drita Islame.» Drita

me raste të ngjashme, në numrin e dytë të saj, “Drita Islame” solli në vëmendje të opinionit publik dhe institucioneve shtetërore rëndësinë e pronave që KMSH kishte gëzuar dikur. Kështu përmes titullit “Një e drejtë që duhet rikthyer”, “Drita Islame” që në fillim mbajti qëndrim ndaj pronave të KMSH-së, ku në krye të një liste të detajuar të pronave të dikurshme, do të shkruante se “në mjaft rrethe të vendit tonë, Komuniteti Mysliman ka patur para çlirimit prona vakëfnore, të cilat përbëheshin nga dyqane, shtëpi banimi, hotele, hane, troje, ullinj dhe toka bujqësore”².

Në një moment kur Shqipëria po përballlej me një nga krizat më të mëdha të periudhës paskomuniste, atë të firmave piramidale në vitin 1997, KMSH përmes “Drita Islame” sqaroi pozicionin e tij ndaj kësaj çështjeje, duke i ofruar çdo besimtari të vërtetën islame ndaj kamatës apo fajdesë. “Si fe humanitare që është, Islami e ndalon marrjen e interesit përkundërt një huaje të dhënë dhe e konsideron atë si një akt që shkon në kundërshtim me atributin e Zotit”³, thuhet në një editorial të posaçëm të publikuar në shkurt të -1997ës.

Përmes “Drita Islame”, KMSH ka bërë zyrtar edhe qëndrimin e tij

ndaj terrorizmit dhe akteve terroriste, që, duke nisur nga mesi i viteve ‘90, shumëkush i atashoi ato me Islamin. Kështu, disa tituj të botuar në mënyrë periodike gjatë këtyre viteve janë: “Islami nuk është sinonim i terrorizmit” (nëntor, 1995), “Islami është kundër dhunës dhe terrorit” (prill, 1997), “Zhurma e shtypit mbi terroristët islamikë” (shtator, 1998), poezia “Nuk jemi terroristë, o botë, po feniksë të këtij ar(b)dheu” (tetor 1998), duke vijuar më tej me artikuj të ngjashëm pas vitit 2000 me “Keqkuptimet ndaj Islamit dhe lufta kundër terrorizmit” (dhjetor, 2002), “Terrori nga këndvështrimi islam” (nëntor, 2003), etj. Situata është pothuajse e njëjtë edhe në vitet e fundit, ku në “Drita Islame” gjenden qëndrime të drejtuesve të KMSH në lidhje me çështjen në fjalë, por edhe problematika të tjera që shqetësojnë vendin tonë.

2.2. “Drita Islame” si një mjet i marrëdhënieve me publikun

“Drita Islame” nuk ka qenë thjesht një gazetë apo një revistë që botohej nga KMSH në formën klasike që ne jemi mësuar t’i njohim organet e shtypit fetar. Ajo ka qenë një dritare komunikimi midis institucionit më të lartë mysliman në vend me publikun në tërësi. I intervistuar në kuadër të këtij punimi, Alban Tartari, studiues i medias dhe komunikimit, e vlerëson “Drita

Islame, 10 janar: 1.

2. *Drita Islame*, 1992, «Një e drejtë që duhet rikthyer», 24 janar: 1.

3. *Drita Islame*, 1997, «Kamata apo fajdeja sipas Islamit», shkurt: 1.

Islame” si një mjet të rëndësishëm të marrëdhënieve publike të KMSH-së me komunitetin vendas e më gjerë, mysliman dhe jo vetëm, etj.

Në kushtet e reja të zhvillimeve në sektorin e medias dhe komunikimit, redaksia e “Drita Islame” ka ditur më së miri të përshtatet me këto risi. Në përmbajtjen e botuar në print, por edhe në faqen e saj online, gjen jo pak artikuj, analiza dhe mesazhe të ndryshme që synojnë lexues që i përkasin një grupi gjithnjë e më shumë heterogjen në tiparet karakterizuese. Njohja e mirë e publikëve dhe audiencave vlerësohet si një çelës suksesi në fushën e marrëdhënieve publike.

E veçanta këtu qëndron në atë se “Drita Islame” ka arritur që t’i flasë jo vetëm publikut tradicional, që ne jemi mësuar të njohim, por të ashtuquajturve në shkencat e komunikimit si “publikë”, pra lloje të ndryshme publikësh brenda dhe jashtë vendit tonë. Sipas Alban Tartarit, studiues dhe specialist i komunikimit, “në termin ‘publikë’, në këtë rast nuk hyjnë vetëm besimtarët myslimanë, por edhe njerëz që nuk janë pjesë e këtij komuniteti, njerëz që nuk besojnë, apo që janë besimtarë, por që nuk e praktikojnë besimin islam. Përmes natyrës së këtij lloj informacioni, “Drita Islame” ka synuar shoqërinë në përgjithësi, e veçanërisht publikët potencialë që mund të ndjekin

mesazhin e saj.”⁴

Mesazhi i përcjellë nga “Drita Islame” është jo vetëm ai fetar, por trajton një sërë çështjesh problemore që kanë të bëjnë me edukimin, ekonominë, normat e sjelljes komunitare, çështje me karakter social e politik, etj. Mjafton të shfletosh faqet e gazetës/revistës dhe që nga viti 1992 e deri më sot gjen tema nga më të larmishmet, të cilat synojnë lexues të profesioneve, etnive dhe besimeve të ndryshme.

2.3. “Drita Islame” si një manual mbi çështjet e besimit

Gazeta/revista “Drita Islame” i ka shërbyer besimtarëve myslimanë shqiptarë për të gjetur përgjigje në lidhje me çështjet e besimit. Ajo ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për gjëra nga më themeloret e deri në çështje të komplikuara të besimit.

Kjo gjë ka qenë mjaft e rëndësishme sidomos gjatë viteve 1990, ku shqiptarët vinin nga një e shkuar që u kishte fshirë çdo informacion dhe orientim mbi jetën fetare. Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve kanë ardhur në mënyrë periodike varësisht problematikave më të rëndësishme të kohës, si p.sh. “Jo besimeve të kota” (shkurt, 1992), “Familja - e vetmja vatër e lumturisë” (shkurt 1994), “Familja -

4. Tartari, Alban, intervista nga Ramadan Çipuri. (25 shkurt 2017).

bazë e një edukimi të shëndoshë për të rinjtë” (dhjetor, 1997), “Islami nuk është sinonim i terrorizmit” (nëntor, 1995), “Zhurma e shtypit mbi terroristët islamikë” (shtator 1998), “Fikhu – Sunneh - Legjislacioni i Traditës Profetike” (qershor, 2005), “Argumentet mbi namazin e teravive” (shtator, 2008), por edhe shumë çështje të tjera që kanë pasur të bëjnë me zhvillimet e nxehta globale që kanë nxitur konflikte të gjera.

2.4. “Drita Islame” si një bazë arkivore e mendimit islam në Shqipëri

Dalja e “Drita Islame” në një periudhë mjaft të rëndësishme për popullin shqiptar, analiza që u është bërë situatave të ndryshme, në momente të rëndësishme, përmes të cilave ka kaluar Shqipëria dhe këshillat fetare, që kanë ndihmuar besimtarët myslimanë shqiptarë, do të shërbejnë si një bazë e rëndësishme të dhënash arkivore për grupet e studiuesve në të ardhmen. Për 25 vjet me radhë, “Drita Islame” ka dokumentuar ngjarjet më të rëndësishme që kanë shoqëruar tranzicionin shqiptar të kësaj periudhe, u ka dhënë përgjigje pyetjeve dhe shqetësimeve të besimtarëve myslimanë rreth çështjeve të caktuara, ka qenë një zë zyrtar i KMSH-së ndaj zhvillimeve të rëndësishme etj., duke u kthyer kështu në një burim të rëndësishëm të dhënash për të ardhmen.

Në këtë aspekt, për t’u vlerësuar

mbetet puna e bërë nga Drejtoria e Kulturës së KMSH-së, e cila ka arritur të digjitalizojë të gjitha ato përmbajtje të shtypura, si edhe të mbledhin në mënyrë të detajuar çdo titull të sjellë përmes gazetës/revistës. Në vitin 2015, nën kujdesin e Kryetarit të KMSH-së, H. Skënder Bruçaj, Drejtoria në fjalë përmes një përmbledhjeje prej rreth 500 faqesh ka arritur të dokumentojë të gjithë bibliografinë e gazetës “Drita Islame” nga viti 1992 deri në vitin 2011⁵.

E gjitha kjo është një punë për t’u lavdëruar, e ngjashme me përmbledhjen e bërë në formën e një kolane gjithëpërfshirëse të gjithë numrave të revistës “Zani i Naltë” midis viteve 1923-1939, e cila sot është kthyer në një thesar të dhënash mbi qasjet e asaj kohe ndaj zhvillimeve socio-ekonomiko-politike në vend.

2.5. “Drita Islame” si një medium elitar

Në kushtet kur njerëzit po i largohen gjithnjë e më shumë librit dhe letrës, duke iu drejtuar burimeve alternative të informimit përmes rrjetit, gazeta dhe revista mbeten mjete komunikimi për vetëm një grup të caktuar më dashamirës ndaj informacionit. Duke kuptuar këtë trend dhe veçori të revistës, drejtuesit e KMSH-së dhe të “Drita Islame” e kthyen këtë të fundit nga

5. KMSH, “Bibliografia e gazetës Drita Islame, janar 1992 - dhjetor 2011”, Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2015.

një gazetë periodike në një revistë të rëndësishme që ndikon në ndërtimin e opinionit publik, duke iu drejtuar disa shtresave më elitare. Nga një vështrim i thjeshtë që mund t'i bësh çdo numri të revistës, vihet re një larmi e gjerë analizash mbi çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me besimin, artin, kulturën, ekonominë, kombin, etj. “Drita Islame” është kthyer në një udhëzues për shumë njerëz të mirë edukuar, të cilët gjejnë aty analiza të shkruara nga emra të njohur shqiptarë dhe jo vetëm.

2.6. “Drita Islame” ndjek hapin e kohës edhe në internet

Duke nisur nga nëntori i vitit 2011, “Drita Islame” nisi publikimin e saj edhe përmes internetit. Në këtë

mënyrë, ajo u bë pjesë e pozicionimit të medias si një pushtet i pestë në shoqëri, ku përmes kanaleve virtuale arriti të komunikojë me lexues përtej çdo kufiri kohor apo hapësinor.

Përmes një dizajni mjaft të kuruar, përmes adresës zyrtare të saj www.dritaislame.al, ajo përcjell te vizitorët jo vetëm informacion fetar mbi Kur'anin, Hadithin, çështjet shpirtërore, por edhe zhvillime nga vendi, bota, rajoni, myftinitë, tematika sociale mbi shoqërinë dhe familjen, risi e kuriozitete, etj.

Së fundmi, në vend të përfundimeve duhet theksuar se revista “Drita Islame” është një medium i rëndësishëm, i cili përmbush suazën e shtypit fetar në Shqipëri. Ajo i vjen në ndihmë të gjithë besimtarëve myslimanë shqiptarë, dhe jo vetëm.

Bibliografi

“Drita Islame” 7 janar 1992: 1.

“Drita Islame”, «Kamata apo fajdeja sipas Islamit», shkurt 1997: 1.

“Drita Islame”, «Një e drejtë që duhet rikthyer», 24 janar 1992: 1.

KMSH, “Bibliografia e gazetës Drita Islame, janar 1992 - dhjetor 2011”, Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2015.

Tartari, Alban, intervista nga Ramadan Çipuri. (25 shkurt 2017).

Gruaja dhe familja në institucione të rëndësishme të shoqërisë nën optikën e “Drita Islame”

**Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla,
Universiteti i Tiranës**

Abstrakt

Struktura e familjes nën këndvështrimin e “Drita Islame” dubet shikuar si nga aspekti i funksionit horizontal në dimensione mikro-sisteme dhe makro-sisteme. Çështja e familjes përgjithësisht në sociologji e sidomos në sociologjinë bashkëkohore dhe në etikën islame zë vend të rëndësishëm. Fenomeni i familjes në planin e mbrojtjes së moralit shqyrtohet ndër faktorët tejet fundamentale, dinamik të shoqërisë dhe të pasurimit human të raporteve ndërnjerëzore në qenien njerëzore.

Pra familja është një lloj i veçantë i strukturës përmes lidhjes së gjakut dhe marrëdhënieve të moralshme bashkëshpirtore, në kërkesa të ndërsjella të përcaktuara nga feja, të përforcuara nga ligji i sberiatit dhe të rindërtuara nga vetë individi.

Gruaja përbën një kontribut të një rëndësie të veçantë për rinovimin e shoqërisë. Nga ajo kërkohet që të njohë fenë, që të jetë prej atyre që pa i ndarë i kryejnë detyrat ndaj Allahut të Madhëruar, ndaj burrit, ndaj fëmijëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj atdheut. Emancipimi dhe përparimi i gruas, brenda normave islame, e bëjnë një shoqëri më të emancipuar, që kërkon afrimin e gruas në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe eliminimin e botëkuptimit të gabuar se gruaja është vetëm nënë, se funksioni i saj biologjik është vetëm të lindë fëmijë dhe se ajo dubet të jetë dhe të mbetet patjetër amvisë, e mbyllur dhe e lidhur vetëm me fëmijët. Gruaja bashkëkohore, e brumosur me ideologjinë islame, është gjithnjë e më shumë e emancipuar dhe me aftësi që i mundësojnë të jetë aktive në jetën ekonomike dhe politike.

Hyrje

Familja është një institucion hyjnor, ajo është institucioni më i lartë i një shoqërie që e ka hyjnizuar vetë Allahu.

Në shoqërinë islame gruaja dhe familja zënë një vend të rëndësishëm. Familja është një institucion origjina e të cilit përkon me krijimin e njeriut. Lloji njerëzor është rezultat i këtij institucioni.

Allahu në Kur'an thotë:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.”¹

Institucioni familjar luan një rol të rëndësishëm në shoqërinë islame; është njësia themelore e kësaj shoqërie dhe organizohet në mënyrë të tillë që mund të sillet si një shoqëri në miniaturë. Rreth një e treta e normave juridike, që përfshihen në Kur'an, i referohen familjes dhe përcaktojnë rregullat e mbarëvajtjes së saj. Bashkësia e të drejtave dhe e detyrave, që përbëjnë bazën e jetës familjare, siguron kushtet për të realizuar konstruktin e një individi dhe të një shoqërie në bazë të modeleve të treguara nga Allahu në Kur'an dhe të shëmbëllyera në jetën e Profetit Muhamed a.s.

Në një ekuilibër të tillë feja vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në të gjithë sistemin e raporteve familjare.

Familja islame është një **“familje e madhe”** në të cilën çdo pozicion përkon me një tip të veçantë marrëdhëniesh. Nuk është një familje e ashtuquajtur nukleare apo atomike, e përbërë nga prindër dhe fëmijë. Në gjirin e saj normalisht përfshihen tre ose katër breza. Familja në një kuptim më të gjerë të saj është në themel të ekzistencës dhe të riprodhimit. Çdo gjë, si qenia njerëzore ashtu edhe e gjithë bota organike zhvillohen dhe shumohen prej marrëdhënies që krijojnë dy qenie të ndryshme.

Pra familja është një nga mirësitë me të cilën duhet të ndjehesh i begatuar dhe i mirëkuptuar.

Duke e parë në këtë këndvështrim familjen ky studim do ndahet në dy drejtime.

Drejtimi i parë:

- Funksionet dhe qëllimet e familjes në optikën e “Drita Islame”.

Drejtimi i dytë:

- Statusi i gruas në familje, në edukimin religjioz të pjesëtareve të saj.

- Të drejtat e gruas në drejtim politik, social, financiar dhe ekonomik siç e përcakton Islami.

1. Kur'an En-Nisa: 1.

1. Funksionet dhe qëllimet e familjes në optikën e “Drita Islame”

Familja nuk është një “fabrikë” për prodhimin e njerëzve, megjithëse ruajtja e llojit është një nga qëllimet e saj kryesore. Ajo është bazë e gjithë strukturës social kulturore dhe është një mekanizëm më se i mjaftueshëm për të siguruar stabilitetin social, ideologjik e kulturor të shoqërisë dhe shëmbëllimin e saj në të ardhmen.

Familja, duke u mbështetur në bazë të mësimëve kuranore, ka një sërë funksionesh:

2. Ruajtja e llojit

Mbijetesa e llojit njerëzor dhe e kulturës së tij varet nga funksionimi i rregullt i mekanizmave të lindjes dhe riprodhimit. Për të realizuar këtë objektiv, lind nevoja e një institucioni që, i parë në optikën islame, duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm. E për të zgjidhur këtë problem të ruajtjes së llojit, Allahu ka krijuar strukturat dhe mekanizmat familjare, në të cilat procesi prokreativ zhvillohet që nga fillimi deri në ezaurimin e tij për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Familja në punën edukative duhet të niset nga qëllime kryesore që ta drejtojë atë në besimin te Zoti, që do ta udhëheqë atë në realizimin e të gjitha detyrave që i dalin përpara nga mosha më e vogël, në rini e në pleqëri.

Edukata e mirë paraqet bukurinë e njeriut, prandaj edhe Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Jam dërguar për të përsosur moralin e lartë”.

Njeriu është përgjegjës për familjen e tij dhe ai do të përgjigjet për të, prandaj edukimi i fëmijëve nën optikën e “Drita Islame” është detyrë e tyre, që të rritin fëmijë të shëndetshëm e me edukatë të lartë fetare.

3. Mbrojtja e moralit

Struktura e familjes nën këndvështrimin e “Drita Islame” duhet shikuar nga aspekti i funksionit horizontal në dimensione mikro-sistemo dhe makro-sistemo. Çështja e familjes përgjithësisht në sociologji e sidomos në sociologjinë bashkëkohore dhe në etikën islame zë vend të rëndësishëm. Fenomeni i familjes në planin e mbrojtjes së moralit shqyrtohet ndër faktorët tejet fundamentale, dinamik të shoqërisë dhe të pasurimit human të raporteve ndërnjerëzore në qenien njerëzore.

Pra familja është një lloj i veçantë i strukturës përmes lidhjes së gjakut dhe marrëdhënieve të moralshme bashkëshortore, në kërkesa të ndërsjella të përcaktuara nga feja, të përforcuara nga ligji i shariatit dhe të rindërtuara nga vetë individi.

Allahu në Kur’an thotë se martesë është si një “fortesë që e mbron njeriun nga një jetë e çrregullt”.

4. Ekuilibrimi psiko-emotiv: mirësjellja

Një tjetër qëllim i familjes është që të sigurojë një ekuilibër psiko-emotiv për një mbështetje shpirtërore.

Raporti midis pjesëtareve të familjes dhe në mënyrë të veçantë midis burrit dhe gruas nuk është një raport thjesht utilitar. Ky raport ka karakter shpirtëror dhe prej tij burojnë dashuri, mirëkuptim, mbështetje, besim reciprok, shpirt sakrificë, përkrahje dhe ndihmë. Vetëm në kontekstin familjar, këto të fundit janë potencialitete shpirtërore të mashkullit dhe të femrës dhe kur kthehen në realitet bëjnë të lulëzojë brenda familjes bollëku dhe virtyti.

Në marrëdhëniet bashkëshortore, secili nga bashkëshortët përpiqet të përmirësohet gjithnjë e më tepër. Kjo marrëdhënie e mirë midis tyre ngulit në personalitetin e fëmijëve ndjenjën e solidaritetit, dashurisë, tolerancës e të mirësjelljes. Në familje realizohet mjedisi më i përshtatshëm për formimin dhe zhvillimin e personalitetit njerëzor. Për këtë arsye Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) thotë se **“vendi më i bukur në botë është shtëpia”**.

Me të drejtë lind pyetja: Si paraqitet sot familja?

Sfidat me të cilat ballafaqohet familja myslimane sot janë të shumta e për ta mbrojtur atë nga idetë e

huaja degjeneruese, të cilat kanosin identitetin kulturor e fetar të saj, duhet që ajo të mbështetet fort në dispozitat e legjislacionit tolerant islam. Sot, Përfundimi udhëhiqet nga ide që kanë të bëjnë me shpërbërjen e familjes. Këto modele kemi filluar t'i imitojmë edhe në vendin tonë, duke e dëmtuar imazhin e familjes sot. Gjithnjë e më tepër sot po degjenerohet familja, në të cilën prindërit po dhunohen, braktisen dhe me sjellje jo të moralshme të fëmijëve ndaj tyre. Familja në përfundim po mundohet të përhapë projektin e imoralitetit midis popujve. Për të mbrojtur gjithnjë e më tepër familjen duhet të kthehemi nga Islami. Njerëzimi nuk ka njohur sistem familjar më të lumtur sesa ai islam. Kështu, ligjet dhe normat e posaçme për familjen janë tejet të sakta dhe të rregulluara mirë nëpërmjet parimit të ekuilibrit të vërtetë të jetës. Një pjesë e mirë e këtyre ligjeve janë shpallur në Kur'an. Për ndërtimin e një familje të tillë kemi nevojë të gjithë sot.

5. Edukimi shoqëror

Faktori prokreativ mbetet i paplotësuar nëse ai nuk ndiqet nga rritja e fëmijëve, edukimi, orientimi, formimi i personalitetit dhe nga fillimi i mësimin gradual të fesë e të kulturës. E për të përballuar këto detyra të vështira që ka familja duhet një angazhim total. Roli i familjes

është themelor në formimin e një individi të fortë fizikisht, psikikisht dhe shpirtërisht të shëndoshë për shoqërinë.

Profeti a.s. thotë: **“Nga gjithë ajo që një baba mund t’i japë të birit të tij më e vlefshmja është një edukatë e mirë dhe përgatitja për jetën”**.

Familja duhet të merret shumë me edukimin e fëmijës. Më shumë familja duhet të merret me kujdesin për fëmijën sesa për biznesin, siç ndodh shpesh sot në vendin tonë. Prandaj edukimi i pjesëtarëve të një familjeje me normat dhe rregullat islame, do të krijojë dhe sigurojë një familje të shëndoshë për jetën, shoqërinë etj.

6. Sigurinë shoqërore dhe ekonomike

Institucioni familjar është pjesë shumë e rëndësishme e sistemit islam të sigurimit shoqëror. Të drejtat nuk i referohen vetëm aspekteve morale kulturore e ideologjike, por i përkasin edhe kushteve ekonomike dhe shoqërore të pjesëtarëve të familjes.

Profeti a.s. ka thënë: **“Kur Zoti ta japë mirëqenien ekonomike, shpenzo fillimisht për veten dhe për familjen tënde”**.

Sistemi i sigurimit shoqëror islam bazohet në një bazë të shëndoshë psiko-sociale në familje. Në fakt, brenda familjes islame nuk zgjidhen vetëm problemet ekonomike, por

tregohet kujdes edhe për ekzigjencat psikologjike.

Pra, nga kjo kuptohet se familja është një mjet përmes të cilit riprodhohet edhe ruhet në kohë. Ajo është një mjet për ruajtjen e moralit individual e shoqëror. Ajo krijon një kontekst të përshtatshëm për realizimin shpirtëror dhe emotiv të të martuarve e të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes dhe nxit dashurinë, mirëkuptimin dhe paqen në shoqëri. Pikërisht në familje fillon edukimi i brezit të ri me kulturën respektin për traditën dhe kështu fillon formimi i ndjenjave të tyre shoqërore. Ajo është pika bazë e një sistemi të sigurt shoqëror. Ajo formon njeriun dhe forcon tek ai motivacionet dhe nxitjen për përpjekje dhe për progres shoqëror. Ajo është djepi i qytetërimit dhe urë përmes së cilës brezat hyjnë në shoqëri. Ajo është lidhje që bashkon të shkuarën me të tashmen dhe të tashmen me të ardhmen, duke siguruar një transformim të rregullt të shoqërisë përmes një procesi të shëndoshë dhe të qëndrueshëm. Ky rol i institucionit të familjes në Islam është mjaft i qartë.

Nëse institucioni i familjes dobësohet, ose shkatërrohet, e gjithë e ardhmja e njerëzimit do të jetë në rrezik të madh.

Rolin kryesor për një familje të shëndoshë e luan grua.

7. Cili është statusi i gruas në familje?

Gruaja është shtylla bazë e familjes dhe nën optikën e “Drita Islame” ajo është një entitet i pavarur dhe sipas kësaj një qenie plotësisht njerëzore. Islami i drejtohet asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk i qaset me ndërmjetësues të tjerë. Revolucioni në Islam qe shpëtim për gruan. Paralelisht me këtë Profeti Muhamed a.s. iu njohu grave të drejta të mëdha. Sheriati islam është kujdesur që të respektojë gruan dhe burrin, sepse secili prej tyre ka një rol të caktuar në këtë jetë.

Gruaja ka një status të lartë në familje. Ajo jo vetëm është e barabartë me burrin, por ka edhe të drejtat e saj. Allahu në Kur’an i ka nderuar gratë duke u ripohuar dinjitetin, statusin njerëzor dhe partneritetin e tyre me burrat. Për këtë H. Muhamedi a.s. ka thënë: “Gratë janë partnere të burrave”.

Gruaja ka rol të rëndësishëm si në familje edhe në shoqëri.

Në familje roli kryesor i saj është edukimi. Arsimimi i gruas është jetik për shoqërinë, pasi ajo është që prodhon burrat dhe gratë e së ardhmes. Gruaja myslimane është ajo që arsimohet dhe edukohet. Nëse ke edukuar një mashkull edukon një person, nëse ke edukuar një femër edukon një familje. Ajo është shtylla kryesore e edukimit të fëmijëve. Një grua e shkolluar dhe e edukuar, do të edukojë shumë më mirë krahasuar

me një grua të pashkolluar. Për më tepër, Profeti a.s. i ka nxitur gratë që të marrin pjesë në rrethet e diturisë, që të ndiqnin mësimet e tij dhe të mësonin prej tij bazat e humanizmit dhe të dukatës morale. Është ajo që prodhon anëtarë të mirë ose të këqij të shoqërisë. Kjo gjë pasqyrohet edhe në vargjet e mëposhtme:

“I them atij që vajzat tona mëson

Injoranca e tyre është shkak i humbjes sonë

Shkollë e fëmijëve të saj është nëna

Një nënë e përgatitur, një popull i ndritur

Nëna është një kopsht i mbjellë

Nëse e ujit, fryte do të sjellë

Nuk them që gratë të zhveshura të jenë

Me burrat të përzihen e cipë të mos kenë

Edukoni vajzat me moral të lartë

Kjo është më e drejta për çdo situatë.

Krejt ndryshe nga sa mund të mendohet, kujdesi ndaj fëmijëve, zhvillimi, rritja, udhëzimi dhe edukimi i tyre janë detyra tepër të vështira dhe tepër të rëndësishme. Çdo fëmijë kalon një mori fazash të ndryshme dhe secila prej tyre kërkon vëmendje të veçantë dhe udhëzime specifike.

Edukimi i fëmijëve duhet të përfshijë tre aspekte:

- Fizik
- Intelektual
- Shpirtëror

Fëmijët zakonisht u besohen nënave, prandaj edukimi i tyre duhet të bëhet i përsosur. Edukimi shpirtëror i fëmijëve me besimin islam është mjaft i rëndësishëm, sepse flitet për një komb të shëndoshë dhe të moralshëm.

8. Të drejtat e gruas siç i përcakton Islami

8.1. E drejta e arsimimit

Arsimi është kushti i parë që gruaja të mund të kuptojë njerëzoren dhe veten e saj. Gjatë gjithë historisë, në mjedise të ndryshme, gruaja është përballur me trajtume të ndryshme, por vetëm Islami ishte ai që pranoi dhe njohu plotësisht të drejtat e saj, duke i lënë vendin që i takon në legjislacionin e tij. Kushtetuta që solli Islami bëri atë që në atë kohë asnjëri nuk e mendonte, duke i dhënë gruas vendin më të lartë që meritonte. Vetëm Islami ishte ai që pranoi dhe i njohu plotësisht të drejtat e saj, prandaj duhet të përpiqemi me besimin tonë, punën tonë t'i tregojmë botës se feja islame nuk është fe e prapambetjes, siç përpiqen ta paraqesin disa, por, përkundrazi, siç po e përjetojmë edhe sot, ajo është fe e civilizimit dhe e integritetit të femrës në çdo aspekt të jetës dhe veçanërisht në planin e arsimit të

saj. Kjo është e qartë që në hyrje të Kur'anit, zbritja e të cilit filloi me fjalën “**Ikre - Lexo! Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi**”.

Edhe femra, si krijesë e Allahut, është e detyruar të mësojë urdhrat dhe porositë e Tij. Një femër e ditur, një komb i ndritur.

8.2. Në të drejtën e barazisë burrë-grua

Sheriati, ligji i Allahut, është drejtësi e plotë. Allahu i Madhëruar e ka nderuar gruan, duke e konsideruar atë qenie njerëzore të barabartë dhe të ngjashme me pjesën tjetër të shoqërisë, me burrin. Gruaja është qenie e pavarur dhe ka të drejtë që të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës me përgjegjësitë dhe funksionet, që ajo mund t'i ketë dhe nuk i cenojnë të qenët femër. Sipas jurisprudencës islame, gruaja është kompetente për jetën e saj në ekonomi, në veprimtari të ndryshme, etj. Sa marrin pjesë në rregullimin e çështjeve familjare, aq mund të kontribuojnë gratë edhe në mbajtjen e familjes. Islami nuk kërkon ndarjen e të drejtave ndërmjet burrit dhe gruas, ata janë bashkudhëtarë të jetës së tyre. Islami i ka dhënë gruas vendin që meriton në shoqërinë njerëzore, duke ia besuar edhe asaj përgjegjësinë e lartë shoqërore për të urdhëruar në çfarë është e mirë e për të ndaluar nga e keqja. Gruaja është dritë që ndriçon shpirtin e brezave. Arritjet e deritanishme tregojnë se

në jetën e myslimaneve militojnë pro intelektuale të devotshme në agjitimin e parimeve islame. Ato sot i gjen kudo, në universitet, në ministri, në parlament, në qeveri. Këto do të na shërbejnë për një mobilizim e organizim të mirë në dobi të përhapjes së kulturës islame.

Një grua me moral të vërtetë islam ciklon realizimin e trinomit: “Grua-Familje-Komb”.

Koha tashmë është në favorin tonë dhe anija e moralit dhe e shpirtit të gruas do të arrijë në bregun e shpresuar dhe të sigurt, duke realizuar të gjitha aspiratat që ajo ka pasur dhe, sot dhe përgjithmonë.

8.3. Jetë e lirë

Jurisprudenca islame, në përgjithësi, parasheh rol të drejtë për gruan në jetën ekonomike të shoqërisë, të jetë e lirë, të punësohet sipas aftësive dhe kapacitetit që disponon. Ajo ka të drejtë të jetë një menaxhere shumë e mirë, jo vetëm në familje, por edhe në punë, të jetë mjeke, inxhinierë, drejtuese, etj. Të gjitha këto virtyte profesionale, një grua e aftë dhe e moralshme i vë në shërbim të njerëzimit dhe të ardhmërisë së kombit.

Muhamedi a.s. ishte njohësi i të drejtave të mëdha të grave. Është një realitet i pranuar që në shoqëritë ku Islami zotëroi mendjet dhe zemrat për shekuj të tërë, gruaja ka kaluar e po kalon një jetë dukshëm të lumtur.

9. Perspektiva e gruas myslimane në shekullin e ri nën optikën e “Drita Islame”

Gruaja përbën një kontribut të një rëndësie të veçantë për rinovimin e shoqërisë. Nga ajo kërkohet që të njohë fenë, që të jetë prej atyre që pa i ndarë i kryejnë detyrat ndaj Allahut të Madhëruar, ndaj burrit, ndaj fëmijëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj atdheut. Emancipimi dhe përparimi i gruas, brenda normave islame, e bëjnë një shoqëri më të emancipuar, që kërkon afrimin e gruas në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe eliminimin e botëkuptimit të gabuar se gruaja është vetëm nënë, se funksioni i saj biologjik është vetëm të lindë fëmijë dhe se ajo duhet të jetë dhe të mbetet patjetër amvisë, e mbyllur dhe e lidhur vetëm me fëmijët. Gruaja bashkëkohore, e brumosur me ideologjinë islame, është gjithnjë e më shumë e emancipuar dhe me aftësi që i mundësojnë të jetë aktive në jetën ekonomike dhe politike. Detyrë themelore për të emancipuar shoqërinë sot është besimi në Zot. Besimi sjell qetësi, bindje, vendosmëri, një logjikë të shëndoshë, që e orienton njeriun për punë të mira. Ai që është i edukuar mirë në të gjithë shoqërinë është i mirëpritur dhe i respektuar. Prandaj Profeti a.s. ka thënë: “Jam dërguar për të përsosur moralin e lartë”.²

2. Hadith i transmetuar nga Imam Ahmedi, Imam Malik, Imam Buhari dhe Bejheku,

Eduko njeriun me normat e moralit islam. Islami është një sistem i plotë jetese që përfshin të gjitha aspektet e ekzistencës njerëzore dhe ka për qëllim ndërtimin e një njeriu dhe të një shoqërie mbi bazën e idealeve dhe vlerave të paraqitura në revelimin kuranor dhe mësimet e Profetit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Feja dhe besimi janë bazat morale mbi të cilat zhvillohet shoqëria njerëzore. Kur praktikohet bindje ndaj ligjit të Allahut shoqëria islame, qytetërimi i saj janë “Ideologji Universale” në origjinën e tyre. Koncepti i një bashkësie ideologjike nuk është diçka që qëndron vetëm në bazë të sjelljeve ekskluzivisht morale, por ka përmasa shoqërore, politike e ligjore. Në këtë sistem faktori shtytës është feja. Ajo është burimi nga ku rrjedhin institucionet shoqërore që nga familja e deri te shteti. Një detyrë të tillë për inductimin e fesë te njeriu e ka familja. Por sot jetojmë në një situatë të vështirë ku vëzhgohet degjenerimi i vetë njeriut si anëtar i

institucionit familje e shoqëri. Nën pretekstin e formimit të njeriut të ri, u arrit largimi i tij nga rruga e drejtë, nga rruga e moralit islam. Edukata fetare të rinjtë, në shumë raste, pothuajse është braktisur. Rinia është e tërhequr pas rrugës së krimit, prostitucionit, drogës, etj. Mjedisi ku jetojmë është i mbushur plot me rreziqe të cilat lënë pasoja si në ambientin familjar po ashtu edhe në atë shoqëror. Prandaj, nëse duam të kemi një jetë njerëzore, morale dhe të ndershme, le t'i kthehemi Islamit, sepse ai i jep përmbajtje personalitetit, krijon ndërgjegje të lartë, formon njeriun e mirë, i cili është bazë e jetës së mirë shoqërore në përgjithësi. Që të arrihet kjo, veçanërisht në tërheqjen e brezit të ri në rrugën e moralit islam, është e domosdoshme që gruaja të marrë rolin e misionares së fesë, e cila duhet të kryhet me devotshmëri, ashtu siç mëson e porosit Pejgambëri a.s. “Allahu dëshiron që kur ndonjëri prej jush të bëjë ndonjë punë, ta përkryejë atë (punë)”.

Musned 17/80 nr. 8939.

Literatura

1. Nasif Umer, F., Gruaja në Islam, Tiranë, 2014.
2. Topallioglu, B., Gruaja në Islam, Stamboll, 2000.
3. Balla, Xh., Kurani dhe Njeriu, Tiranë, 2008.
4. Murshid, A., Familja dhe Islami, Tiranë, 1999.
5. Turabi, M., Gruaja në Islam dhe në Shoqërinë Muslimane, Shkup, 1996.
6. Kerzun, E., Fëmijët tanë janë përgjegjësi, Tiranë, 2006.
7. Sibai, M., Etika jonë familjare, Tiranë, 2008.
8. Kepi, F., Unë dhe familja ime, revista Familja, 2007, f. 19.
9. Keçi, V., Islami, Perëndimi dhe marrëdhëniet burrë grua, revista Familja, 2010, f. 36.
10. Çelepija, E., Rinia, shpresë e së ardhmes, revista Familja, 2013, f. 9.
11. Daçig Goga, S., Për një familje moderne dhe të shëndoshë, revista Familja, tetor 2013, f. 3.

Procesi i pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe roli i saj në stabilitetin politik të Ballkanit dhe gjerë në Evropë

M.sc. Artan S. Mehmeti

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i procesit të pavarësisë së Kosovës, sfidat nëpër të cilat ka kaluar si dhe roli i pavarësisë si proces i domosdoshëm për stabilitetin politik të Ballkanit dhe më gjerë në Evropë.

Abstrakt

Republika e Kosovës me sipërfaqe prej 10.907 km², dhe rreth 2.2 milion banorë, është shteti më i ri në Botë. Procesi i pavarësisë së Kosovës ka kaluar nëpër një periudhë të gjatë dhe të vështirë, nga e cila mbetën shumë të vrarë dhe të zhdukur. Shteti më i ri në Botë është njohur nga 108 shtete. Shpallja e pavarësisë ka prodhuar stabilitet vendor dhe rajonal, këtë e ka vërtetuar edhe mendimi këshill-dhënës i GjND-së, duke e konstatuar edhe shumë politikanë dhe analistë të njohur ndërkombëtarë. Edhe pas shpalljes së pavarësisë Republika e Kosovës po përballet me vështirësi të shumta si në aspektin ekonomik – social ashtu edhe atë politik. Institucioneve të Kosovës ju mbetet edhe shumë punë për të punuar, që Kosova të ecë drejt rrugëtimit për të aderuar në BE dhe NATO. Pavarësia e Kosovës është vetëm një përmirësim i padrejtësive që i janë bërë popullit shqiptar në Konferencën e ambasadorëve në Londër, nga e cila, Kosova dhe pjesë të tjera shqiptare, iu shkëputën shtetit shqiptar dhe iu dhanë shteteve fqinje.

Pozita gjeopolitike e Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës shtrihet në Gadishullin Ballkanik. Kufiri i Kosovës, nga aspekti politik, është kufi artificial i imponuar për arsye se në tre anët e kufirit Kosova kufizohet me troje shqiptare, ndërsa për sa i përket aspektit fiziko - gjeografik, kufiri i Kosovës është kufi natyror sepse kufirin e përcaktojnë malet, luginat dhe qafat. Kosova me të gjithë elementët gjeografikë është një hapësirë e individualizuar dhe specifike. Nëpër territorin e saj kalojnë rrugë të rëndësishme të cilat lidhin Evropën e Qendrore me Detin Mesdhe dhe me brendësinë e Gadishullit Ballkanik. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Evropës.¹

Republika e Kosovës (historikisht Dardania) është vend i pavarur në Evropën Juglindore, ka një sipërfaqe prej 10.907 km²,² me popullsi rreth 1,8 milion banorë (Këtë regjistrim komuniteti serb e bojkotoi. Numri i banorëve të komunitetit serb vlerësohet të jetë rreth 200 mijë), prej të cilëve rreth

200 mijë banojnë në Prishtinë, që është kryeqyteti dhe qendra më e rëndësishme e vendit.³ Shumicën e popullsisë e përbëjnë shqiptarët me rreth 90 %, ndërsa komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë janë: serbët, turqit, goranët, boshnjakët, romët, ashkalinjët, egjiptianët (këto 3 komunitete, romët, ashkalinjët dhe egjiptianët para vitit 1999 kanë qenë një i vetëm dhe njiheshin vetëm si romë).

Kosova, që nga kohët e lashta deri te pushtimi nga Mbretëria Serbo – Kroate – Sllovene

Që nga kohët e lashta Kosova ka qenë vatër e qytetërimit ilir, të cilët janë paraardhësit e popullit shqiptar. Në shek. e IV p.e.s., u themelua mbretëria Dardane e cila përfshinte edhe hapësirën e Kosovës së tanishme. Me pushtimin e Ballkanit nga perandoria Romake edhe Mbretëria Dardane (Kosova) në shek. I p.e.s bëhet pjesë e Perandorisë Romake. Pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395, trojet shqiptare në përgjithësi dhe Kosova në veçanti u bënë pjesë e Perandorisë Bizantine apo Perandorisë Romake të Lindjes. Pas dobësimit të Perandorisë

1. Dr. Riza I. Çavolli, GJEOGRAFIA REGIONALE E KOSOVËS, Prishtinë 1997, f. 5.

2. Dr. sc. Florim Isufi & Dr. Gani Gashi, Krijimi i Gjeo Bazës së të dhënave në Kosovë, KËRKIME GJEOGRAFIKE 14, Prishtinë 2008, f. 131.

3. Sipas regjistrimeve të vitit 2011, <http://ask.rks-gov.net/> shikuar më 19.12.2015.

Bizantine, në Ballkan, në fillim të shek. XIII, krijohet shteti i fuqishëm serb; ndërsa Dardania ra tërësisht nën sundimin serb, në kohën e mbretit serb Stefan Dushani (1331 – 1355). Sulmet e ushtrive osmane për pushtimin e viseve shqiptare nisën në mesin e viteve 80 të shek. XIV. Në këto vite Kosova pushtohet nga perandoria Osmane. Pas shumë përpjekjeve dhe luftërave për autonomi dhe pavarësi nga Perandoria Osmane më 28 nëntor 1912 u shpall pavarësia e Shqipërisë. Por fatkeqësisht, në Konferencën e Londrës, që është mbajtur në dhjetor 1912, nga Fuqitë e Mëdha (Britania, Gjermania, Rusia, Austro – Hungaria, Franca dhe Italia) u vendos copëtimi i trojeve shqiptare, ku Kosova dhe disa pjesë të tjera shqiptare ju dhanë Serbisë. Territori i sotëm i Kosovës, i pushtuar nga Serbia dhe Mali i Zi, iu aneksua këtyre dy vendeve të cilat ndoqën fushatë për asimilimin e popullsisë shqiptare dhe kolonizimin e tokave të tyre. Edhe pse populli shqiptar luftoi përkrah forcave Aleate gjatë Luftës së Parë Botërore duke arritur të fitojnë përkrahjen e presidentit paqedashës të SHBA-ve Woodrow Wilson, vendimet e Kongresit të Paqes së Versajës, të mbajtur nga 18 janari deri më 28 qershor 1919, e mundësuan ripushtimin e Kosovës

nga Mbretëria Serbo – Kroate – Sllovene, e quajtur më vonë Jugosllavi.⁴

Kosova si pjesë e RSF të Jugosllavisë

Në vitin 1941 Mbretëria Jugosllave pushtohet nga forcat e Boshtit, ndërsa territori i Kosovës u nda midis forcave italiane, bullgare dhe gjermane. Pjesa më e madhe e Kosovës, në këtë kohë, ishte nën sundimin italian, të cilët këtë pjesë ja bashkuan Shqipërisë. Nga 31 dhjetori i vitit 1943 e deri më 3 Janar të vitit 1944 u mbajt Konferenca e Bujanit, si përpjekje e popullsisë shqiptare për vetëvendosje. Kjo konferencë hartoi një rezolutë ku, pas mbarimit të luftës, shqiptarët kishin të drejtë për vetëvendosje, në mënyrë që të bashkohen me Shqipërinë, ndërsa gjatë luftës forcat shqiptare të Kosovës duhet të luftonin përkrah Forcave Komuniste Jugosllave. Pas mbarimit të luftës kërkesat e shqiptarëve nuk u morën parasysh nga Qeveria Komuniste Jugosllave.⁵

Më 1945 Forcat Komuniste Shqiptare hynë në Kosovë për t’ju ndihmuar Forcave Komuniste Jugosllave për të larguar pushtuesin

4. E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, “8 Nëntori”, Tiranë: 1990, f. 49.

5. Po aty, f. 74.

nazist nga këto troje. Këto forca nuk i kushtuan fare vëmendje çështjes shqiptare në Kosovë, duke lejuar rianeksimin e Kosovës nga Serbia, që në këtë kohë ishte shpallur republikë anëtare e Jugosllavisë. Më këtë aneksim, tashmë nga Republika Socialiste e Jugosllavisë (RSFJ), qëndresa shqiptare e Kosovës u tradhtua nga dy anët, si nga Forcat Komuniste Shqiptare, ashtu dhe nga Forcat Komuniste Jugosllave, të cilët shkatërruan shumë fshatra duke vrarë e masakruar shumë civilë, njëlloj si paraardhësit e tyre nga Mbretëria Jugosllave. Këto shtypje nga ana e nacionalistëve serbo – jugosllavë, e rënduan tej mase jetesën normale të popullsisë shqiptare në trojet e tyre, jo vetëm në Kosovë, por në përgjithësi edhe të trojeve shqiptare që mbetën nën Jugosllavi. Të nisur nga këto arsye, lëvizjet studentore së bashku me udhëheqësit politik të Kosovës, u munduan që të ushtrojnë tryzni tek autoritet qendrorë jugosllave, që ti ndalojnë vrasjet, përndjekjet, persekutimet, burgimet, duke kërkuar përmirësimin e pozitës së popullsisë shqiptare. Kërkesat nuk u realizuan dhe nuk u morën parasysh. Si pasojë e kësaj, më 28 nëntor të vitit 1968, shpërthyen demonstratat e studentëve shqiptarë të cilët kërkonin të drejtat e tyre kombëtare,

përdorimin e gjuhës shqipe dhe të flamurit kombëtar.⁶

Si rezultat i demonstratave të vitit 1968, Kosovës i lejohet të këtë Kushtetutën e saj. Në vitin 1969 hartohen ligjet e para të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Kurse në vitin 1974 u hartua Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, së bashku me Kushtetutën e re të RSFJ-së, Kosovën e lanë si pjesë të Republikës Socialiste të Serbisë, mirëpo duke e ngritur ndjeshëm në aspektin politik, ekonomik, social, arsimor, si dhe duke i dhënë të drejtë vote në organet qendrore federative. Gjatë viteve 70 shqiptarët gëzuan edhe shumë të drejta të tjera. Në vitin 1970 u themeluan: Universiteti i Kosovës, Akademia e Arteve dhe Shkencave, si dhe Radiotelevizioni i Prishtinës (RTP). Këto të drejta, si dhe shumë të drejta të tjera, u mundësuan shqiptarëve të krahinës ngritjen e nivelit arsimor, intelektual, kulturor, si dhe një zhvillim të mëtejshëm.⁷

Për dallim nga vitet 70, në vitet 80, Kosova, në të shumtën e rasteve, ndodhej në shtetrrethim. Qeveria e Serbisë e përkrahur nga nacionalistët

6. Eva Hyskaj Tafili, Ballkani përgjatë periudhës moderne, "Progresi", Tiranë: 2006, f. 27.

7. E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët..., f. 62.

serbë që jetonin në Kosovë, filluan një fushatë të egër kundër popullsisë shqiptare. Gjatë këtyre viteve shqiptarët u burgosën, u vranë, u zhdukën, u larguan me dhunë nga shtëpitë e tyre. Si pasojë e lodhjes nga kjo gjendje, më 11 dhe 26 mars të vitit 1981 shpërthyen demonstratat studentore të Universitetit të Kosovës. Më 2 prill 1981 Beogradi shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë dhe ndaloi qarkullimin e mbi dy vetave së bashku në vendet publike. Kjo qeveri ndërpreu mësimin në shkollat fillore, në ato të mesme, si dhe në universitete. Mbylli konviktet e studentëve dhe të nxënësve në Prishtinë. Masa të njëjta u ndërmorën edhe në komunat e tjera të Kosovës. Demonstratat vazhduan përgjatë viteve '80, nga të cilat shumë veprimtarë shqiptarë u burgosën dhe të tjerë u detyruan të lënë vendin.⁸ Edhe pas shtetrrethimit që u vu menjëherë pas fillimit të demonstratave, si dhe shtypjeve të egra që i bëheshin popullsisë shqiptare nga forcat serbo-jugosllave, Qeveria Jugosllave me udhëheqësin e ri Slllobodan Millosheviç nuk u mjaftuan me kaq, por së bashku me nacionalistët serbë, në vitin 1987,

organizuan në Fushë Kosovë një komplot kundër autonomisë së Kosovës dhe popullsisë shqiptare. Agjentët serbë fajësuan shqiptarët për *“jetën e vështirë të serbëve në Kosovë dhe sulme të vazhdueshme ndaj pranisë së tyre në këtë trevë, akuza ishte se shqiptarët po tentonin të kryenin spastrim etnik”*.⁹

Regjimi i Slllobodan Millosheviçit edhe pas komplotit kundër autonomisë së Kosovës, vazhdoi me burgosjen e udhëheqësve, intelektualëve, mësuesve, si dhe mbarë popullsisë shqiptare. Duke mos u mjaftuar me kaq, ky regjim, më 23 mars të vitit 1989, me ndihmën e forcave policore dhe ushtarake, duke ia u imponuar votën deputetëve shqiptarë, si dhe me një numërim të votave në mënyrë jo demokratike dhe jo transparente, i heq Kosovës autonominë e cila i garantonte popullsisë së Kosovës disa të drejta, duke e kthyer Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë. Shuarja e autonomisë po shënonte fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë paraqiste hyrje në një periudhë tepër të rëndë për shqiptarët, të cilët po trajtoheshin jo vetëm si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtroheshin torturave sistematike nga regjimi kriminal serb. Në të njëjtin vit forcat

8. <http://shenja.mk/index.php/kulture/histori/4448-demonstratat-studentore-te-vitit-1981.html> (Sabile Keçmezi-Basha) shikuar më 25.01.2015.

9. <http://kosova-app.weebly.com/>, shikuar më 25.01.2015.

e armatosura serbe hynë në Kosovë duke e mbajtur atë të pushtuar për dhjetë vite më radhë.¹⁰

Kosova gjatë periudhës 1990 – 2008

Në kushtet e okupimit serb, më 2 korrik 1990 deputetët e KSA të Kosovës, të ndaluar të hynë në godinën zyrtare, e lexuan deklaratën e pavarësisë, duke e shpallur kështu Kosovën Republikë, anëtare të federatës Jugosllave. Shpallja e pavarësisë u pasua edhe me miratimin e Kushtetutës më 7 shtator të po atij viti. Ishte kjo koha kur në horizont tashmë dukej shpërbërja e qartë e ish-RSFJ-së, krijesë kjo artificiale dhe krejtësisht antishqiptare e dominuar nga ambicet dhe politika hegjemoniste serbe.¹¹ Në këto procese rol kyç luajtën forcat politike të Kosovës, që sapo ishin themeluar, në veçanti Lidhja Demokratike e

Kosovës (LDK) e Udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova. Në tetor të vitit 1991, u zhvillua referendumi mbarë popullor, i cili zyrtarisht e shpalli Kosovën shtetet të pavarur dhe sovran. Presidenti i parë i Republikës së Kosovës u zgjodh Dr. Ibrahim Rugova, ndërsa qeveria ishte në mërgim, e me kryeministrin Bujar Bukoshi. Më 24 Maj 1992 u zhvilluan zgjedhjet presidenciale, ku president u zgjodh Dr. Ibrahim Rugova, i cili ishte gjithashtu edhe kryetar i LDK-së. Rugova zgjodhi rrugën e rezistencës paqësore për të arritur deri te pavarësia e shtetit të Kosovës.

Prej shpalljes së pavarësisë e deri në fillimin e luftës së viteve 1997-99, në të gjithë Kosovën u organizuan demonstrata popullore. Kjo kohë për popullsinë shqiptare ishte shumë e vështirë, për arsye se çdo ditë arrestoheshin, torturoheshin, burgoseshin, dhe vriteshin, në mënyrën më çnjerëzore me dhjetëra civilë shqiptarë të pafajshëm. Në këtë kohë u mbyllën shkollat, u larguan punëtorët shqiptarë nga administrata shtetërore dhe publike, si dhe nga fabrikat, duke e vështirësuar tej mase jetën e popullsisë shqiptare. Kjo politikë synonte largimin e shqiptarëve nga Kosova. Në Gusht të vitit 1997, UÇK-ja merr mbi vete përgjegjësinë kundër sulmeve

10. Eva Hyskaj Tafili, 'Tranzicioni politik në Evropën Qendrore dhe Lindore, PEGI, Tiranë: 2008, f. 51.

11. ISAK SHERIFI, Zhvillimet politiko – diplomatike në ish – Jugosllavi me theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981 – 2008, f. 42, Temë e Doktoratës, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Tiranë 2013, (<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/02/Doktoratura-Isak-Sherifi-Instituti-Studimeve-Europiane1.pdf>) shikuar më 28.12.2015.

serbe dhe bashkëpunëtorëve të tyre, ndërsa më 28 nëntor të po këtij viti, në fshatin Llaush të Skënderajt, për herë të parë del publikisht UÇK-ja. Më 28 shkurt të vitit 1998, ushtria dhe paramilitarët serbë organizuan sulmin në fshatrat Likoshan dhe Qirez të Drenicës. Kjo datë njihet edhe si fillimi i Luftës në Kosovë. Në vitet 1998 – 1999, ushtria serbe kreu gjenocid të tmerrshëm, duke vrarë dhe masakruar rreth 15 mijë civilë shqiptarë, shumica gra e fëmijë, e duke dëbuar me dhunë rreth 1 milion civilë. Gjatë kësaj kohe janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur mirëpo ekzistojnë akoma shumë të tjerë që nuk dihen. Për të ndaluar këtë luftë të përgjakshme, jo të drejtë, më 6 shkurt të vitit 1999 i filloi punimet Konferenca e Rambujesë, afër kryeqendrës franceze, Parisit. Pas përfundimit pa sukses të këtyre bisedimeve, si dhe refuzimit të presidentit të RSFJ-së, Slobodan Millosheviç, që të pranonte marrëveshjen për Kosovën dhe vendosjen e trupave ndërkombëtare, më 24 mars të vitit 1999, forcat e NATO-s fillojnë bombardimet kundër trupave ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Bombardimet përfunduan më 6 qershor 1999 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës

që parashihte tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e trupave paqësore ndërkombëtare. Po në këtë vit, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244, që juridikisht Kosovën e mban si pjesë të Jugosllavisë, mirëpo nën protektoratin ndërkombëtar. Sipas kësaj rezolute OKB ka përgjegjësinë për administratën civile, ndërsa NATO për sigurinë në Kosovë. Që prej vitit 1999 e deri më 2008 Kosova u drejtua nga Qeveria Vetëqeverise e Kosovës, por nën protektoratin ndërkombëtar UNMIK (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë).¹²

Shpallja e pavarësisë, sfidat dhe roli i saj në stabilitetin politik të Ballkanit dhe më gjerë në Evropë

Më 2 shkurt 2007, i dërguari special për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij për zgjidhjen e statusit të Kosovës në Prishtinë dhe Beograd. Si nga pala kosovare, ashtu edhe analistët e huaj ishin të mendimit se ky propozim e bën Kosovën shtet të pavarur. Pas pranimit të propozimit nga pala kosovare dhe refuzimit nga pala serbe, Qeveria e Kosovës,

12. Eva Hyskaj Tafli, Ballkani përgjatë periudhës moderne..., f. 32.

me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare si SHBA-ve, shteteve të Bashkimit Evropian (BE), dhe Turqisë, më 17 shkurt 2008, shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kosova u bë shteti më i ri në botë i njohur ndërkombëtarisht. Afganistani dhe Kostarika ishin vendet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës, të përcjella nga Shqipëria, SHBA-ja, Britania, Gjermania, Franca, Turqia, etj. Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga 112 etnitete sovraane, nga të cilat 108 shtete janë anëtare të OKB-së, nga 193 që ka gjithsej OKB-ja, si dhe nga shumica e shteteve të BE-së, dhe NATO-s. Njohjet e fituara deri më tani e tregojnë dhe e vërtetojnë se pavarësia e Republikës së Kosovës është një proces i domosdoshëm dhe i pa kthyesëm, për botën demokratike, si proces që nuk kishte rrugë tjetër përpos pavarësisë.¹³

Për Serbinë shpallja e Pavarësisë ishte e pa pranueshme dhe përbente shkelje ndërkombëtare, duke shkelur Rezolutën 1244, si dhe kornizën kushtetuese të UNMIK-ut. Të bindur për këto shkelje, Ministri i Jashtëm i Serbisë, Vuk Jeremiç, më 15 gusht 2008, i dërgoi një kërkesë OKB-së, për të kërkuar mendimin e GjND-së (Gjykatës Ndërkombëtare

të Drejtësisë) rreth aktit të pavarësisë së Kosovës. Më 22 korrik 2010 GjND-ja me 10 vota pro, si dhe 4 vota kundër konstaton se: “... shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, rezolutën 1244, si dhe kornizën kushtetuese të UNMIK-ut”. Pro pavarësisë kanë votuar edhe shtete që në atë kohë, por edhe tani akoma nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, siç ishte rasti i Brazilit dhe Meksikës. Kishte shtete që janë tërhequr nga votimi. Kërkesën e dërguar nga ana e Serbisë, analistët ndërkombëtarë e kanë konsideruar “autogol” për Serbinë, e në favor të Kosovës duke e vërtetuar ligjshmërinë e pavarësisë, si proces në përputhshmëri me të drejtat ndërkombëtare, e i domosdoshëm për stabilitetin ballkanik.¹⁴

Pavarësinë e Kosovës, si një vendim i drejtë dhe i pa kthyesëm e vërteton anëtarësimi i saj në shumë organizata ndërkombëtare. Kosova sot është pjesë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, e Marrëveshjes së CEFTA-s, dhe shumë organizatave të tjera. Kosova është pranuar në shumë federata

13. Eva Hyskaj Tafili, Tranzicioni politik në Evropën Qendrore dhe Lindore..., f. 63.

14. <http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/8361/Kush-jane-vendet-ge-votuan-pro-dhe-kunder-ne-GJND>, shikuar më 29.12.2015.

sportive, ku rëndësi të veçantë ka pranimi në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar.

Republika e Kosovës sot ka institucionet e veta demokratike të dala nga vota e lirë e popullit. Ka parlamentin që ka 120 deputetë. Kosova ka të vendosura marrëdhënie diplomatike me të gjitha shtetet që e kanë njohur si shtet të pa varur.

Kosova sot përballet me vështirësi të shumta, ndër të cilat mund të veçojmë ato më të rëndësishmet, të cilat edhe kërkojnë zgjidhje urgjente:

1. Mos shtrirja e pushtetit të qeverisë së Republikës së Kosovës në gjithë territorin e Kosovës, problem kryesor mbetet veriu i vendit,
2. Procesi i njohjeve, që po ecën me ritme shumë të ngadalta,
3. Gjendja ekonomike – sociale e rënduar,
4. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme,
5. Procesi i liberalizimit të vizave,
6. Dhe së fundi problemet e brendshme politike.

Një raport i Grupit Ndërkombëtar të krizave lidhur me veriuin e Kosovës, rekomandon: “autonomi të pjesës veriore të Kosovës, në kontekst të kësaj Lugina e Preshevës patjetër duhet të bëhet pjesë e Kosovës, përkatësisht pjesë e Shqipërisë”. Ky raport nga Qeveria e Kosovës është i papranueshëm

duke theksuar se statusi politik i Kosovës është zgjidhur më 17 shkurt 2008, si dhe territori i Kosovës është i pa diskutueshëm. Këtë raport e kanë kundërshtuar edhe shtetet me të fuqishme që e kanë njohur Kosovën si ShBA-të, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Turqia, si dhe vendet fqinje të Kosovës përveç Serbisë. Këto shtete e konsiderojnë si shumë të rrezikshme ndarjen e Kosovës, duke nxitur ndryshimin e gjithë kufijve të shteteve ballkanike. Këto ndryshime do të çonin deri te shpërthimi i një lufte të gjerë mes popujve ballkanikë, kur dibet se kufijtë e shteteve ballkanike janë kufij artificialë dhe nuk përputhen me kufijtë e shtetit Komb. Qeveria e Kosovës bëri një veprim të mençur, që nuk e pranoi, dhe e kundërshtoi, sepse nga ky propozim Kosova do duhej të bënte shkëmbime të territoreve të veta.¹⁵

Në mos stabilitetin politik të Ballkanit, që nga Lufta e Parë Botërore, rol të rëndësishëm nuk ka luajtur vetëm Kosova, por mund të përmendim tre faktorë të cilët pothuajse çdo dhjetë vite kanë shkaktuar luftëra në Ballkan. Këta 3 faktorë kryesorë janë:

1. *Copëtimi i trojeve shqiptare,*
2. *Krijimi i shtetit artificial të Jugosllavisë, si dhe*
3. *Problemët kufitare ndërmjet shteteve ballkanike. Për aq kohë sa këta*

15. <http://www.rtvpresheva.com/?p=4222>, shikuar më 29.12.2015.

tre faktorë nuk zgjidhen, në Ballkan nuk do të ketë stabilitet politik, edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e as me futjen e Ballkanit në BE e NATO. Ballkani dhe Evropa, do të kenë stabilitet politik vetëm atëherë kur të zgjidhet çështja shqiptare, dhe kufijtë e Ballkanit të jenë kufij natyrorë e të pranueshme për të gjithë popujt e Ballkanit.

Përfundim

Si përfundim mund të konstatojmë, se Republika e Kosovës me sipërfaqe prej 10.907 km², dhe rreth 2.2 milion banorë, është shteti më i ri në Botë. Procesi i pavarësisë së Kosovës ka kaluar nëpër një periudhë të gjatë dhe të vështirë, nga e cila mbetën shumë të vrarë dhe të

zhdukur. Shteti më i ri në Botë është njohur nga 108 shtete. Shpallja e pavarësisë ka prodhuar stabilitet vendor dhe rajonal, këtë e ka vërtetuar edhe mendimi këshilldhënës i GjND-së, duke e konstatuar edhe shumë politikanë dhe analistë të njohur ndërkombëtarë. Edhe pas shpalljes së pavarësisë Republika e Kosovës po përballet me vështirësi të shumta si në aspektin ekonomik – social ashtu edhe atë politik. Institucioneve të Kosovës ju mbetet edhe shumë punë për të bërë, që Kosova të ecë drejt rrugëtimit për të aderuar në BE dhe NATO. Pavarësia e Kosovës është vetëm një përmirësim i padrejtësive që i janë bërë popullit shqiptar në Konferencën e ambasadorëve në Londër, nga e cila, Kosova dhe pjesë të tjera shqiptare, iu shkëputën shtetit shqiptar dhe iu dhanë shteteve fqinje.

Haxhi Ismail B. Rexhepi (3.11. 1947 – 13. 11. 2016)

nga Akademik Feti Mehdiu

Abstrakt

Imami i xhamisë “Haxhi Ramadan” në Prizren dhe imami i xhamisë “Hadim Aga” në Gjakovë. Njeri i palodhur, i cili kreu edhe funksionin e kryeimamit të Kështillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë. Sa ishte me detyrë në Gjakovë dhe kontribut të veçantë në organizimin e shumë aktiviteteve të rëndësishme për popullatën e këtij rajoni. U kujdes sidomos për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të dëshmorëve e viktimave të luftës, për grumbullimin e mjeteve për ndihmë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të cilën iu dha edhe Mirënjohje në Ditën e Flamurit, më 28 nëntor 1997, nga Këshilli Komunal në Prizren. Mori pjesë edhe në aksionin e faljes së gjakeve dhe në takime zyrtare në misione ndërkombëtare, që vëzhgonin situatën e zhvillimeve të luftës në Kosovë.

Më 13 dhjetor 2016 ndërroi jetë haxhi Ismail B. Rexhepi – rhm, profesor i historisë, punonjës shkencor në Arkivin e Kosovës.

Ismail B. Rexhepi lindi më 3 nëntor 1947, në fshatin Bresanë të Opojës. Këtu kreu shkollën fillore. Shkollimin e mesëm e vazhdoi në

Medresen Alauddin, në Prishtinë. Më 1 shtator 1972 diplomohet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, grupi: Histori – Gjeografi, ndërsa më 12. Dhjetor 1977, diplomohet në Degën e Historisë, në Universitetin e Prishtinës. Në vitin shkollor 84-1983, ka qenë në Specializim për hulumtime në Kajro.



Në Arkivin e Kosovës filloi punën me 7 nëntor 1978, *Shërbimit për mbrojtjen e lëndës arkivore*. Nga 9 janari deri më 3 korrik 1978 ndoqi kursin special të arkivistikës. Më 28.01.1987 u Certifikua për njohje të Gjuhës Serbo-kroate. Gjithashtu pati kryer edhe kursin e gjuhës angleze.

Punoi profesor i historisë në shkollën fillore «Zenel Salihu», në Bellaqevc, (1972) kurse nga viti 1978, kalon me punë në Arkivin e Kosovës, *shërbimit për mbrojtjen e lëndës arkivore*.

Vitet 1990-1993, i kaloi ashtu sikurse edhe shumica e intelektualëve shqiptarë të Kosovës, të përzënë nga puna, duke furnizuar me artikuj ushqimorë lagjen e vet në Prizren.

Ka kryer detyrën e imamit në xhaminë “Haxhi Ramadan” në Prizren prej 15 nëntorit 1993 deri më 20 shtator 1995, kur transferohet

në Gjakovë, imam i xhamisë “Hadim Aga”. Këtu kreu edhe funksionin kryeimam i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë. Sa ishte me detyrë në Gjakovë dha kontribut të veçantë në organizimin e shumë aktiviteteve të rëndësishme për popullatën e këtij rajoni. U kujdes sidomos për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të dëshmorëve e viktimave të luftës, për grumbullimin e mjeteve për ndihmë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të cilën iu dha edhe Mirënjohje në Ditën e Flamurit, më 28 nëntor 1997, nga Këshilli Komunal në Prizren. Mori pjesë edhe në aksionin e faljes së gjaqeve. Mori pjesë edhe në takime zyrtare në misione ndërkombëtare, që vëzhgonin situatën e zhvillimeve të luftës në Kosovë.

Gjatë periudhës 1994 - 1999, punoi profesor në medresenë “Alaudin” – paralelja në Prizren. Në pranverën e vitit 1999 – u gjend në kampin e Kukësit – me popullatën shqiptare të përzënë me dhunë nga Kosova. Këtu ofroi ndihmë të veçantë në organizimin e mbarëvajtjes së jetës së të ndjekurve nga Kosova.

Ismail Rexhepi Kosovës i la tre djem: Fazliun, Nevahiun, Muaviun dhe plot nipa e mbesa. Shkençës dhe kulturës shqiptare, nga fusha e historisë dhe islamistikës, i la kontribute të çmueshme, si në vijim:

- *Ismail Rexhepi,*
Dokumentet osmane në Arkivin e Kosovës, Vëllimi I, Prishtinë, 2004.

- Ismail Rexhepi, *Dokumentet në gjuhën osmane në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës*, vëllimi II, Prishtinë, 2013.
- Ismail Rexhepi – koautor, *Arhivski fondovi i zbirke u SFRJ–SAP Kosovo-Fondet dhe koleksionet arkivore në RSFJ-KSA-Kosovë*, Beograd, 1986.
- Ismail Rexhepi – koautor, *Udbërrëfyesi i fondeve dhe koleksioneve arkivore*, vëllimi II, Prishtinë, 2003.
- Ismail Rexhepi – koautor, *Udbërrëfyesi i fondeve dhe koleksioneve arkivore*, vëllimi III, Prishtinë, 2004.

Përkthime:

- Ahmet Behxhet, *All-llahu – të konceptuarit islam dhe besimi*, Prizren 1994.
- Mustafa Mahmud, *Kur’ani – përpjekje bashkëkohore për ta kuptuar*, Prizren, 1997.
- Dr. Abdulbasit Muhammed Es-Sejjid, *Të ushqyerit sipas të Dërguarit a.s.- ushqimi midis sëmundjes dhe ilaçit*, Prishtinë, 2009.
- Amër Halid, *Rrëfime që udbëzojnë*, Prishtinë, 2009.
- Amër Halid, *Morali i besimtarit*, Prishtinë, 2009.
- Dr. Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, Prishtinë, 2012.

Studime e artikuj

- *Depoja e Arkivit dhe vendosja e lëndës arkivore*, “Vjetari”, nr. 14 - 15, (1978 -1979), 1982, f. 385 – 390.
- *Cili ishte vendimi i gjyqit kushtetues të ish-RSFJ-së për deklaratën kushtetuese të 2 korrikut 1990*, “Vjetari”, nr. 35 – 36/2006, f. 489 – 494 (në bashkautorësi)
- *Depoja e Arkivit*, “Vjetari”, nr. 35–36/2006, f. 539–546.
- *Historiku dhe mbrojtja e lëndës arkivore*, “Vjetari”, nr. 20/1985, f. 205–211.
- *Formimi i fondit arkivor*, “Vjetari”, nr. 23/1987, f. 449 – 454.
- *Dokumentet arkivore dhe rëndësia e tyre*, “Vjetari”, nr. 29–30/2003, f. 573 – 582.
- *Valorizimi i dokumenteve arkivore*, “Vjetari”, nr. 33 – 34/2005, f. 371 – 376.

“Dituria Islame” – Prishtinë

- *Haxhi Rexhep Ismaili (1871-1956)*, nr. 77 / 1996, f. 50.

- *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinë më 1943-1944*, (bashkautor), nr. 136/ 2001, f. 45-50.
- *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Gjakovë me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore*, (bashkautor), nr. 142/2002, f. 45-48.
- *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinë më 1943-1944*, II, (bashkautor), nr. 143/ 2002, f. 48-50.
- *Mbresa nga Haxhi*, nr. 163/2004, f. 62.
- *Në kujtim të ditëlindjes së më të madhit njeri – Muhammedit a.s.*, nr. 165/2004, f. 19.
- Hysein Xhozo, *Të rinjtë dhe religjioni*, nr. 138/ 2001, f. 21-23.
- Salih Çollaković, *Si jemi të edukuar*, nr. 144-145/ 2001, f. 27-28.
- Hysein Xhozo, *Agjërimi*, nr. 148/ 2002, f. 18-21.
- Muhamed Qutub, *A është tejkaluar feja*, nr. 156-157/ 2003, f. 13-14.
- Dr. Jusuf Ramiq, *Kaptina El-kadër (Nata e Kadrit)*, nr. 159/2003, f. 45-46.
- Sami Zemni, *A ka vend islami në Evropë*, nr. 162/ 2004, f. 34-36.
- Shefko Omerbashiç, *Ibn Halduni*, nr. 167/2004, f. 45-46.
- Dr. Xhemaludin Latif, *Synimet e ixhtibadit tonë*, nr. 179/ 2005, f. 20-23.
- Mr. Mustafa Prlaça, *Para përdimit të diellit (ose: A kanë ngecur myslimanët për shkak të moszbatimit të Shpalljes)*, nr. 188/ 2006, f. 14-16.

“Edukata Islame”, Prishtinë

- Mustafa, Spahiq, *Pamje të Amerikës*, nr. 65/2001, f. 135-157.
- Hysein Xhozo, *Problemi i prapambeturisë së përgjithshme*, nr. 67/2002, f. 151-162.
- Hysein Xhozo, Husein, *Etika si element shumë i rëndësishëm i lumturisë dhe kënaqësisë së përgjithshme*, nr. 73/2004, f. 33-42.
- Glishe Elezović, Glishe, *Tarabhanja (Derb –Haneja) në Nova Bërdë –Akçe (Aspra) Osmane të farkuara në farkëtarinë e Nova Bërdës*, (bashkpërkthyes), nr. 80/2006, f. 233-252.
- Hasan Kaleshi – Ismail Eren, *Mahmut Pashë Rrotulla nga Prizreni – përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij*, (bashkpërkthyes), nr. 81/2006, f. 151-189.
- Dr. Hasan Kaleshi, *Veziri i madh Koxha Sinan Pasha – përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij*, 2007, (bashkpërkthyes), nr. 82/2007, f. 95-144.
- Hasan Kaleshi – Rexhep Ismaili, *Kukli Begu dhe vakëfnameja e tij*, (bashkpërkthyes), nr. 83/2007, f. 201-224.
- Dr. Hasan Kaleshi, *Vakëfnameja dhe vakëfet e Sunkur Çausb begut nga Manastiri*, (bashkpërkthyes), nr. 86/2008, f. 123-143.

- Enes Kujunxhiq, *Transferimi i shkencave greke dhe arabo-islame në perëndim përmes al-Andaluzisë*, nr. 95/2011, f. 177-195.
- Maxhida Beqirbegović, *Objektet arsimore fetare islame të arkitekturës në Kosovë*, nr. 102, Prishtinë 2013, f. 108-140.
- Muxhait Asimov, *Monumentet mbivarrore në gjubën osmane në Kosovë*, nr. 103, Prishtinë, 2013, f. 167-184.
- Mehmet Kico, *Letërsia islame në mes arabizmit dhe arabistikës – Feti Mehdiu dhe punimet e tij në gjubën boshnjako-kroato-serbe*, nr. 109, Prishtinë 2015, f. 241-258.

Studime Orientale – Prishtinë

- Salih Trako, *Beteja e Kosovës e vitit 1389 në historinë e Idris Bitlisit*, nr. 2/2002, Prishtinë, f. 153-175 (përktheu Ismail Rexhepi).
- Divna Gjuriq – Zamolo, Kontribut për njohjen e xhamive të Beogradit, nr. 2/2002, Prishtinë, f. 177-190.
- Fehim Bajraktareviq, *Një burim bashkëkohor persian për Betejën e Kosovës*, nr. 3/2012, Prishtinë, f. 39-59 (përktheu Ismail Rexhepi); I njëjti edhe në librin: Feti Mehdiu, *Reflektime të luftës së shqiptarëve për pavarësi...* Prishtinë, 2012, f. 125-156.

Perla – Tiranë

- Mehmet Kico, *Letërsia islame në mes arabizmeve dhe arabistikës – Feti Mehdiu dhe punimet e tij në gjubën boshnjako-kroato-serbe*, Tiranë, 2015.
Adil Ebu Shanab, Teatri palestinez në territorin e okupuar, (Feti Mehdiu, Për letërsinë arabe, Prishtinë, 2005, f. 165-175.)
Salah Abdussabur, Abbas Mahmud al-Akkad figurë kontradiktore, (F. Mehdiu, Për letërsinë arabe, 2005, Prishtinë, f. 198-218).

Kush njëf vet-vedin njëf Zotin

قال عليه الصلاة والسلام: «من عرف نفسه فقد عرف ربه»

Abstrakt

Këtu qellimi me këtë mësim Profetik, «Kush njëf vet-vedin njëf Zotin» nuk është se ajo që njëf figuren e vet, përfaqe, njëf Perendin, por ajo njeri që të ketë një mendje të mprehtë e të kthjellët, një truh të shëndoshë, e, mbassi t'a analizojë, me një vëmendje e interesë të gjallë, organizimin dhe funksjonimin filosofik të trupit të vet, do t'a detyrojë ndërgjegjja e vet të pyes vet-vehten: «Kush është Artisti filosof i këtij arti kaq mrekullues, që qenka jashtë rrethit të kompetencës njerzore?»

Pra po që se i pergjigjet kush kësaj pyetje, tue thënë: «une jam në pozitë të krijoj të tillë art, pa ndjekë ligjin, që ka caktue Artisti i parë» d.m.th. të thotë: «une jam i Zoti të krijoj njerës, pa ndjekë ligjin Hyjnuer», le t'i krijoj pra se edhe neve, qysh tash e s'harigojmë se ajo do të fitojë rekordin në gjith botën mbarë dhe se dot të bāhet Mbreti i gjith njerzisë, mbassi ja kalon gjith Mbretëve të tjerë, si me dijen, ushtri, forcë... e tjera e tjera; gjā kjo që është imposibël të jetë në kompetencën njerzore.

Lexues të ndershëm!

Thema, mbi të cilën due të flas, është kjo Traditë Profetike: «Kush njëf vet-vedin njëf Zotin».

Jam i sigurtë se shumë njerse ju duket gjā e lehtë me njoftë vehten e tyne e madje mund të kenë gojë edhe me qeshë me këtë artikull, tue thënë: «Ne njohim me mija njerës të

ndryshëm, dimë mësimet filosofike, si do mos shkencës i kemi gjetë fundin, kështu që kemi çpikë vegla të ndryshme, si ç'e din gjith bota e, si të mos njohim vehten t'onë?»

Po, kanë të drejtë Zotnit në fjalë, se kaq u a pret mendja e vorfun e tyne, e cila i ka hudhë në humnerë e në kthetra të tmershme të natyrës, që kështu po u plagoset e po u brengoset zemra e tyne dita me ditë,

tue mos gjetë as një herë prehje e qetsí të plotë në këtë botë, le-je se për botën tjetër s'mendojnë fare, se si do të jetë përfundimi i tyre.

Këtu qellimi me këtë mësim Profetik, «Kush njëf vet-vedin njëf Zotin» nuk është se ai që njëf figuren e vet, përfaqë, njëf Perendín, por ai njeri që të ketë një mendje të mprehtë e të kthjellët, një truh të shendoshë, e, mbassi t'a analizojë, me një vëmendje e interesë të gjallë, organizimin dhe funksjonimin filosofik të trupit të vet, do t'a detyrojë ndërgjegjeja e vet të pyes vet-vehten: «Kush është Artisti filosof i këtij arti kaq mrekullues, që qenka jashtë rrethit të kompetencës njerzore?»

Pra po që se i pergjigjet kush kësaj pyetje, tue thënë: «une jam në pozitë të krijoj të tillë art, pa ndjekë ligjin, që ka caktue Artisti i parë» d.m.th. të thotë: «une jam i Zoti të krijoj njerës, pa ndjekë ligjin Hyjnuer», le t'i krijoj pra se edhe neve, qysh tash e sihariqojmë se ai do të fitojë rekordin në gjithë botën mbarë dhe se dot të bëhet Mbreti i gjithë njerzisë, mbassi ja kalon gjithë Mbretënve të tjerë, si me dijení, ushtrí, forcë... e tjera e tjera; gjatë kësaj që është imposibël të jetë në kompetencën njerzore.

Traditen Profetike në fjalë, rreth të cilës po shtjellojmë themën t'onë, nuk e shofim të nevojshme, që të hymë me vertetue se ç'farë tradite është, mbassi përmbajtjen e saj e nxjerrim drejt për drejtë nga verseti i naltë kuranuer:

استعِذْ بِاللّٰهِ بِسْمِ اللّٰهِ: «و من يرغب عن ملة إبراهيم إلا من سفه نفسه»

që d.m.th. «Kush asht ai që i shmanget Fés së H. Ibrahimit, veç ai që s'njef ved-vedin?»

N'anë tjetër vertetohet me versetin e naltë kuranuer:

«ملة أبيكم إبراهيم هو سماكم المسلمين من قبل»

se feja e H. Ibrahimit, me Fen Islame është një. Nga këto kuptimi i traditës në fjalë merr tash ketë trajtë:

ما يرغب عن قانون التوحيد إلا من جهل نفسه، إن كان الجاهل لنفسه معرضاً عن الألوهية أي عن معرفتها يلزم أن يكون من عرف نفسه أن يعرف ربه بمفهوم المخالفة فهذا التدقيق تحقق أن حقيقي من عرف نفسه فقد عرف ربه مؤدى قوله تعالى «و من يرغب عن ملة إبراهيم إلا من سفه نفسه» فيثبت أنه مفهوم القرآن.

Nuk shmanget as kush nga Kanuni i Unitetit Hyjnuer, vaç ai që s'njef vedin o, në qoftë se vetëm ai që s'njef vedin kundërshton Unitetin Hyjnuer, del në shesh se, kushdo që njëf ved-vedin njëf edhe Perendín. Prej kësaj u muer vesht më kjashtë se Tradita e jonë e naltëpërmendun është direkt kuptimi i versetit në fjalë (40:53)

Le të hedhim një sy pre mbi trupin t'onë e të shofim mrekullinat bindëse e prekse që kanë lanë dhe to të lanë me gjishtë në gojë gjenit më të shkëlqyeshëm të botës, pse janë të çpikura nga Artisti i pa shoq, i cili, tue porositë njeriun që të hapin sytë e të zgjohet nga gjumi i thellë që e ka zënë e të njoftin krijuesin e tij, Perendín, thotë:

«سنريهم آياتنا في الآفاق و في أنفسهم حتى يتبين لهم أنه الحق أو لم يكف بربك أنه على كل شيء شهيد»

«u a diftojmë njersve mrekullinat t'ona ndër horizonte dhe në ve-vedin e tyne, deri sa t'a kuptojnë sheshazi se me të vërtetë Perendia është aj qi ka krijuë të gjitha këto dhe se vetëm ky meriton me u adhurie për Zot...» (40:53)

Pra të shiqojmë mrekullinat, qi ka krijuë Artisti n'artin mâ të naltë, mâ të bukur, mâ të përsosun e mâ model të arteve të Tij; të vërejmë me një vë-mendje e interesë të gjall, tue analizue pik për pikë organizimin dhe funksjonimin e tij; me sa të jetë e mundur: s'parit fillojmë nga selula a po çeliza, e cila përbâhet prej protoplasmës me nuklius në qender – berthâm – dhe është organizma mâ e vogël në trup të gjall. P. sh. Aniba dhe infuzorët janë organizma me një selule të vetme. Kompozimi i shume seluleve përbân hinde të ndryshme:

I. Hindet epitheljore, selulet e të cilave, janë të vendosura rrjesht njena mbas tjetrës, shërbejnë për të mbulue trupin, qi kështu e ruejnë nga sulmimet e rrezikshme të natyrës; mirëpo këto selule shofim qi s'janë rrjeshtue, aq dendur në mes tyne, por kanë pore (vrime) në mes tyne.

Këtu na vjen të pyesim ç'është qellimi filosofik i Artistit me këto pore? A po kot? Jo, jo! Se Aj urdhnnon e thotë:

«و ما خلقنا السموات و الأرض لاعين»

«S'kam krijuë gjâ të pa vlefshme e kot, pa qellim.»

Pra struktura e seluleve, në formën e sipër-tregueme, ka për

qellim qi të jetë një komunikasjon i korentit t'ajrit, si edhe i të thithmes e i jashtëqitjes s'ujit, i cili formon $\frac{3}{4}$ e peshës së krejt trupit; me këtë mënyrë freskohen e fladiten të gjitha selulet tjera, qi s'janë në kontakt me ajrin, si edhe shpirti; madje mund të themi se jeta do t'ishte e pa mundun pa këtë komunikasjon, sidomos kur trupi i njeriut është në një temperaturë të naltë nxetsie, i nevojitet doemos qi të qesin jasht djersë e të thithin tjetër ujë e ajr. Pra për t'i mprojtë këto pore, kaq të nevojshme për shendetin t'onë, duhet m'u lã e me u pastrue shpesh, qi kështu të mos i lamë me u mbyllë prej pluhuri e djersësh, gjâ kjo për të cilën na porosit si Artisti i Artit ashtu edhe H. Muhamedi:

«إذا قمتم إلى الصلاة فاغسلوا وجوهكم وأيديكم إلى المرافق وامسحوا برؤوسكم وأرجلكم إلى الكعبين».

d.m.th. «Kur të doni me u fal lani ftyrat, duert me gjith brryla, përshkoni doren të lagët mbi një të katertën e kokës e mâ në fund lani kambët me gjith nëna rregullisht.» Kështu çohet urdhni Hyjnuer në vend, i cili s'është gjâ tjetër vç dobí për né.

Po kështu urdhnnon edhe H. Pejgamberi në shumë hadithe qi të lajmë krejt trupin s'pakut një herë në javë.

Këso bazash pra me qëllime e dobina të mdhá ka urdhnue çpiksi i artit e jo si thonë disa mendeshkurtë qi kush lindet dhe rritet e vdes pa e prekë trupin e tij uji, është i pastër nga mëkatet. Jo, jo s'është ashtu! Kjo është

kundra urdhnit të Krijuesit të trupit dhe kundra logjikës.

II. Mbas këtij hindi vinë hindet e mbështetjes, të përbâme prej seluleve qi ndahen në mes të tyre prej një lânde të posaçme dhe ndahen në tri (3) lloje:

a) – Hindi lidhuer, selulet të cilit shquhen prej pezve të gjata që quhen rrypa lidhuer e me këto lidhen organet e njeriut me një mënyrë shumë të mrekullueshme.

b) – Hindi rrishtuer, qi përbâhet prej selulesh të përkulshme.

c) – Hindi eshtnuer, selulet e të cilit ndahen prej një lânde të fortë, qi përbâhet prej krypnash gëlqerore.

III. Hindet pejzore, selulet e të cilave janë të elastikshme, kështu qi me anën e këtyne jemi kapabël me bâ ç'do lëvizje trupore, qi të na nevojitet.

IV. Hindet e luëjtshme të formueme prej selulesh të zhytuna në një lang të qujtun gjak, hinde këto qi luejnë rrolin mâ të madh në trupin e njeriut.

V. Edhe Hindet nervore.

Prap shofim se këto hinde të ndryshme bashkohen në mes vedit me një sistem të çuditshëm për të krye një punë të caktueme dhe quhen organe; p.sh. le të marrim sÿnin dhe le të shiqojmë se me ç'mjeshtëri është ndërtue. Ky organ, struktura misterjoze e të cilit, me mbulesën e dukshme të bardhë, për të bâ rifleksjonin e plotë; mandej të fortë për të ruejtë trajtën e kokrrës

së synit, qendrën me mbulesë të zezë, është me të vërtetë modeli shembulluer dhe gurra e pashterrun e të gjithë instrumenteve optike; pse të gjitha këto instrumente si Dylbia – Tej-qyrja – Mikroskopi, Teleskopi, si edhe aparati i fotografis e tjera janë çpikë mbas imitimit qi kanë bâ dijetarët e ndryshëm në strukturën filosofike t'Artit të pa shembull.

Këtë imitim, të gjith ata qi kanë studjue dhe qi do të studjojnë pas këndeje, me vrejte në sÿnin dhe në instrumentët në fjalë, tue ju bâ një krahasim, si në të qenme e zezë mbrendia e dy palve, si edhe në lentila kristalini... e tjera, pa dyshim kanë për t'a gjtë të vërtetë, por jo në ç'do pikpamje.

Po t'u shiqojmë një herë lândën përbâse; shofim se instrumentët optike përbâhen prej një lânde minerale, kurse sÿni prej mishi, lândë kjo qi fizika s'mund t'a shtjeri në përdorim për të tilla instrumente. Po të mendohemi pak në kët krahasim gjejmë se çpiksit e instrumenteve optike në fjalë, me gjith qi murën model sÿnin, nuk mundën me i ndërtue pik për pikë si kët model; n'anë tjetër lândët ndërtuese i patën po të çpiksit të modelit, si ç'urdhnon vetë Artisti i modelit me versetin plot-kuptim në Kuranin e madhnueshëm:

«الله خالق كل شيء»

e çka mâ tepër kanë pasë edhe veglat, me të cilat punuen për të imitue modelin në fjalë, të

dhuruem po prej Artistit të synit si duert, kambët, sÿt e tyne, fuqin dhe mendjen, vegël kjo qi është xhevahiri mâ i çmueshëm në trupin e njeriut.

Të gjitha këto vegla, si kur të donte Artisti i tyne do të ja u përllante dhe do t'i lente me duër thatë. Pra për këta njerës s'meriton mburrja për çpikjen e instrumenteve të tyne. N'oranizimin e trupit shofim edhe se bashkohen organe të ndryshme dhe formojnë një Erení. P. sh. stomaku, i cili me langjet e tij gjith farësh, s'është e mundun të mos çudisi dijetarët mâ të mdhaj të shkencës. Mandej kemi për të vërejtë funksjonet ushqimore, të cilat janë: Tretja, Thithja, Qarkullimi i gjakut, frymësia e tjera. Të gjitha këto kanë me rradhë funksjone filosofike, të cilat, mbassi të studjohen me një vërejtje e vëmendje të mpreftë e me një qëllim vetëm për të gjurmue të drejtën e jo me interesë, pa dyshim do t'i habisi dijetarët mâ të famshëm të shkencës e të botës mbarë, sa qi do t'i bindin me prû konviksjon ndaj Artistin e pa shoq të tyne.

Kështu pra lexues të ndershëm, mbassi t'a analizojmë vehten t'onë, si ç'thamë, është imposibël të mos e gjejmë me mendi, deri diku, Artistin filosof t'artit t'onë, të pa shoq, Allahun, Krijuesin e gjithsis, i Cili e bâni trupin t'onë kaq të përsosur si ç'e vërteton me versetin e shenjtë Kuranuer:

«لقد خلقنا الإنسان في أحسن تقويم»

«Me t'vërtetë njeriun e kemi

krijue në formën mâ të bukur e mâ të përsosun».

Pra nga kjo del qi ç'do njeri e ka në natyrë të besojnë Krijuesin e vetëm të tij, si ç'urdhnon vetë me versetin e naltë:

«فطرة الله التي فطر الناس عليها»

«Mendimi, për Fen Islame, është një natyrë e Zotit, mbi të cilën i ka krijue Aj Vet njerzín».

Pra, lexues i dashur është turp i madh dhe mjerim i tmershëm të mos njofim ved-vetën e të mos gjejmë atë natyrë të saktë, esanca apo origjinali i artit t'onë; njeriu pa atë s'mund të rrojë me nderë e me lumtëri, as nuk mund të kryejë detyrat, për të cilat është destinue. Aj qi njëf natyrën e sakt të ved-vedës shpirtin e tij e ka sigurue. T'a shpjegojmë me një shembull: Një shofer automobili me qenë se hypë në makinën e tij për t'udhtue në një vend të caktuem dhe mbassi të ndezin motorin e makinës t'ja lëshojnë timonin, vegëlën drejtuese, e të shtyhet vet mâ mbrapa tue mos e prekë as kush timonin e makinës; tash makina e ndezur, e kompletueme me ç'i nevojitet, veç shoferit, vall a do t'a mbrijë vendin e caktuem?! Jo! Jo, as pak, po, përkundrazi makina do të përllase me ndo një shkamb, ku do të bâhet tanë thërmi e grimë; e po në atë kohë edhe shoferi qi s'mbajti drejt, si lypsej, timonin, do të bâhet tânë fije fije pa pasë të drejtë me ju ankue as kujt për jetën qi humbi.

Kështu pra timoni i trupit

t'onë është ajo natyrë e sakt që e krijoi Artisti i artit, për të drejtue e rregullue n'udhë të drejtë e të shesht artin e vet.

Vetëm kjo natyrë esancjale është pra që i ep ngushëllim njerzís, e, që u a siguron, si lypset gëzimin e ndërgjegjës së tyne, dhe, që u a çelë dyert e lumtërisë së vërtetë për të dy jetët.

I lutemi pra përvujtnisht e me plot bindje Perëndís fuqí plotë, Krijuesit t'onë e të krejt ruzullimit, që të na bân të qëndrushëm në këtë natyrë të saktë, tue na mprojtë

kujdesisht nën Hijen e Amshueme të Tij, si edhe të na shtië nën Hijen e Flamurit të madhnueshëm e plot begatí të H. Muhamedit A. S.

Gjith ashtu i lutem edhe për ata vllazën t'onë që s'kanë pasë fatin me shijue e admirue këtë natyrë të saktë Hyjnore, t'i bajë me hetue e diktue hollsisht vehten e tyne! Amín!¹

Ajdin Zejneli

S. M. P. – 36

1. Marrë nga revista "Zani i Nalë", nr. 4, viti XI, 1936, f. 111 – 119.

Abstracts in English

ISLAMIC SCIENCE

1. Bid'ah (innovations),

One of the issues that hinder the unity of Muslims

Ervin Qylafku

Abstract

One of the main arguments that we often hear from those who consider every innovation as sin and loss is the concept that, if the Prophet (pbuh) has not acted in a certain way, then such an action is considered prohibited and innovation (bid'ah). This is one of the strangest things one can be said about this issue. Not everything that the Prophet (pubh) did not act is considered as prohibited – even if it is a type of worship – especially when he has not forbidden people from doing so.

It is clear that generally, the concept of Islamic scholars regarding the issue of innovation (bid'ah) has been misunderstood, misinterpreted and often ignored by scholars and self-taught people who have created a conflictual climate. Minimally, a silence on the issuance of accusations, allegations, and labels is required, avoiding such allegations that all those who do not think like them have deviated from the Lord's path and are at risk of being punished by Him in eternal life for subject matters of human reasoning. Constructive debate is the one that paves the way for understanding and justification of different thinking and, consequently, the unification and brotherhood of believers - an action that pleases the Lord of the universe, his honored Prophet and all believers as well. Allah knows best!

STUDIES

2. Learning civil norms in madrassas of Albania

Prof. Assoc. Dr. Gentiana Skura, University of Tirana

Dr. Robert Gjedia, University "Marin Barleti"

Dr. Genti Kruja, "Bedër" University

Abstract

Civic education curricula in pre-university education is developed through the subjects of "Education for Society" and "Civics" and aims at forming the knowledge, skills, attitudes and civic values of the students of this educational cycle by heavily relying on philosophies, good practices and models of European citizenship and the democratic world in particular, where in their essence lie individual rights and responsibilities, law enforcement, environmental care, the right to employment, human security and coexistence in the community. The content of the aforementioned subjects does not affect any information or practice of education related to matters of religious instruction and education. Also, this type of education has a special place in the curriculum that is sufficient to achieve the desired goals and competencies for the students, considering the amount of hours, the specific weight of the curriculum area, as well as of the genuine subjects of civic formation taught in all three pre-university education cycles, compared to the curricula of European education systems.

Madrasas develop the official curriculum for pre-university education cycles, but they also have a part of their curriculum with a religious orientation, which is also approved by the Ministry of Education.

Religious subjects are integrated into the official curricula of the madrasas in such a way as to be supportive of the topics covered by civic education subjects. Since the person living in a democratic system is very similar to a believer in his/her behaviours (regardless his/her religious affiliation), the common themes of these subjects are numerous.

3. Waqfs in Albania from the Ottoman period to the communist regime

Uran Kalej, Muslim Community of Albania

Abstract

The creation of waqf institutions in Albanian territories begins after the arrival of the Ottomans in the Balkans, starting from the second half of the XV-th century. These institutions have played an extremely important role in the socio-economic and religious life of the Albanian population. Indeed, various studies show that some of the Albanian medieval urban centers were created because of Waqfs. This is also true for Tirana, which today is the

capital of the Republic of Albania.

During the Ottoman period, the amount of agricultural assets, mosques, taps or objects that were donated as a Waqf experienced a large extent in all urban and rural centers of Albania. This is also evidenced by the names these assets carry, which, in most cases, belong to the persons who donated or built them.

After Albania's secession from the Ottoman Empire, the traditions of the donation as Waqfs of the assets continued with the same intensity. But at that period, Waqfs were being administered by the Albanian Muslim Community, which already was an independent institution from the Ottoman Caliphate. In the period 1920-1944 there was an increase in the level of Waqf management. For a proper management, special regulations were drafted, which set rigorously the way they functioned. Their income were used for the restoration and construction of mosques, opening of courses and religious schools, qualification of staff, or for solving of the problems of the Islamic community.

An unfavorable situation for Waqfs was created in Albania after 1945, when the communist regime was installed. The repressive measures that the Albanian government pursued in this period originally consisted of the restriction, and then the destruction of religious institutions. In this period, laws which overwhelmingly passed the Waqf assets to the state were drafted, while, in 1967, religion was banned by law, and most of the mosques were destroyed. Nowadays, the attitude of the Albanian state to the restoration of Waqfs is confusing.

Keywords: Albania, Waqf, the Albanian Muslim Community, management of Waqfs, legislation.

EDUCATION AND INSTRUCTION

4. 100th anniversary of Shkodra's normal school

Prof. dr. Njazi Kazazi

Department of Linguistics

University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"

Abstract

As widely known, Albania turned into a battlefield during the First World War. In 1916, there were armies of 5 different states in the territory of Albania. Despite the difficult conditions of war, where our country suffered enormous economic damage and was divided into three occupation zones, progressive forces, patriots and folk teachers, tried to exploit those few opportunities created for the benefit of our national cultural development and education.

5. Technologization of Education: - Challenge or Progress?

Nuredin Nazarko

Abstract

Being educated today is considered one of the most normal objectives, nay the most important one. The importance of the human being education has become such an axiomatic belief, that nobody cares if one has the capacity and the potential to absorb and express knowledge. Fourly convinced that without going through the links of the educational chain there is no chance of becoming a true human being, everyone is getting educated, dreaming so a later successful end through interim. Man likes to dream and imagine fictional success, because he can ease in this way the burden and weight of tension that stems from the huge difficulties lying in the path of the educated people. The evolution of many ideas and practices in human society cannot leave the education intact. The technical-information revolution has generated many dreams of many people - dreams that are giving shape to the reality of the educated. Building realities based on dreams and imaginations inspired by artificial instruments cannot bring anything new beyond the possibilities. In this situation, it is our duty - as beings of this world - to strive hard in clarifying our ideas and imaginations in order to remove the beautiful veil of technology adorned with the flowers of progress. It is more than natural that we try to move things toward improvement and relief. We should not - for the sake of this improvement or relief - be alienated from our earlier goal. We should not consider ourselves as self-sufficient and not in need for anyone since we already possess science and technology. Avoiding the lure from these dreams is our challenge.

Keywords: Technologization, Education, Being in Opportunity, Progress, Challenge

HISTORY

6. Corpus of Ottoman inscriptions in Vlora and Gjirokastra

Dr. Mehmet Tütüncü

The Global Research Center for Turkish and Arab Languages,
Haarlem, The Netherlands

Abstract

This is a study and publication on Ottoman inscriptions in southern Albania, defined as the region between Vlora and the Greek border. Over the last few years, many new inscriptions (mainly gravestones) have been discovered by foreign and local scholars.

Inscriptions taken from the literature (Evliya Çelebi and others) have been added to these new inscriptions. 25 graffiti from this area, dating from 1542 to 1897, are published here as part of the Corpus of Ottoman inscriptions in Albania. These inscriptions are analyzed in the light of their historical and cultural context. They contain information about the activities in the field of construction, life and culture of this region during the centuries of Ottoman rule in Albania.

COMMUNICATION SCIENCE

7. Conference: “Drita Islame” - a light ray for Islam in Albania “Drita Islame” as a responsible tool of mass communication in the trend of current developments Doc. Dr. Ramadan Çipuri, “Bedër” University

Abstract

“Drita Islame” was not just a newspaper or magazine published by MCA in the classical form in which we are accustomed to see the organs of the religious press. It has been a window of communication between the highest Muslim institution in the country and the public as a whole.

The particularity here lies in the fact that “Drita Islame” has managed to communicate not only with the traditional public t as we are accustomed to know but also with the so-called “public” in communication sciences, ie different types of public within and outside our country.

The message brought by “Drita Islame” is not only of a religious character, but it also addresses a number of problematic issues related to education, economy, norms of community behavior, issues of social and political nature, etc.

8. Woman and family in important institutions of society under the optics of “Drita Islame” viewpoint Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla, University of Tirana

Abstract

The structure of the family in the perspective of “Drita Islame” should be viewed from the perspective of horizontal function in micro-systemic and macro-system dimensions. The issue of the family in sociology - especially in contemporary sociology and Islamic ethics - takes an important place. The family phenomenon considered from the perspective of morality protection is considered among the most fundamental and dynamic factors of society and of the human enrichment regarding the interpersonal relationships in the human being.

Thus, the family is a special kind of structure through blood bonding and moral conjugal relationships, held through mutual demands defined by religion, reinforced by the law of Shari'ah and rebuilt by the individual.

Woman has a contribution of special importance for the renewal of society. It is required from her to recognize the religion, to be one of those who continuously accomplish the duties of Allah - the Exalted, the husband, the children, the society and the homeland without neglecting any of them. Emancipation and advancement of women within Islamic norms, consists in a more emancipated society, which requires the approach of women in all areas of social life and the elimination of the wrong worldview according which a woman is only a mother and that her biological function is only giving birth to children and thus it must be and remain a household, closed and connected only to children. Contemporary women, entangled with Islamic ideology, are increasingly emancipated and with increasing abilities that allow them to be active in economic and political life.

POLITICAL SCIENCES

9. The process of the Republic of Kosovo independence and its role in the political stability of the Balkans and across Europe M.Sc. Artan S. Mehmeti

Abstract

Republic of Kosovo with an area of 10,907 km², and about 2.2 million inhabitants, is the newest state in the world. The process of Kosovo's independence has gone through a long and difficult period, from which many people were dead and are still missing. The newest country's in the world has been recognized by 108 countries. The proclamation of independence has produced local and regional stability; this is confirmed by the opinion of the ICJ adviser, as well as of many well-known international politicians and analysts. Even after the declaration of independence, the Republic of Kosovo is still facing many difficulties both in economic and social terms and also in politics. There is still a lot of work for the Kosovo institutions to do in enabling Kosovo move towards the road to accession to the EU and NATO. Kosovo's independence act is only a correction of the injustices that have been made to the Albanian people at the Conference of Ambassadors in London, from which, Kosovo and other Albanian lands, were detached from the Albanian state and given to neighboring states.

PERSONALITY

10. Hajji Ismail B. Rexhepi
(3.11. 1947 – 13. 11. 2016)
By Academician Feti Mehdiu

Abstract

He was the Imam of “Hajji Ramadan” mosque in Prizren and of “Hadim Aga” mosque in Gjakova. He was a tireless man, who also carried the duty of leading the Islamic Community Council in Gjakova. When he was in Gjakova, he gave a special contribution in organizing many important activities for the population of this region. Especially he tried to help the families of martyrs and victims of war, to collect the means of assistance to the Kosovo Liberation Army, for which the Gratitude on Flag Day on 28 November 1997 was also given to him by the Municipal Council in Prizren. He also participated in the action of feud reconciliation and in official meetings in international missions, observing the situation of war developments in Kosovo.

RETROSPECTIVE

11. Who knows himself, knows the God

قال عليه الصلاة والسلام: «من عرف نفسه فقد عرف ربه»

Abstract

Here, the goal of this Prophetic tradition “Who knows himself, knows the God” is not to make people think that if they know their own physical image are able to know the God, rather, those people who have insight and sound thinking, a healthy brain and after analyzing with attention and interests their own organism and the philosophical function of their own brain will make their conscience to ask themselves: “Who is that philosophical artist of their marvelous art that is outside of the human competency circle?”

So, if anybody answers to this question by saying “I am able to create such an art without obeying the law of the First Artist” ie stating “I am able to create humans without obeying the Divine Law” let’s start to create them, for we from now and on will congratulate him, as he will establish a record in the entire world and will become the King of the humanity because he will exceed the abilities of other kings in knowledge, power, military etc... which is impossible to be within the human competency.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.